



Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës



PLANI HAPËSINOR

Zona me interes të veçantë ekonomik

"Parku Energjetik - Hidrocentrali i Zhurit"

2012 - 2022



Instituti për Planifikim Hapësinor

Prishtinë,
Nëntor, 2012

FALËNDERIM

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit e grupit punues ndërministror (GPNM), përfaqësues të komunave e të organizatave publike qeveritare dhe joqeveritare si dhe ekspertë tjerë profesional, për kontributin e dhënë në takimet e organizuara, me qëllim të ndihmës dhe mbështetjes së MMPH-së gjegjësisht Institutit për Planifikim Hapësinor, në hartimin dhe ngritjen e cilësisë së këtij dokumenti:

"Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik – Hidrocentrali i Zhurit 2012 - 2022".

TABELA E PËRMBAJTJES

Hartuesit e planit	5
Lista e shkurtesave	6
Lista e figurave dhe tabelave	7
Përmbledhja ekzekutive	8
Hyrje	10
Gjithpërfshirja në hartim të planit.....	10
Qëllimi i hartimit të planit.....	11
Bazueshmëria dhe procesi i planifikimit	12
Struktura dhe fazat e planit	13
I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR	15
Veçoritë natyrore dhe gjeografike.....	15
Klima	15
Temperatura	15
Reshjet	16
Era	17
Hidrografia	17
Ndërtimi gjeologjik	20
Aspekti tektonik.....	20
Aspekti gjeologjik.....	21
Rreziqet natyrore.....	22
Sizmika	22
Erozioni	22
Mjedisi dhe shfrytëzimi tokës.....	24
Sipërfaqet pyjore	25
Toka bujqësore	25
Vendbanimet/Banimi.....	26
Ndotja dhe degradimi i mjedisit	27
Ajri.....	27
Toka	27
Uji - Kontaminimi i ujërave dhe mbrojtja e tyre	27
Biodiversiteti.....	28
Trashëgimia kulturore dhe natyrore.....	32
Popullsia, zhvillimi social.....	36
Popullsia.....	36
Zhvillimi social.....	36
Arsimi	36
Papunësia.....	38
Varfëria	40
Vendbanimet, banimi dhe shërbimet sociale	41
Zhvillimi ekonomik.....	44
Ekonomia dhe punësimi	44
Bujqësia dhe blegtoaria	44
Industria.....	45
Tregtia.....	46
Turizmi dhe potencialet turistike.....	46
Infrastruktura.....	47
Infrastruktura e transportit dhe transporti	47
Transporti	47
Telekomunikacioni.....	47
Infrastruktura energjetike	47
Rrjeti i shpërndarjes.....	47
Infrastruktura ujore	48

Furnizimi me ujë	48
Kanalizimi i ujrave të zeza	48
Menaxhimi i mbeturinave.....	48
Analiza SWOT.....	50
Kapacitetet investive	51
Sfidat zhvillimore	53
II. VIZIONI PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM HAPËSINOR	55
Deklarata e vizionit	55
III. KORNIZA dhe KONCEPTI I ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM HAPËSINOR	59
Koncepti i zhvillimit hapësinor i ZIVE –“KEZH - Hidrocentrali i Zhurit”	59
IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM HAPËSINOR	61
Synimet e zhvillimit hapësinor të ZIVE "Hidrocentrali i Zhurit"	61
Strategjia sipas trendit.....	73
Strategjia sipas konceptit zhvillimor	74
V. DISPOZITAT PËR ZBATIM	77
Kushtet dhe masat e përgjithshme.....	77
Literatura	80

HARTUESIT E PLANIT

Instituti për Planifikim Hapësinor

Drejtor – Luan Nushi

Ekspertët e fushave – Arbën Rrecaj, Besim Gollopeni, Elvida Pallaska, Faton Deva, Festa Nela, Gëzime Grajqevci, Ismail Gagica, Mimoza Kallaba, Nexhmije Kamberi, Rizah Murseli, Shpend Agaj, Zana Mehmeti, Luan Nushi.

Grupi Punues Ndër-Ministror:

Koordinator – Elvida Pallaska

Ndihmës koordinator – Rizah Murseli

Anëtarët tjerë – Ardian Begaj MTPT, Fadil Bajraktari AKMM/MMPH, Fatmir Azemi DBN/MMPH, Florim Krasniqi KK/Dragash; Hazir Çadraku DU/MMPH, Ilirjana Azizi-Mejzini DPH/MMPH, Refki Muzbegu KK/Prizren; Sabit Restelica AKMM/MMPH, Sami Sinani DMM/MMPH, Sylë Tahirsylaj IHM/MMPH; Tahir Halitaj MBPZHR

LISTA E SHKURTESAVE

AER	Agjencionit Evropian për Rindërtim
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BKK	Buxheti Konsoliduar i Kosovës
DMM	Departamenti i Mbrojtjes Mjedisit
DPH	Departamenti për Planifikim Hapësinor
EJL	Evropa Jug Lindore
GPNM	Grupi Punues Ndër-Ministror
HC	Hidro - Central
IHMK	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KK	Kuvendi komunal
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës
MBPZHR	Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTPT	Ministria e transportit dhe postë telekomunikimit
MËh	Megavat orë
PATEL	Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti
PH	Plani Hapësinor
PVZH	Plani Veprimit për Zhvendosje
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
TC	Termo - Central
TKE	Traktati i Komunitetit për Energji
UNMIK	Misioni i Administrimit të Përkohshëm i OKB-së në Kosovë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VNS	Vlerësimi i Ndikimit Strategjik
VSMS	Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social
ZIVE	Zonë me Interes t'Veçantë Ekonomik
ZKR	Zyra Kryeministrit

Lista e figurave dhe tabelave

- Fig. 1. Skema e pjesëmarrjes
 Fig. 2. Procesi i planifikimit
 Fig.3. Harta e pozitës gjeografike të lokacionit të HC Zhur Dragashit
 Fig.4. Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore në Dragash për periudhën 1949-1978
 Fig.5. Vlerat mesatare të reshjeve 1950-1978
 Fig 6. Lagështia relative e ajrit në Prizren dhe Dragash
 Fig.7. Hidrografia dhe ndotja e ujërave në zonën e HCZhur
 Fig.8. Prurjet mesatare meter/kub
 Fig. 9. Harta gjeologjike e zonës së HC Zhur
 Fig.10. Harta sizmike për zonën e HC Zhur (te punohet)
 Fig.11. Harta e erozonit në zonën e HCZhur
 Fig. 12. Harta sipas pronësisë
 Fig.13. Shfrytëzimi i tokës në zonën e interesit "HC Zhur"
 Fig.14. Shtrirja e tokës bujqësore sipas kualitetit në zonën e "HC Zhur"
 Fig.15. Shtrirja e vendbanimeve sipas zonave në HC Zhur
 Fig.16. Degradimi i lumenjve në zonë
 Fig. 17. Harta e ndotjes së lumenjve në zonën e HC Zhur
 Fig.18. Valanica - objekt unik në Kosovë
 Fig.19. Namazxhahu, monument i mbrojtur
 Fig.20. Xhamia e Kukli Begut, monument i mbrojtur
 Fig.21. Lojërat tradicionale të pelivanëve
 Fig. 22. Shtrirja hapësinore e shërbimeve arsimore dhe niveli i tyre
 Fig.23. Shtrirja hapësinore e objekteve shëndetësore
 Fig. 24. Papunësia sipas vendbanimeve në komunën e Dragashit
 Fig. 25. Skema sipas moshës dhe gjinisë
 Fig. 26. Skema e pjesëmarrjes dhe e papunësisë
 Fig. 27. Skema e shkallës së papunësisë sipas kualifikimeve
 Fig.28. Përqindja e vendbanimeve që merren me prodhimtari bujqësore
 Fig. 29. Garat në Zapluzhë
 Fig. 30. Harta e rrugëve (M25, R113, R114 dhe R222) dhe vendbanimet e përfshira nga transporti publik.
 Fig. 31. Harta e vendbanimeve, shërbimeve postare dhe telefonisë fikse
 Fig.32. Harta e ujësjellësit, kanalizimeve, shërbimeve publike për largimin e mbeturinave
 Fig.33. Skema piramidale për arritjen e vizionit
 Fig.34. Koncepti zhvillimor i Hidrocentralit të Zhurit
 Fig.35. Harta e zhvillimit hapësinor të ZIVE "HC Zhur"

Tabelat

- Tab 1. Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore të ajrit të regjistruara në stacionin meteorologjik të Dragashit
 Tab 2. Vlerat mesatare mujore dhe vjetore të reshjeve (1950-1978) (mm)
 Tab 3. Shpejtësia mesatare e erërave në Prishtinë dhe Prizren (1949) (m/s)
 Tab 4. Lagështia relative e ajrit 1
 Tab.5. Rrjedhat mesatare vjetore :
 Tab.6. Shkalla e erozionit
 Tab.7. Shfrytëzimi i tokës në zonën e HC Zhur
 Tab.8. Zonat pyjore sipas njësisë ekonomike
 Tab. 9. Zona e pyjeve, vëllimi, shtimi dhe prerjet vjetore
 Tab. 10. Monumentet e trashëgimisë kulturore

- Tab.11. Vendbanimet dhe numri i popullsisë*
- Tab. 12. Pronësia private (Brezne)*
- Tab.13. Pasuritë /Objektet publike në zonën e Breznës*
- Tab.14. Prona Private Zym/Qollopek*
- Tab. 15. Shuma e përgjithshme shpronësimit dhe zhvendosjes*
- Tab. 16. Kostoja e ndërtimit të projektit*
- Tab. 17. Shuma e përgjithshme shpronësimi dhe zhvendosja*
- Tab. 18. Kostoja e ndërtimit*
- Tab. 19. Kostoja e shpronësimit dhe zhvendosjes*
- Tab. 20. Synimi i parë dhe objektivat e tij*
- Tab. 21. Synimi i dytë dhe objektivat e tij*
- Tab. 22. Synimi i tretë dhe objektivat e tij*
- Tab. 23. Vlerësimi i strategjive për zonën PEZH-së sipas kritereve standarde. –*

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky dokument paraqet Planin Hapësinor të Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik të Hidrocentralit të Zhurit të shpallur me vendimin e kryeministrit të Kosovës, nr. 03-V-154 të datës 24 korrik 2009.

Direktiva 2009/28 obligon Kosovë si anetare të Traktatit të Komunitetit Evropian, në prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, e cila i përfshin dy direktiva të mëhershme: i) Direktivën 2001/77/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 shtator 2001 mbi promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burime të ripërtëritshme të energjisë në tregun e brendshëm të energjisë elektrik dhe ii) Direktivën 2003/30/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 8 maj 2003 mbi promovimin e shfrytëzimit të bio-karburanteve dhe karburanteve tjera të ripërtëritshme për transport.

Sipërfaqja e kufirit të HC Zhur sipas vendimit në fjalë është 19.41 km², kufi i cili prek komunën e Prizrenit dhe të Dragashit me vendbanimet: Komuna e Dragashit: Brezna; Buçe; Plava; Zymi dhe Bellobradi; Komuna e Prizrenit, Dobrusha, Rrenc, Dikancë, Gllloboqicë dhe **Zona urbane e Dragashit**.

Hidrocentrali i Zhurit ndodhet në pjesën jugore të Kosovës, në jug-perëndim të Komunës së Prizrenit dhe në Veri të komunës së Dragashit. Ka kapacitet 305 MgW, me një prodhim mesatar vjetor të 400 GgW në orë, që transferohet në furnizimin energjetik të Kosovës nëpërmjet linjave të transmetimit.

Plani Hapsinor për Zonën e Interesit të Veçantë Ekonomik për Hidrocentralin e Zhurit është i bazuar në dokumentet bazë për zonën në fjalë: Studimin e arësyeshmërisë për Hidrocentralin e Zhurit; Analizën hapësinore të komunës së Dragashit, Profilin socio ekonomik dhe fizik të komunës së Dragashit dhe të tjera.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Plani është ofrimi i bazës së masave, dispozitave dhe projekteve për zbatim të projektit të Hidrocentralit të Zhurit por dhe të zhvillimit të gjithëmbarshtëm social dhe ekonomik të Zonës, informojë vendim-marrësit për mundësitë, opcionet dhe ndikimet e zhvillimeve.

HYRJE

Ky dokument paraqet Planin Hapësinor të Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik të Hidrocentralit të Zhurit të shpallur me vendimin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-154 të datës 24 korrik 2009, me të cilën dhe është përcaktuar përgjegjësia për koordinimin e hartimit të planit hapësinor për zonën. Kjo përgjegjësi i takon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht Institutit për Planifikim Hapësinor, përderisa akterët kryesorë janë identifikuar që në fillim të hartimit të PHHCZH.

Sipërfaqja e kufirit të HC Zhur sipas vendimit në fjalë është 19.41 km², kufi i cili prek komunën e Prizrenit dhe të Dragashit me disa vendbanime.

Zona e vendndodhjes për Hidrocentral të Zhurit do të jetë në pjesën jugore të Kosovës, në jug-perëndim të komunës së Prizrenit dhe në veri të komunës së Dragashit.

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në ndërtimin e kapaciteteve të mjaftueshme energjetike për mbulimin e konsumit vendor, duke pasur parasysh ndërtimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtëritshme. Në përgjithësi, prodhimi aktual i rrymës elektrike në Kosovë varet nga Termocentralet (TC) e vjetruara 'Kosova A' dhe 'Kosova B', të cilat djegin linjtin që nxirret nga minierat e Bardhit dhe Mirashit, me vendndodhje në perëndim të kryeqendrës së Kosovës - Prishtinës. Pasuritë (resurset) minerare në këto mihje ekzistuese janë në përfundim dhe pritjet të shterojnë në vitin 2011, andaj edhe planifikohet që të hapen miniera të reja linjiti për kapacitete të reja prodhimi të energjisë elektrike nga kjo lëndë e parë, Kosova duhet të planifikojë për gjenerim të energjisë nga burimet e ripërtëritshme².

Ekspertët e energjetikës, këtë projekt e kanë vlerësuar si shumë të rëndësishëm, pasi që ky hidrocentral do të jetë shumë i mirë jo vetëm për qasje ndaj mjedisit, porse do të ketë një rëndësi të veçantë për furnizimin e Kosovës me energji, do të ndikojë në performancën teknike të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës, fleksibilitetin dhe sigurinë e furnizimit. Energjia do të prodhohet me standarde evropiane, me një ndotje minimale sikurse dhe do të jetë një mundësi e mirë për zhvillim të turizmit të komunës së Dragashit dhe Prizrenit.

Studimi i fizibilitetit është financuar nga Banka Botërore në kuadër të projektit të asistencës teknike që kjo bankë ofron për sektorin e energjisë në Kosovë dhe është përgatitur nga kompania kroate Elektroprojekt nga Zagrebi. Ky studim është prezantuar në qershor të vitit 2009, përderisa qeveria është shprehur si e përkushtuar në stabilizimin dhe zhvillimin e ofrimit të energjisë në Kosovë.

GJITHPËRFSHIRJA NË HARTIM TË PLANIT

Në vendimin, me numër protokollit 03-V 154 të datës 24.07.2009, Qeveria e obligon Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor për hartimin e Planit Hapësinor për këtë zonë. Me këtë rast, si edhe për shkak të nevojës për hartim sa më të shpejtë të këtij Plani, përveç zyrtarëve profesional në stafin e Institutit për Planifikim Hapësinor është themeluar edhe Grupi Punues Ndër-Ministror. Gjatë procesit të hartimit të Planit, ky grup punues do të zgjerohet edhe më tej me pjesëmarrës tjerë.

Kjo bazohet në parimin e gjithëpërfshirjes me qëllim të involvimit dhe pjesëmarrjes të gjitha palëve të interesit që nga faza e parë e hartimit të dokumentit si dhe në kërkim të vazhdueshëm për të dhënat e duhura gjatë punës së grupeve punuese. Përveç kësaj, në diskutimet e hapura dhe shqyrtimet e organizuara publike ju ipet mundësia dhe opinionit të gjerë, me çrast arrihet plotësisht dhe gjithëpërfshirja si në skemën e paraqitur në figurën '1' në vijim.




Fig. 1. Skema e pjesëmarrjes (të ndryshohet sipas prezantimit)

QËLLIMI I HARTIMIT TË PLANIT

Zhvillimi i projektit për Hidrocentralin e Zhurit, ndërtimi i dy liqeneve dhe i rrjetit të kanaleve për bartjen e ujit, ndryshimi permanent i peizazhit të terrenit, zhvendosja e disa nga vendbanimeve, do të shkaktojnë ndryshime dhe transformime të mëdha në strukturën hapësinore dhe demografike të zonës. Në anën tjetër ofrimi i mundësive të reja në zonë përkrah aktivitetit energjetik, atij të turizimit kulturor dhe rekreativ, e bëjnë projektin e Planit Hapësinor për HC Zhurin edhe më sfidues.

Plani Hapësinor për Zonën e Interesit të Veçantë Ekonomik për Hidrocentralin e Zhurit do të qartësojë të gjitha sfidat zhvillimore për sukses të projektit dhe të zhvillimit të zonës në fjalë me rrethinë. Ky është njëkohësisht dhe qëllimi i hartimit të Planit. Plani **përkates** është i bazuar në dokumentet bazë për zonën në fjalë: Studimin e arësyeshmërisë për Hidrocentralin e Zhurit; Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+; Analizën hapësinore të komunës së Dragashit, Profilin socio ekonomik dhe fizik të komunës së Dragashit.

Sipas dokumentit të Studimit të Arësyeshmërisë (Elektroprojekt, Zagreb, 2008) detyrat e elaboruara janë:

1. Shqyrtimi dhe vlerësimi i të dhënave ekzistuese hidrologjike, hidroteknike dhe gjeologjike për zhvillimin e HC të Zhurit.
2. Shqyrtimi, vlerësimi dhe optimizimi i kapaciteteve të instaluar të centralit sikurse dhe vlerësimi/kompletimi i projektit detal inženjerik për Hidrocentralin e Zhurit.
3. Shqyrtimi dhe vlerësimi/kompletimi i arësyeshmërisë financiare dhe ekonomike e hidrocentralit të Zhurit, duke përfshirë mundësi dhe analiza financiare.
4. Përgatitja e VNM preliminare –Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis, përfshirë ndikimet tejkufitare, të ujërave, ujitjes dhe sigurisë së pendës e ndërlidhur dhe me kërkesat ndërkombëtare;
5. Përgatitja e VSM preliminare - Vlerësimi Social përfshirë dhe Draft Planin e Veprimt të Zhvendosjes.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Plani është ofrimi i bazës së masave, dispozitave dhe projekteve për zbatim të projektit të Hidrocentralit të Zhurit por dhe të zhvillimit të gjithëmbarshtëm social dhe ekonomik të Zonës, të informojë vendim-marrësit për mundësitë, opcionet dhe ndikimet e zhvillimeve. Plani Hapësinor për ZIVE të HC Zhur është dokument, i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Zonës me ato të Kosovës, duke tentuar zhvillim më të shpejtë ekonomik, përmirësim të kualitetit të jetesës, mbrojtje mjedisore krahas shfrytëzimit racional të resurseve, trashëgimisë natyrore e kulturore.

BAZUESHMËRIA DHE PROCESI I PLANIFIKIMIT

Plani Hapësinor për Zonën e Interesit të Veçantë Ekonomik "Hidrocentrali i Zhurit" bazohet në legjislacionin në fuqi, si dhe në praktikat dhe standardet ndërkombëtare. Baza ligjore mundëson përgatitjen e planeve hapësinore për zona të veçanta, të një regjimi të veçantë të organizimit, zhvillimit, shfrytëzimit, mbrojtjes, si dhe ruajtjes së identitetit socio-kulturor të Kosovës, të identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës.

Gjatë hartimit të planit është respektuar baza ligjore e sektorit të Mjedisit, Energjisë, legjislacionit tjetër relevant si dhe Udhëzimeve përkatëse të cilat burojnë nga këto ligje. Duhet theksuar se baza ligjore në Kosovë është e përafëruar në masë të kënaqshme me *acquis communautaire* të BE-së.

Gjatë hartimit të këtij Plani Hapësinor janë marrë për bazë këto ligje:

Ligji për Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14;
 Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03 / L – 025;
 Ligji mbi Ujërat nr. 2004 / 24;
 Ligji i Energjisë nr. 2004 / 8;
 Ligji për Rrugët nr. 2003/11
 Ligji mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L–139;
 Ligji për Tokat Bujqësore nr. 02/L ,
 Ligji i Ndërtimit 2004/15, etj.

Plani do të përfillë këto parime:

- Të ketë qasje të integruar, e cila përfshin elementet hapësinore të zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor, të infrastrukturës dhe politikave të tjera strategjike për territorin për të cilin nxirret Plani;
- Të sigurojë udhëheqje në territorin e gjerë të zhvillimeve me rëndësi strategjike dhe të trajtojë çështjet e rëndësishme strategjike (përqendrimi në më shumë se çështje lokale);
- Plani duhet të ketë parasysh kontekstin e gjerë hapësinor dhe duhet të ketë kujdes të veçantë për çështjet ndërkufitare;
- Plani duhet të jetë i shprehur në formën e cila lehtëson monitorimin dhe rishikimin (duke përfshirë rishikimin e pjesërishëm të strategjisë);

Përgjegjësit e sektorit energjetik në Kosovë

Ministria e Energjisë dhe Minierave - Përgjegjëse për hartimin e politikave që rrjedhin nga ligjet bazike për Energji Elektrike dhe miniera. Të gjitha vendimet, qëndrimet dhe studimet relevante, për këta dy sektorë, propozohen dhe ndërmerren nga MEM. Paralel me kompetencat e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, ekzistojnë dhe dy agjenci të pavarura, përgjegjëse për rregullimin e sektorëve përkatës: i) Zyra e Rregullatorit të Energjisë/përgjegjës për mbikëqyrje të tregut të energjisë, mbrojtjes së konsumatorëve të energjisë, licencimit të operatorëve energjetik, etj. dhe ii) Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale /përgjegjës për licencim të "Operatorëve Minerar.

Korporata Elektro-energjetike e Kosovës (Sh.A.KEK) - është ndërmarrje energjetike, e licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, dhe gëzon statusin e furnizuesit publik.

KOSTT- është Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, një subjekt i cili luan rol të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë.

PROCESI I PLANIFIKIMIT

Procesi i planifikimit, për hartimin e Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Hidrocentrali i Zhurit", fazat në për të cilat kalon si dhe vendimet e veprimet që mund të dalin gjatë zhvillimit tij, deri në miratim të Planit, paraqiten në fig. 2:




Fig 2. Procesi i planifikimit

Qeveria merr vendim dhe shpall si Zonë të Interesit të Veçantë Ekonomik, Zonën e Hidrocentralit të Zhurit. Me këtë rast, Qeveria obligon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të hartojë Planin Hapësinor për zonën e HC Zhuri, e cila përgjegjësi i delegohet Institutit për Planifikim Hapësinor. Pas hartimit të Planit Hapësinor, MMPH dorëzon dokumentin në Qeveri, e cila pas aprovimit e dërgon në Parlament për miratim final. Më tej Plani Hapësinor i ZIVE HC Zhur, si dokument nacional i miratuar, paraqet dhe shpreh përmbushjen si pjesë përbërëse të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ e që së bashku do të kontribuonin në Strategjinë e përgjithshme për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kosovës si dokument zhvillimor për vendin.

Grupi Punues Ndërmjësor i themeluar, për hartimin e këtij plani, i përbërë nga përfaqësues të Institucioneve të ndryshme merr parasysh strategjitë e ndryshme sektoriale, siç janë: Plani Hapësinor i Kosovës, Plani i Veprimit për Mjedis 2006–2010, Strategjia e Energjisë 2005-2015, Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë, dokumentet relevante mbi objektet dhe tërësitë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore si dhe nga sektorë tjerë.

STRUKTURA DHE FAZAT E PLANIT

Dokumenti i Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Hidrocentrali i Zhurit" përbëhet nga pjesa tekstuale, tabelare dhe ajo grafike, I ndarë në pesë faza:

- I. Profili hapësinor i zonës me interes të veçantë ekonomik HC Zhur dhe i cili përshkruan gjendjen ekzistuese mjedisore dhe sociale;
- II. Vizioni i dëshiruar për zonën me parimet dhe synimet e këtij Plani;
- III. Korniza e propozuar për zhvillimet e ardhshme hapësinore të planifikuara;
- IV. Strategjia e sugjeruar me masa, aktivitete dhe veprime për zbatimin e konceptit për zhvillimet e ardhshme, dhe
- V. Dispozitat për zbatimin e strategjisë së këtij Plani Hapësinor për HC Zhur.

I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

ANALIZA E GJENDJES, KONTEKSTI DHE VEÇORITË GJEOGRAFIKE

Hidrocentrali Zhur do të jetë hidrocentral akumulues-derivues, i cili do të ndërtohet në jugperëndim të Prizrenit, në pjesën e komunave të Prizrenit dhe Dragashit. Relievin e kësaj zone e përcakton mali Sharr dhe fusha e Prizrenit në rrjedhën e poshtme të Drinit të Bardhë. Zona më e ulët në këtë region është në lokalitetin Vërmicë në Drinin e Bardhë. Rrjedhjet e shumta ujore kanë rëndësi parësore në formimin e relievit. Territori i komunës së Dragashit ka një rrjet të dendur hidrografik, i cili i takon pellgut të detit Adriatik.



Ujërat të cilat do të shfrytëzohen në këtë sistem hidroenergjetik rrjedhin nga vargu i Malit Sharr, me pellgun kryesor ujqor, atë të rajonit të lumit Plavë me degët e tij, prej të cilëve më të rëndësishmit, lumi Brod dhe Restelicë. Në këto ujëra të përbashkëta lidhet edhe pellgu i lumit Çaljan me degët e tij. Ujërat e mbledhur në këtë rajon do të barten në sistemin e prurjeve të lumit Çaljan, lumit Restelicë dhe lumit Brod deri tek akumulimet e planifikuara në lumin Plavë dhe Breznë, i cili do të realizohet në luginën natyrore të Fushës së Llopshnikut.

Në bazë të të dhënave nga Instituti Hidrometeorologjik të Kosovës, prurjet mesatare ujore në pikën matëse në Orqushë janë 5.26m³/s. 3 Lumi i Plavës me degët e veta formon sistemin më të madh lumor dhe përfshin rreth 63 % të territorit të komunës së Dragashit.

Fig.3. Harta e pozitës gjeografike të lokacionit të HC Zhur

VEÇORITË NATYRORE DHE GJEOGRAFIKE

Klima - karakterizohet e mesme kontinentale, në vende të larta mbizotëron klima malore, ndërsa përmes Drinit të Bardhë depërton klima e ndryshuar mesdhetare. Ndikimi i Detit Adriatik përmes Drinit të Bardhë dhe barrierës malore të Sharrit, e cila pengon depërtimin e erërave të nxehta nga jugu dhe hapjen e këtij regjioni

ndaj veriut, ka kushtëzuar modifikimin e klimës, duke e bërë këtë më të llojlojshme.

Temperatura - Temperatura e ajrit është matur në stacionin meteorologjik të Dragashit, i cili ndodhet në zonën e ujëmbledhësit të lumit Plavë. Temperatura mesatare vjetore e ajrit ndryshon për periudhën 30 vjeçare (1949-1978), e cila është paraqitur në tabelë.

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	viti	
Dragashi	T.mes. min.	-7.0	-6.2	-1.6	4.2	9.8	13.0	15.9	13.5	10.5	4.7	1.4	-3.2	7.1
	T.mes. vjet.	-1.6	0.2	3.1	7.7	12.4	15.7	17.7	17.9	14.1	8.8	4.7	0.7	8.5
	T.mes.max.	1.7	4.8	7.0	10.4	16.1	17.9	20.5	22.1	16.5	11.8	9.3	4.8	9.5

Tab 1. Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore të ajrit të regjistruara në stacionin meteorologjik të Dragashit 4

³ IHMK - 1980-91

⁴ HPP ZHUR, Studim Multidisciplinar, Vlerësimi përfundimtar mjedisor, 2009




Fig.4.Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore në Dragash për periudhën 1949-1978

Temperatura e ajrit në Dragash është rreth 3,5 °C më e ulët se në Prizren, sepse Dragashi shtrihet në 1.100 metra mbi nivelin e detit dhe Prizreni në vetëm 435 m. Në Prizren temperatura mesatare vjetore e ajrit është 11,9°C, temperatura mesatare minimale 10,7 ° C dhe temperature mesatare maksimale 13,1 ° C.

Reshjet - Sasia mesatare vjetore e reshjeve në këtë hapësi është 958 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie në stinën e vjeshtës e më e vogël në verë. Këto ndryshime janë mjaft të theksuara dhe paraqesin problemin kryesor të përhapjes së reshjeve të kësaj hapësi.

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	VJETORE
Prizren	66	55	60	60	74	62	57	39	64	66	81	71	755
Zhur	90	75	90	70	85	63	59	48	80	80	111	107	958

Tab 2. Vlerat mesatare mujore dhe vjetore të reshjeve⁵ (1950-1978) (mm)




Fig.5.Vlerat mesatare të reshjeve 1950-1978

⁵ HPP ZHUR, Study-Multidisciplinary, Preliminary Environmental Assessment, 2009

Era - Pozita e mbyllur e Dragashit prej malit Koritnik në perëndim, dhe malit Sharr në lindje, ka kushtëzuar mbizotërimin e erërave vetëm në dy drejtime, prej veriut dhe jugut. Era veriore është përfaqësuar me 28.6%, ndërsa ajo jugore me 14.7%. Gati të gjitha stinët e vitit janë përfaqësuar me pjesëmarrje të njëjtë të rastisjeve të erës veriore. Në Prizren dominojnë erërat verilindore me 14.2% dhe erërat jugperëndimore me 14.2%. Në tabelën x është paraqitur shpejtësia mesatare mujore dhe vjetore e ernave (m/s) nga stacioni meteorologjik i Prishtinës dhe Prizrenit për vitin 1949.

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
Prishtinë	1.9	2.4	2.8	2.6	2.1	1.8	1.8	1.6	1.5	1.8	2.1	1.8	2.0
Prizren	1.5	1.8	1.9	1.9	1.6	1.8	1.6	1.5	1.3	1.2	1.3	1.3	1.6

Tab 3. Shpejtësia mesatare e erërave në Prishtinë dhe Prizren (1949) (m/s) *6

Lagështia relative e ajrit është matur nga stacioni meteorologjik i Dragashit, matjet janë bërë në vitin 1953, kur është vendosur stacioni meteorologjik.

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	viti
Prizren	82	75	70	64	63	62	59	59	67	74	79	83	70
Dragash	81	79	74	72	72	72	69	70	72	72	81	81	75

Tab 4. Lagështia relative e ajrit 7

Siç shihet nga tabela, mesatarja e lagështisë relative të ajrit në Dragash është 70 %, ndërsa në Prizren është 75 %.





Fig 5 . Lagështia relative e ajrit në Prizren dhe Dragash

Hidrografia - Territori i komunës së Dragashit ka rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të detit Adriatik. Lumi më i njohur në këtë zonë është lumi Plava, i cili njëherit është pellgu ujëmbledhës në këtë zonë. Lumi Plava dhe degët lumore përbëjnë pjesën kryesore hidrografike të zonës së veçantë „HC ZHUR“. Burojnë në shpatet e malit Sharr me lartësi mbidetare të ndryshme mbi 1700 - 2212m. Lumenjtë kanë luginë kompozite të ndërtuar nga pjesët e gjëra dhe ngushticat. Në këto pjesë lumi ka shtrat të ngushtë dhe lëvizja është relativisht i shpejtë.

Hidrografia për këtë zonë të veçantë është e ndarë në 8 ujëmbledhës kryesor me degët e tyre:

1. Lumi Qaljana / sipërfaqe ujëmbledhëse = 27.5km²
 2. Lumi Restelica / sipërfaqe ujëmbledhëse = 66.5km²
 3. Lumi Brod / sipërfaqe ujëmbledhëse = 73.1 km²
 4. Lumi Leshtan / sipërfaqe ujëmbledhëse = 9.2 km²
 5. Lumi Radeshë / sipërfaqe ujëmbledhëse = 23.7 km²
 6. Lumi Xërxë / sipërfaqe ujëmbledhëse = 4.8 km²
 7. Lumi Plavë / sipërfaqe ujëmbledhëse = 81.6km²
 8. Ujëmbledhësi Brezna sipërfaqe = 20.7km²
-
- Gjithsej sipërfaqe ujëmbledhëse = 307.1 km²



Të gjitha analizat janë kryer në mënyrë të saktë për periudhën që është shqyrtuar. Të dhënat bazi-ke janë bërë duke u bazuar në matjet e kryera në stacionin Orqusha mbi lumin Plavë, i cili gjendet mjaft larg nga zona dhe për shkak se të dhënat në dispozicion nuk kanë mundur të merren nga tregues hidrologjik, ato nuk mund të konsiderohen dhe si shumë të qëndrueshme.

Gjatë tridhjetë viteve të fundit ka pasur më pak të dhëna në dispozicion. Për stacionin Orqusha, nivelet mesatare ditore të ujit dhe rrjedhjet përka-tëse janë shënuar vetëm në Vjetarë Jugosllavë për vitet 1983, 1984, 1985 dhe 1986. Në kohët e fundit nuk janë kryer vajtme apo matje as në stacionin Orqushë, as në lumin Plavë e as në stacionet tjera të grumbujllimit. Për këtë arsye, të dhëna më të reja hidrologjike mungojnë, kështu që të gjitha konkluzionet janë nxjerrë në bazë të analizave të parashtrura në dokumentacionin që është shqyrtua.

Fig.7. Hidrografia dhe ndotja e ujërave në zonën e HCZhur

Shkarkimi mesatar në stacionin Orqushë në lumin Plavë për periudhën katërveçare (1983-1986) ishte $Q_{sr} = 4.30$ m³/s, periudhë kjo tepër e shkurtë për të nxjerrë konkludime. Për këtë arsye, rezultatet e paraqitura në dokumentacion konsiderohen si

reale dhe të pranueshme për periudhën e analizuar (1925/26-1978/79).

Në bazë të të dhënave si dhe studimeve të më hershme të projektit si dhe dokumentacionit të shqyrtuar për periudha kohore nga vitet 1925/1926 deri 1978/1979 janë dhënë këto rezultate sa i përket sasisë së prurjes së ujërave në ujërrjedha:

Lumi Çaljana	Q mesatare = 0.854 m ³ /s
Lumi Restelic	Q mesatare = 2.320 m ³ /s
Lumi Brod	Q mesatare = 2.380 m ³ /s
Procka Baç	Q mesatare = 0.042 m ³ /s
Lugina e Veliut	Q mesatare = 0.024 m ³ /s
Lugina eMarinit	Q mesatare = 0.054 m ³ /s
Procka Lubivie	Q mesatare = 0.027 m ³ /s
Lumi Leshtani	Q mesatare = 0.159 m ³ /s
Lumi Radeshe	Q mesatare = 0.731 m ³ /s
Lumi Xërxë	Q mesatare = 0.048 m ³ /s

Tab.6. Rrjedhat mesatare vjetore




Fig.7. Prurjet mesatare meter/kub

Të dhënat themelore për hidrografinë e sipërfaqeve të pellgut janë:

Sipërfaqja e pellgut $F= 307.10\text{km}^2$
 Reshjet mesatare vjetore $h=958\text{mm}$
 Rrjedhjet vjetore mesatare $Q= 8.84\text{m}^3/\text{s}$ dhe
 Volumi mesatar vjetor $V= 278.8 \text{ hm}^3$

Shtrirja e lumenjve në raport me territorin komunal konsiderohet e mirë ngase e përshkrojnë pothuajse në mes territorin, përveç lumit Qaljana që del nga territori komunal në brezin kufitar me Shqipërinë. Degët tjera për shkak të relievit të theksuar, kanë rrjedhje të shpejtë dhe shumica janë rrjedhje të përkohshme. Ujërat nëntokësorë kanë përhapje të kufizuar.

Nga analiza e hartës hidrogeologjike shihet se ka ujëra nëntokësorë rreth aluvioneve lumore që janë shumë të pakët . Ujëra karstik ka pak meqë shkëmbinjtë gëlqerorë janë pak të përhapur në këtë zonë. Ekzistojnë burime që kanë prurje të vogla, por ka mjaft për shkak të sasisë së reshjeve dhe terrenit malor.

Ndërtimi gjeologjik

Ndërtimi gjeologjik karakterizohet me formacione të vjetërsisë së Premianit, Triasikut të sipërm, të mesëm dhe kuaternarit. Pjesa më e madhe është e ndërtuar nga formacionet e Permo –Triasikut.

Permio- trasiku - depozitat e kësaj kohe e ndërtojnë shumicën e zonës. Në sipërfaqe janë të shprehur sendimente të varfër (Pelitet dhe Psamitet). Ndryshimi i shkallës së përbërjes dhe të metamorfozës së kompleksit të shkëmbit është shumë i ndryshuar, si dhe përbërja litologjike është e shumëllojshme, përkatësisht në zonën në mes të fshatit Dikancë dhe Kukulan.

Në këtë zonë kemi një zhvillim të pjesërishtë të metamorfizmit. Duke qenë se shumica e shkëmbinjve janë të mbuluar me produkte erozive është shumë vështirë dhe gati i pa mundur identifikimi i përbërjes litologjike.

Triasiku i Sipërm dhe Mesëm - Përfaqësohet me shkëmbinj karbonatik. Janë kryesisht masiv , gëlqerorë të metamorfizuar dhe gëlqerorë dollomitik. Karakterizohen me ngjyrë të bardhë, hiri dhe pjesërisht me ngjyrë të kuqe. Stratifikimi shpesh nuk është i theksuar dhe shkëmbinjtë janë të prerë në numër çarjesh. Këto depozite janë gjetur në zonën e veriut të fshatit Kukulan, në jug the lindje të fshatit Renc, dhe gati në tërë zonën prej rezervuarit të fushës së Lapushes deri në fshatin Zhur.

Kuaternari - Këto depozitime janë ndërtuar në tipe të ndryshëm gjenetikë, shpërndarja e sipërfaqes është e dominuar me depozitimet diluviale të tipit të shpatit, e përcjellur me depozitime poligjenike të tipit lacustrine, përderisa depozitat aluviale janë me shume te shprehura ne pjesët e poshtme të lumenjve.

Deponimet lacustrike - janë shfaqur në zonen në mes të fshatit Kukulan dhe Shainovac dhe në brigjet e lumit Plava. Ky është sediment argjile deri në lym me zhavorre. Shumica përmban deri 1m³ calcite gjysmë rrethi dhe blloqe kuartz të transportuara në ambientin lacustrine nga rrëqe te herë- pashershme.

Deponimet aluviale - janë ndërtuar në luginat e lumenjve dhe përrenjve. Litologjia e tyre është e shumëllojshme nga fuqia dinamike e ujit dhe nga litologjia e shkëmbinjve për rreth. Lugina e lumit Brod është e dominuar me blloqe vëllimi prej 2 m³ te shkëmbinjve vullkanik, me shkallë të lartë të shkëmbinjve të gjelbër metamorfik dhe shkëmbinj mermeri e dolomiti.

Resurset minerale - Zona e Sharr-Korabit - Në juglindje të ultësirës tektonike të Dukagjinit shtrihet gryka e Maleve të Sharrit, e cila dallon shumë nga rajonet tjera gjeotektonike të Kosovës. Në ndërtimin gjeologjik të zonës së Sharrit bëjnë pjesë formimet e Palezoikut dhe Triasikut.

Palezoiku është i përhapur në pjesët me të larta të Sharrit, i përfaqësuar me rreshpet albit-sericit-kloritike, kuarc-sericitike, fillitet sericit-biotitike, rreshpet e gjelbërta, fillitet, gnejset, thjerrëza të mëdha mermeri dhe gëlqerori të mermerizuar. Paraqiten edhe shkëmbinjtë granitoid, granodioritet, kuarc-porfirit dhe shkëmbinjtë e metamorfizuar diabaz-gabroid.

Triasiku është i zhvilluar në trajtën e dy serive rreshporo-karbonatike dhe vullkanogjeno-sedimentare. Në kohët e fundit janë bërë përpjekje që tektonika e Dinarideve dhe Karpato-Balkanideve, të shtjellohet nga pozicioni i tektonikës së pllakave. E përbashkëta e të gjitha mendimeve është se gjatë Mesozoikut një pjesë e madhe e Dinarideve dhe Helenideve ka përfaqësuar një apo më tepër mikrokontinente në Tetis.

Njësia e Drino-Ivanjicës përfshin terrenet e Bjeshkëve të pasura me ujë dhe Rogoznës jugore, pastaj Drenicën dhe rajonin Ferizaj-Shtime, në veri kufizohet me nënzonën e jashtme të Vardarit, në jugperëndim kufizohet me brezin e ofioliteve. Kufiri juglindor i kësaj zone me brezin e ofioliteve, kalon përgjatë kontaktit në mes të produkteve të Palezoikut dhe Triasikut të bjeshkëve të pasura me ujë, pastaj përgjatë skajit perëndimor të Basenit të Drenicës, në perëndim të Kaçanikut, drejt jugut.

Aspekti tektonik

Pjesa e lartë e mbulesës së tokës, pjesërisht e ndërtuar me sediment klastik, bën të pamundur identifikimin e elementeve tektonike që do të ishin të mjaftueshme për krijimin detal tektonik të imazhit në zonën e hulumtuar.

Mbetjet dhe çarjet, janë hasur në disa dalje në sipërfaqe, kryesisht në zonën në drejtimin veri lindje/jug perëndim, që është kryesisht më e shprehur në seksionin e rrugës mes fshatit Dikancë dhe Kukulanë. Në afërsi të fshatit Kukulan, është shumë i shfaqur kontakti tektonik në mes të Triasikut dhe Permian – Triasikut, qartësisht në mes të dy mbetjeve në drejtimin veriperëndim dhe juglindje. Lokacioni tjetër me elemente të qarta tektonike është jugu i fshatit Renc, ku gëlqerorët e Triasikut të sipërm me Permian trasic clastite janë në kontakt përgjatë dy sistemeve të mbetjeve. Është

vërejtur se mbetjet në veriperëndim dhe juglindje janë më të reja për shkak se i presin mbetjet në drejtimin verilindje-jugperëndim. Këto elemente janë të rëndësishme për parashikimin e kushteve gjeologjike për tunele.

Aspekti gjeologjik

Duke konsideruar aspektin gjeologjik-inxhinierik, shkëmbinjte në këtë zonë janë të grupuara në:


Shkëmbinj masiv – të cilët përfaqësohen nga amfibolet glukozane dhe shkëmbinjte e kuarcit. Në sipërfaqe këta shkëmbinj janë shumë të freskët.

Masa të favorshme që përfshijnë shkëmbinjte - filitet dhe rreshtet filitore, sericitet, muskoviti, kuarci, shistet kuarcore, mermeret dhe gëlqerorët dollomitikë. Sedimente metamorfike, të ekspozuar proceseve ekzodinamike dhe janë të mbuluar me shenja moti në lym dhe argjilë që përbëjnë një numër fragmentesh të bedrockut. Bazuar nga të dhënat e hulumtuara të marra nga kanalet e eksploruara, trashësia e pjesës së mbuluar nga moti nuk e tejkalon 1.2-2m. Këta shkëmbinj janë të karakterizuar me shkallë të lartë të ndryshimit metamorfik, dhe rrjedhimisht komponimi litologjik dhe karakteristikat inxhinierike gjeologjike, mund të ndryshojnë konsiderueshëm në drejtim vertikal dhe anësor.

Fig. 9. Harta gjeologjike e zonës së HC Zhur

Masat e varfëra të shkëmbinjeve - përfshijnë shkëmbinj me karakteri-stika fiziomekanike të dobëta. Shkëmbinjte janë filite - metamorfike të varfëra dhe të shkallëzuara nga lymi në shiste të argjilës, sedimente të varfëra metamorfike të lymit në argjilë. Duke konsideruar gjeologjinë inxhinierike, karakteristika bazë e theksuar e këtyre shkëmbinjeve janë ato fiziomekanike, të cilat ndryshojnë konsiderueshëm në kontakt me ujin.

Shkëmbinjte me karakteristika të mira inxhinierike gjeologjike - janë dominante, si amfibolitet, rreshtet e gjelbërta, filitet, shistet dhe rreshtet kuarcore. Në sipërfaqe të këtyre deponimeve janë të vërejtura rrëshqitjet, rëniet dhe pastrimet e thella të gurëve.






Fig.10. Harta seizmike për zonën e HC Zhur

RREZIQET NATYRORE

Sizmika - Bazuar në hartën sizmotektonike për periudhën 500 vjeçare, maksimumi i intensitetit në këtë zone është 8 shkallë. Relacionet funksionale dhe kulminacioni i përsheptimit të tokës për periudha specifike të përsëritura të kohës dhe fasiliteti jetësor jep vlerat e PGA dhe parametrat e dizajnit.

Rezultatet e analizave të theksuara ofrojnë të dhëna të domosdoshme për kalkulime strukturale bazuar në rregullat e standardeve teknike për ndërtimin e konstruksioneve në zona seizmike. Nëse kalkulimet bazuar në eurokode 8 zbatohen, studimi IZIS do të përdoret për të përkrahur dokumentacionin në baza ku forcat seizmike mund të kalkuloohen sipas eurokodit 8.

Erozioni - Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon në sipërfaqet bujqësore dhe në vendbanime. Rreth 6000km² ose 56% e territorit të Kosovës është e rrezikuar nga erozioni, dukuri kjo natyrore që i takon shkallës së I,II dhe III të erozionit⁸. Edhe në territorin e Dragashit është prezent erozioni që rrezikon me humbje të tokës bujqësore dhe dëme të mëdha në ekonomitë familjare.


Në bazë të të dhënave, shkallë të lartë të rrezikshmërisë erozive paraqesin 14575ha ose 24%e sipërfaqes së komunës së Dragashit, ku shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri.

Shkalla e erozionit	Sip.ha	%
Pa erozion		
Erozion shumë i dobët	11765.47	27.5
Erozion i dobët		
Erozion i mesëm	16651.59	38.5
Erozion i fortë	8682.43	20.1
Erozion shumë i fortë	5893.38	13.9

Tab.8.Shkalla e erozionit

⁸ (I-erozion shumë i fortë, II-erozion i fortë dhe III-erozion i mesëm)

Zonat më të rrezikuara ne Komunën e Dragashit janë: Zona e fshatit Restelicë, Zilipotoku, Krushevë, Brod, Gllboçicë, Baçkë, Dikancë, Mlikë, Kukljan, Leshtanë, Vranishtë, Xërxë, Pllajnikë dhe Rrenc.



Faktorët që ndikojnë në shkallën e lartë të erozionit janë:

- I. Kushtet meteorologjike;
- II. Pjerrtësia e terrenit;
- III. Përbërja gjeologjike;
- IV. Flora dhe fauna; dhe
- V. Shfrytëzimi jo racional i pyjeve

Fig.11. Harta erozive në zonën e HCZhur


**MJEDISI
DHE SHFRYTËZIMI TOKËS**

Shfrytëzimi i tokës për zonën me interes të veçantë, ka rëndësi të madhe dhe nënkupton llojin e përdorimit (apo destinimin) e sipërfaqe-ve ose nxënien e sipërfaqeve tokësore sipas sektorëve nga të cilët shfrytëzohen ato. Nga vlerat e paraqitura (të shpre-hura në Ha ose %), mund të nxirren raporte të ndryshme ndërmjet sektorëve (p.sh. shtrirja e infrastrukturës ndaj zonës së vendbanimeve; apo nxënies së tokës me sipërfaqe të ndërtuar kundruall sipërfaqeve me tokë bujqësore ose pyjore, etj).

Informatat e shfrytëzimit të tokës shërbejnë dhe tregojnë raportin në mes përdorimit nga shfrytëzues të ndryshëm, kurse krahasimi tjetër i mundshëm, është ai që bëhet përbrenda një sektori para dhe pas projektit. Me qëllim të planifikimit me të lehtë dhe realizimit më pak kushtues, të zhvillimeve të ardhshme, duke kursyer në shpronësime të shumta, informatat për pronësinë kanë rëndësi të madhe, të asaj private dhe publike në zonën e interesit.

Nga harta shihet se 56.3 % e territorit të zonës së interesit është me sipërfaqe pyjore (pyje dhe shkurre) dhe toka bujqësore (ara, livadhe dhe kullosa), që kanë rol dominues në aspektin e shfrytëzimit të tokës, ndërsa sipërfaqet e ndërtuara (vendbanimet dhe infrastrukturë rrugore, socia-le, ekonomike, të shërbime-ve etj) janë 5 %.

Fig.12. Shfrytëzimi i tokës në zonën e interesit "HC Zhur" sipas përdorimit (IPH)




Sipërfaqet pyjore

Sipërfaqet e mbuluara me pyje, shtrihen në 1488 ha dhe janë relativisht më të vogla se ato me shkurre prej 1646 ha, që së bashku gjithsejt përbëjnë 3134 ha ose rreth 56 % nga sipërfaqja e tërësishme e zonës së interesit. Pyjet, përbërja e të cilave është nga drunjtë halorë gjenden në lartësitë mbidetare deri në 2000 m, kurse ato të përbëra nga drunjtë gjethrënës gjenden prej në mes 900 – 1400 m. Këto potenciale pyjore, me florën dhe faunën mund të shërbejnë për zhvillimin ekonomik përmes turizmit shkencor, rural, malor, shëndetësor si dhe me mbledhjen e bimëve mjekuese të rralla dhe bimëve industriale.

Shfrytëzimi tokës në zonën "HC Zhur"	Sipërfaqja (ha)	(%)
Tokë Pyjore (pyje dhe shkurre)	3134	56.3
Tokë Bujqësore (ara+livadhe+kulloso)	2155	38.6
Sipërfaqe e ndërtuara (Vendbanimet dhe infrastruktura rrugore)	280	5.0
Sipërfaqe Ujore (liqeni)	5	0.1
Gjithsejtë:	5574	100

Tab.9. Shfrytëzimi i tokës në zonën e HC Zhur



Toka bujqësore

Në zonën me interes të veçantë ekonomik për HC Zhur, kryesisht përdoret për bujqësi, ku arat, livadhet dhe kullostat së bashku zënë rreth 39 % ose 2155 ha të territorit.

Kullostat dhe livadhet - që së bashku marrin 1223 ha ndahen në ato të larta dhe të ulëta, në bazë të nivelit, rreth lartësisë mbidetare 1500m, që shfrytëzohen 3-4 muaj respektivisht 6-7 muaj, varësisht nga kushtet klimatike. Këto kullostat dhe livadhet janë potencial për zhvillimin e blegtorisë në veçanti dhe paraqesin përparësi për zhvillim ekonomik në përgjithësi me prodhimin dhe procedimin e produkteve të mishit dhe qumështit.


Fig.13. Shtirja hapësinore sipas kualitetit të tokës bujqësore në zonën e "HC Zhur"

Arat - të cilat dominojnë në strukturën e tokës së punueshme dhe shtrihen në 932 ha, janë kryesisht natyrore kurse me pak të mbjella. Nga kulturat që mund të mbillen në ara, bazuar dhe në kushtet klimatike të zonës, paraqesin potencial që mund të përdoren për kultivimin e patates, të thekrës dhe më pak të grurit dhe misrit, por dhe të perimeve në sipërfaqe më të limituara.

Toka është me përmbajtje gëlqerore dhe të argjilës, kurse tokat pjellore për nga kualiteti, të shprehura sipas bonitetit, janë të paraqitura me shtirjen e tyre hapësinore në zonën e interesit si më poshtë, në fig. 13.

VENDBANIMET/BANIMI

Hapësirat e ndërtuara, për nevoja strehimi apo veprimi të popullatës, vendbanimet në kuadër të zonës së interesit të zonës së ardhshme për HC ZHUR, zënë rreth 5 % të sipërfaqes së tërësishme të kësaj zone, gjegjësisht shtrihen në 280 ha.



Vendbanimet të cilat gjenden në këtë zonë të interesit, janë kryesisht vendbanime të karakterit rural, fshatra të banuara me popullsi që merret kryesisht me veprimtari bujqësore. Po ashtu, lokacionet e objekteve për nevoja të industrisë, tregtisë dhe të shërbimeve sociale dhe turistike, me të gjitha hapësirat përcjellëse së bashku, kanë sipërfaqe të vogël në kuadër të Zonës së interesit të veçantë HC Zhur.

Fig.14. Shtrirja e vendbanimeve sipas zonave në HC Zhur (IPH)

Vendbanimet në kuadër të zonës së interesit "HC Zhur", në bazë të ndikimeve që kanë dhe mënyrës së veçantë të trajtimit që kërkohet për to, ndahen në dy zona:

i) Zona qendrore (Zona e ardhshme për akumulim të ujit) – Kemi të bëjmë me vendbanimet që ndikohen drejtpërdrejtë nga zhvillimet e ardhshme hapësinore në favor të krijimit të mundësive për grumbullimin e ujit të cilat i takojnë Komunës së Dragashit: Breznë, Buçe, Plavë, Zym, Bellobrad dhe Kapër.

ii) Zona e gjërë (bartja e ujit) – Kemi të bëjmë me të gjitha vendbanimet tjera që janë në zonën me interes të veçantë ekonomik HC Zhur dhe ndikohen në mënyrë indirekte nga infrastruktura e ardhshme për hidrocentral të Zhurit (objektet-elementet për përcjelljen e ujit përmes kanaleve të hapura apo të mbyllura ose tuneleve), ne Komunën e Prizrenit – Zhur dhe Dobrushtë – ne Komunën e Dragashit – vendbanimet Rrencë, Shajnë, Dragash, Lubovishtë, Kukjan, Dikancë, Gllloboqicë dhe Krushevë.

NDOTJA DHE DEGRADIMI I MJEDISIT

Ajri – Është njëri nga mediumet mjedisore kryesore në përhapjen e ndotjes, efekti i të cilit në mënyrë direkte dhe indirekte ndikon në ekonominë, shëndetin e njeriut, pastaj biodiversitetin dhe përbërësit e tjerë mjedisor. Mungon ende monitorimi i indikatorëve të përcaktuar me Ligjin e ajrit, përderisa si pasojë të dhënat nuk janë të plotësuara. Sa i përket lokacionit ku planifikohet të ndërtohet hidrocentrali dhe në komunën e Dragashit, në përgjithësi kemi mungesë të të dhënave për sa i përket ndotjes së ajrit, por duke u bazuar nga vizita që është bërë në teren si dhe vlerësimi që ju ka bërë kësaj zone vërehet se ajri nuk është i ndotur pasi që shkalla e urbanizimit nuk është e lartë dhe sektori industrial nuk funksionon, duke pasur parasysh që këta janë shkaktarë kryesor të ndotjes së ajrit pa e lënë anash edhe komunikacionin i cili shkakton ndotjen në zonat urbane.

Toka – Ndikimet e vazhdueshme që bëhen nga aktivitetet njerëzore sjellin deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja sociale dhe ekonomike. Sipërfaqet tokësore të destinuara për vendosjen e rezervarëve për grumbullimin e ujit të nevojshëm për ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit kanë struktura të ndryshme dhe përmbajnë shumë humus.

Duke u bazuar nga studimi i bërë për këtë zonë mund të konstatojmë se shkaktarë kryesorë të ndotjes së tokës janë përdorimi i plehrave kimik, pesticidet, insekticidet dhe fungicidet për nevojat e sektorit të bujqësisë. Shkaktar tjetër i ndotjes është edhe hedhja dhe grumbullimi ilegal i mbeturinave në shumicën e vendbanimeve dhe atë në vendet ku nuk kanë qenë të destinuara për këtë qëllim dhe kjo ndikon në përkeqësimin e gjendjes mjedisore. Sidomos është shqetësuese dukuria e zënies së sipërfaqeve të tokave të punueshme, me mbeturina si dhe hedhja e mbeturinave pranë brigjeve të lumenjve; Plavë, Radeshë, Leshtan dhe Brod.

Dukuritë e tilla ndikojnë edhe në dëmtimin e peizazheve dhe ekosistemeve. Në komunën e Dragashit gjendet deponia komunale me madhësi 1.2 ha, me kapacitet total prej 50.000m³, ndërsa kapaciteti mujor 20 tonë. Kjo deponi nuk i plotëson kushtet pasi që gjysma e saj nuk është e mbuluar me shtresën izoluese si dhe ujërat e zeza nuk kanë asnjë tretman.

Uji - Kontaminimi i ujërave dhe mbrojtja e tyre - Edhe pse ekziston një deponi sanitare për komunën e Dragashit, e cila gjendet në afërsi të fshatit Brezna, ndotësit e mundshëm potencial të ujit në zonë, janë deponitë ilegale, të cilat gjenden sidomos përgjatë brigjeve të lumenjve, paraqesin rrezik permanent për përhapjen e sëmundjeve të ndryshme gjatë stinës së verës si dhe krijojnë një pamje të padëshirueshme. Kjo dukuri është rezultat i nivelit të ultë të popullatës për ruajtjen e mjedisit si dhe angazhimit të komunës për menaxhimin e mbeturinave. Zona nuk është e lidhur në rrjetin e sistemit të kanalizimit, prandaj shkarkimi i ujërave të zeza dhe reshjeve atmosferike bëhet përmes çarjeve të tokës që depërtojnë në lumenj dhe janë ndotës potencial ujit.






Fig.15. Degradimi i lumenjve në zonë

Mirëmbajtja joadekuate e gropave septike paraqet problem tjetër të cilat gjenden rreth 50 sosh në Zym , 150 në fshatin Breznë, ndërsa në fshatin Buçe në largësi prej 1,5 km gjinden rreth 50.

Në fazat e ardhshme të projektimit është i nevojshëm identifikimi i deponive ilegale në projektin e planifikuar të objekteve në bazë të karakteristikave të tokës.

Fig. 16. Harta e ndotjes së lumenjve në zonën e HC Zhur



Biodiversiteti

Flora - Zona e planifikuar për hidrocentralin e Zhurit i takon zonës së maleve të Sharrit dhe Koritnikut, në lartësi mbidetare mbi 952 metra dhe është nën ndikimin e klimës malore që karakterizohet me dimra të gjatë dhe me periudhë të shkurtër vegetative. Ajo është e lidhur ngushtë me kushtet klimatike dhe llojet e tokës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e botës bimore në këtë territor. Zona është e mbuluar me livadhe, pyje si dhe lloje të ndryshme bimore, të cilat paraqesin burime të rëndësishme të natyrës.

Mbulesa e ulët e bimëve përfshin këto lloje: aguliqet (*Primula veris*, *Primula acaulis*), (*Geranium pratense*, *G. macrorrhizum*), (*Pulmonaria officinalis*), (*Campanula moesica*, *C. pusilla*), shpatore (*Iris variegata*), luleshtrydha e egër (*Fragaria vesca*), manaferra (*R.hirtus*, *R idaeus*), (*Achillea millefolium*), (*Galium verum*), (*Tanacetum vulgare*), zhabinorja (*Ranunculus sp.*), (*Aconitum napellus*), (*Veratrum album*), (*Saxifraga umbrosa*), (*Carlina acualis*), (*Geum montanum*), manushaqja, (*Viola sylvestris*), (*Veronika chamedrys*), (*Symphytum officinale*), (*Alliaria officinalis* etj).

Nga sipërfaqja e përgjithshme e territorit 4,53 % janë sipërfaqe të mbuluara me livadhe, 69,6 % me kullosa, 11,5 % me pyje, 12,7 % me ara dhe vetëm 1,6 % është sipërfaqe pa vegjetacion, e cila mbulon një sipërfaqe mbi 70 % të hapësirës dhe gjendet në afësi të vendbanimeve.

Ekzistojnë katër breza vegjetativ:

Brezi i pyjeve gjethërrënëse – Këto lloje janë të shkapërderdhura nëpër tërë territorin e komunës. Në këto pyje rriten lloje të ndryshme të drunjve dhe bimëve tjera. Llojet e drunjve më të përhapura janë: ahu, lajthia, mështekna, dushku, thana, verri, dëllinja, shkoza, panja, vidhi, plepi etj. Ndërkaq nëpër lugina të lumenjëve janë të përhapura: verri, shelgu, rakita dhe plepi i butë. Llojet e bimëve më të përhapura në këtë brez janë: lulevjollcat, vjollca trengjyreshe, trumëzat, hithi i vdekur, shakullorja, bukuroshja, lulëpranvera, trëndafil i egër, lulëdredhëza, kulpera, gjerokulli vjeshtor, lulëmal, lulëbora etj.

Brezi i pishave – Ky brez shtrihet në mes të pyjeve gjethërrënëse dhe kullosave. Drunjtë e këtij brezi i takojnë dy familjeve, pinaceae dhe polypodiaceae, të cilat kryesisht shtrihen në shpatijet e malit të Koritnikut dhe në Krushë. Nga familja e parë më të përhapura janë: pisha e zezë (*pinus nigra*), pisha e bardhë (*pinus silvestris*) dhe bredhi apo (*abies alba*). Ndërsa nga familja e dytë janë të përhapura fieri i ëmbël apo i butë dhe fieri i blertë.

Brezi i bashkësisë së livadheve – Livadhet kryesisht shtrihen në afërsi të vendbanimeve, pavarësisht nga lartësia mbidetare. Bimët më të përhapura në livadhe janë: graminoret, zhabinoret, trëndafilat, shevarët, flokëzat, lulet e bardha, kamomilja, luledhëmbi, pelimi, lulëkuqja, trëndafilja e egër etj.

Brezi i kullosave – Kullosat janë pasuria më e madhe natyrore mbitokësore e territorit të komunës. Dallohen disa tipe të kullosave:

Nareditum Stricas – Ky tip përfshin rreth 33,2% të sipërfaqes së kullosave. Në përbërje ka rreth 52 lloje të bimëve dhe ka kualitet mesatar.

Festucetum Halleri – Ky tip përfshin rreth 26 % të sipërfaqes së kullosave. Këto kullosa shtrihen në lartësi të mesme dhe të larta. Në përbërjen e tyre marrin pjesë rreth 56 lloje të bimëve dhe konsiderohen si kullosat më kualitative të maleve të Sharrit.

Poestum Violacea – Ky tip përfshin rreth 13 % të sipërfaqes së kullosave, dhe shtrihet në lartësinë mbidetare mbi 2000 m, e cila në përbërje ka rreth 48 lloje të bimëve.

Festucetum Spadicea – Marrin pjesë me rreth 10,3 % nga sipërfaqja e përgjithshme e kullosave. Janë kullosa kryesisht të përhapura në terrenet e pjerrëta dhe të ekspozuara diellit. Në përbërjen e tyre marrin pjesë rreth 26 lloje të bimëve.

Përgjithësisht bimët e territorit dallohen me ngjyra atraktive, aromë të këndshme dhe fruta të shijshme, më së shumti boronica, pastaj mbi 60 lloje të bimëve mjekësore, aromatike dhe lloje të tjera të bimëve të rëndësishme për industrinë farmaceutike, që mbulojnë tërë territorin e komunës. Disa nga bimët që rriten në territorin e komunës janë: Ylli i Alpeve (*Leontopodium Alpinum*), Troliu European (*Trolius Europius*); Boronica (*Vaccinum Myrtilus*), Saneza (*Gentiana Lutea*), etj.

Fauna - Të dhënat për llojet e shtazëve, të mbrojtura dhe të rrezikuara në zonën e hulumtimit janë të mangëta. Duke u bazuar në vizitat që janë bërë në terren si dhe pas rishikimit të dokumentit të Studimit të Arsyeshmerisë për zonën e planifikuar për ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit, në aspektin faunistik mund të konstatojmë se ekosistemet e maleve dhe pyjeve të larta sigurojnë kushte të favorshme të jetesës për llojet e ndryshme të shtazëve, veçanërisht zogjve dhe gjitarëve të cilët janë të rëndësishëm për gjueti. Ndër llojet më të përhapura të shtazëve janë: dhëpëra, ujku, lepuri, kitra, shqarshi, ariu, dhitë e egra, kaprojtë dhe derrat e egjër.

Shpezët më të përhapura janë: harabeli, pëllumbi, korbi, sorra, laraska, fëllënza, dallëndyshja, kukuvajka, hutini, petriti, shqiponja, skifteri si dhe llojet e peshqëve.

Pyjet - Pyjet si burime të ripërtëritshme të natyrës paraqesin terrenin me ekologjik në mjedis dhe konsiderohen pasuri kombtare të cilat duhet të menaxhohen nga aspekti ekonomik, mjedisor dhe mbrojtës, kanë efekt direkt ose indirekt në zvogëlimin e dukurive ekstreme klimatike.

Pyjet shtrihen kryesisht jashtë zonë ku është planifikuar ndërtimi i HCZH, me përjashtim të shtresës më të vogël në zonën e rezervarit të Plavës i cili përfshin 2 hektar pyje, ndërsa në zonën e rezervuarit Brezna nuk ka pyje vetëm disa pemëve individuale.

Në zonën e hulumtimit në komunën e Dragashit pyjet janë të menaxhuara nga tri njësi ekonomike Bredhiku – Jellaku, Opoja dhe Koritniku II.

Komunat	No	Njësia ekonomike	Zona në hektar
Dragash	1	Çestaku – Jellaku (Bredhiku)	2800
	2	Opoja	4600
	3	Koritniku II	2700
	4	Pyje private	1600
Total Dragash			11700
Prizren	1	Koritniku I	5500
	2	Pyje private	400
Total Prizren			5900
Totali			17600

Tab.10. Zonat pyjore sipas njësisë ekonomike

Nga tabela shohim se pyjet mbulojnë 17.600 hektar tokë në zonën e gjërë të hulumtimit, prej të cilave disa 11.700 hektar në zonën e Dragashit dhe 5900 hektar në zonën e komunës së Prizrenit.

Komuna	No	Njësia ekonomike	Zona në ha	Volumi	Rritja vjetore	Prerjet vjetore
Dragash	1	Çestak-Jellaku (Bredhiku)	2800	130000	6000	2000
	2	Opoja dhe sipërfaqja a tokave pyjore të Sharrprodhimit	3600	110000	3500	1800
	3	Koritnik II	3700	420000	17000	3000
	4	Pyjet private Dragash	1600	75000	900	500
	Totali		11700	735000	27400	7300
Prizren	1	Kortinik I	5500	255500	7559	3520
	2	Pyjet private Prizren	400	18000	230	120
	Totali		5900	273500	7790	3640
Totali i përgjithshëm			17600	100850069	391900	10940

Tab. 11. Zona e pyjeve, vëllimi, shtimi dhe prerjet vjetore

Në tabelë është paraqitur zona a pyjeve, vëllimi, shtimi dhe prerjet vjetore. Rritja vjetore e pyllit në zonën e hulumtimit është rreth 391 900 m³, prej të cilave 274.000 m³ janë pyje afër zonës së Dragashit.

Prerja vjetore e lejuar është 10.940 m³, prej të cilave 7300 m³ e pyjeve është afër zonës së komunës së Dragashit, përderisa rritja vjetore e pyllit prej 23 m³/ha është mjaft e mirë.

Në rajonet më të larta të zonës së gjërë të Dragashit gjenden këto lloje pyjore:

- Lisi dhe pyjet e shkozës (Querceto carpinetum),
- Pyjet e dushkut Sessile-austriake (Quercetum petraeae-cerris),
- Pyjet e dushkut (Querceto-carpinetum cerris),
- Pyje e ahut (Faginetum montanum),
- Pyjet e bredhi (Abietum alba),
- Pyje e pishave (Pinetum heldreichii).

Një lis meso-xerophilous dhe pylli i shkozës (Querceto-carpinetum) mbulojnë zonat e ulët të Opojës të njësive ekonomike që ndodhet në perëndim të rezervarëve të planifikuar. Zonat e larta të njësive ekonomike janë të mbuluara nga një lloj i pyjeve të ahut (Fagetum montanum).

Një dushk meso-xerophilous sessile (*Querceto carpinetum cerris*) mbulon fushën e Çestak - Jellaku (Bedhiku) njësia ekonomike e vendosur në zonën e lumenjëve Brod dhe Restelic. Zonat e larta të kësaj njësie ekonomike janë të mbuluara nga pyje të ahut (*Fagetum montanum*) dhe rajonet më të lartë të kësaj njësie ekonomike janë të banuara nga pyjet e bredhit (*Abietum alba*).

Njësia kortitnik II ekonomike të vendosura në zonën në perëndim të rezervarit Brezna karakterizohet nga mesophilous e pyje të ahut (*Fagetum montanum*) mbulon zonat e ulta dhe llojet e pishave (*Pinetum heldreichii*) që mbulojnë zonat më të lartë të kësaj njësie ekonomike.

Njësia ekonomike e Opojës, zonat e ulta të njësisë ekonomike karakterizohen nga pyjet e dushkut dhe shkozës (*Querceto - carpinetum*), por dominojnë llojet e lisit sessile (*Quercus petraeae*) dhe pisha e zezë (*Pinus nigra*), por përfshin edhe disa lloje të shkoza (*Carpinus betulus*), qershia e egër (*Avium cerasus*), frashëri (*Fraxinus ornus*), panjë (*Acer pseudoplatanus*), pemë të egra (*Sorbus torminalis*), dardha e egër (*Pirus piraster*), molla (*Malus silvestris*) etj.

Nga shkurre, dëllinja (*Juniperus communis*), thana (*Cornus mas*), shtogu (*Sambucus nigra*), lajthia (*Corylus avellana*) etj.

Njësia ekonomike e Çestak-Jellaku (Bredhiku). Shtresa e parë e pyllit përbëhet nga llojet e dushkut sessile (*Quercus petraea*) dhe shkozës (*Carpinus betulus*), ahu (*Fagus silvatica*) frashëri (*Fraxinu ornus*) panjë (*Acer pseudoplatanus*) pemë të egra (*Scrobus torminalis*) qershia pyll, thana (*Cornus mas*) etj.

Shtresa e dytë e pyllit përbëhet nga llojet e larta të lisit, (*Betula pendula*), ahu (*Fagetum silvaticum*), (*Alnus glutinosa*), panje (*Acer sp.*). Prej shkurreve gjenden: trëndafili i egër (*Rosa canina*), shtogu (*Sambucus nigra*), murrizi (*Crataegus monogyna*), murrizi (*Crataegus pentagyna*), dëllinja (*Juniperus comunis*) etj.

Njësia ekonomike e Koritnikut I shtrihet në zonën e komunës së Prizrenit, ku dominojnë llojet e ahut (*Fagetum montanum*) me 38.5%, bredhi (*Abietum alba*) 19%, dushku (*Quercus cerris*) 9% dhe (*Pinetum heldreichii*) me 5%.

Njësia ekonomike Koritniku II, në zonën e komunës së Prizrenit që përfshin zonën ku është planifikuar ndërtimit i hidrocentralit të Zhurit I dhe II gjenden këto lloje të pyjeve:

- Lisi (*Orno polyquercetum*)
- Shkoza (*Ostyeto-carpinus orientalis*)
- Pyjet e dushkut, lisi Sessile-austriake (*Quercetum petraeae-cerris*)
- Pyjet e ahut (*Fagetum montanum*)
- Pyjeve e shkozës dhe ahut (*Aceri ostryo - Fagetum*)
- Pyjet e ahut dhe bredhit (*Fageto - abietum*)
- Pyjet e pishes (*Pinetum heldreichii*)

Gjuetia - Pjesa ku është e zhvilluar gjuetia shtrirë në një lartësi deri në 1000 metra mbi nivelin e detit është nën ndikimin e klimës mesdhetare, kurse pjesët tjetër mbi 1000 metra mbi nivelin e detit janë nën ndikimin e klimës kontinentale. Klubi i gjuetarëve nga Dragashi ka 400 anëtar, prej tyre 80 janë aktiv në gjueti. Klubi i Sharrit në Prizren ka 150 anëtarë, prej të cilëve 30 janë aktiv në gjueti. Terreni i gjuetisë mbulon një sipërfaqe prej rreth 21.000 hektar edhe pse lartësia mbi nivelin e detit është ndërmjet 716 dhe 2619 metra, shtrihet në terren gjuetie per pjesen me te madhe ne një lartësi mbi 1000 metra mbi nivelin e detit.

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE

Trashëgimia kulturore

Territori i komunës së Dragashit është i pasur me objekte të trashëgimisë kulturo – historike që nga periudhat më të lashta të saj. E kaluara historike e Komunës së Dragashit të sotëm nuk mund të shikohet e ndarë nga Prizreni dhe rrethina e tij, për shkak të lidhjes së ngushtë me qytetin, si pjesë përbërëse e tij.

Në Opojë dhe në Gorë ka mjaft gjëmatra të vendbanimeve të vjetra, disa prej të cilave u kanë humbur gjurmët e disa prej tyre u ka mbetur vetëm emri si p.sh. "Zinova" si qytet i lashtë, në afërsi të Bellobradit ku gjenden gjurmët e lokalitetit të lashtë "Gostil" dhe gjurmë të ngjashme të cilat i hasim dhe në afërsi të fshatit Brut.

Rëndësi të veçantë ka pasur rruga e ndërtuar në periudhën romake Tetovë – Shkodër – Lezhë, e cila ka kaluar nëpër malin Sharr dhe qyteti antik "Zinova" supozohet të ketë pasur rolin e qendrës regionale tregtare. Në periudhën e mesjetës Opoja, Gora dhe Zgatarë kanë qenë si qendra të rëndësishme tregtare dhe zejtare.

Në periudhën osmane shumë vendbanime kanë fituar fizionominë e qendrave të fuqishme ekonomike, edhe atë duke ndërtuar një numër të madh të objekteve fetare, rrugëve, ujësjellësve, kanalizimeve, spitaleve etj.

Kukli Begu (në shek.XVI) ishte personalitet që ndikoi në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të kësaj treve. Ai ndërtoi xhaminë dhe tyrben pranë saj, të cilat edhe sot ekzistojnë dhe kanë status të mbrojtjes. Ka ndërtuar sarajin (shtëpinë e bejlerëve), ujësjellësin dhe "Çeshmen e Sarajit", tunelin nëntokësor që një kohë e ka lidhur sarajin me xhaminë, namazxhahun, hamamin e shumë objekte të tjera të cilat janë shkatëruar dhe janë në shkatërim e sipër.




Fig.17. Namazxhahu, monument i mbrojtur



Fig.18. Valanica - objekt unikat në Kosovë

Sot monumentet me trashëgimi kulturo – historike të kësaj komune pothuaj se janë harruar në tërësi. Kërkesë nga niveli komunal është që të themelohet një muze komunal historik, kulturor dhe etnografik ku do të mund të shpaloset e kaluara e kësaj ane. Sa i përket objekteve të trashëgimisë kulturore, sipas të dhënave nga tabela më poshtë, kryesisht dominojnë xhamitë (27 sosh), tyrbet (5 sosh), gjëmatra të kalave (3 sosh) dhe objekte të tjera (tuma, kroje, mullinj etj.). Për mundësinë e zhvillimit të turizmit kulturor, problem kryesor janë rrugët të cilat nuk janë të asfaltuara dhe mundësia e arritjes në monumente të caktuara është e vështirë.



Fig.19. Xhamia e Kukli Begut, monument i mbrojtur

Monumentet që kanë status të mbrojtjes në komunën e Dragashit janë :

Xhamia e Kukli begut – xhami e një rëndësie të madhe historike të kësaj ane, mirëmbahet nga njerëzit që jetojnë në afërsi të saj. Rruga nuk është e asfaltuar dhe qasja nuk është e përshtatshme,

Mbetjet e objekteve fetare islame ("Namazxhahu") – të cilit mund t'i humbasin gjurmët nëse vazhdon të mos ketë kontrollë, janë mbetjet e kalasë në kodër "Hisarlishte".

Pasuritë kulturore dhe historike¹⁰ të zonave të hulumtuara për arsye të ndërtimit të hidrocentralit Zhur, bazuar në të dhënat nga institucionet përkatëse të Kosovës për vendbanimet Brezne, Zym, Buqe, Plavë dhe Zhur, Shkozë, Mirzë dhe Vërmicë, kanë identifikuar këto objekte:

Brezne – 5 shtëpi, varrezat e krushqve, varreza të vjetra, 1 xhami;

Plavë – 4 shtëpi, 1 Teqe e bektashinjve, 1 xhami, varreza;

Në Buqe – 1 shtëpi, 1 xhami, varreza; Zym – 1 xhami; Zhur – 3 shtëpi dhe 1 xhami; Vërmicë – 4 shtëpi të vjetra, 2 shtëpi dhe 1 xhami; Shkozë – gërmadha të manastirit të Shën Jeronimit

Vendbanimi		Trashëgimia kulturore	
		Monumentet e trashëgimisë kulturore që kanë status dhe janë të propozuara për mbrojtje	Periudha, shekulli, viti
1	Brut	gërmadha të kalasë	mesjetare
		Xhami	shek.XX
		Xhami	shek.XX
2	Zaplluzhe	Tuma	parahistori
		Xhami	shek.XIX
3	Zinovë	gërmadha të kalasë	mesjetare
4	Bresanë	gërmadha të kalasë	mesjetare
		Xhami	shek.XVIII
5	Kosavë	gërmadha të man.	Mesjetare
		Xhami	shek.XX
6	Krushevë	misar antic	Antike
7	Bellobrad	mull vala	shek.XIX
		Xhami	shek.XIX
8	Blaq	Kroni	shek.XVIII
		Xhami	shek.XIX
		Tyrbe	shek.XIX
9	Orqush	obj.lok.	shek.XIX
10	Zgatar	Xhami	shek.XVIII
11	Mlik	Xhami	shek.XIX
12	Zym	Xhami	shek.XX
13	Kapre	Xhami	shek.XX
14	Shajne	Xhami	shek.XVI

¹⁰ Vlerësimi përfundimtar mjedisor, Detyra 4, 2009

15	Restelicë	Xhami	shek.XVIII
		Xhami	shek.XIX
		Tyrbe	shek.XVIII
16	Zlipotok	Xhami	shek.XX
17	Krushe	Xhami	shek.XX
18	Radesh	Xhami	shek.XX
		Xhami	shek.XX
19	Lubevisht	Xhami	shek.XIX
20	Kukajan	Xhami	shek.XX
21	Leshatan	Xhami	shek.XX
22	Renc	Xhami	shek.XX
23	Xerrxe	Xhami	shek.XX
24	Pllajnik	Xhami	shek.XX
		Tyrbe	shek.XIX
25	Rapq	Xhami	shek.XIX
		Xhami	shek.XIX
		Tyrbe	shek.XIX
26	Kuki	Xhami	shek.XX
27	Dragash	Tyrbe	shek.XIX
28	Buzezë	Namazxhah	shek.XVI

Tab. 12. Monumentet e trashëgimisë kulturore¹¹



Fig.20. Lojëra tradicionale e pelivanëve

Trashëgimia shpirtërore

Si pjesë e trashëgimisë kulturore është e shprehur në shkallë më të lartë në trevën e Opojës dhe të Gorës. Etnografia e kësaj ane karakterizohet me një kolorit dhe origjinalitet që kultivohet edhe sot e kësaj dite. Me rastin e festave të motmotit, fejesave, martesave etj., këto veshje përdoren më shpesh dhe janë unike për të gjitha trevat e rajonit dhe më gjerë, p.sh. veshjet e burrave (tirqit, këmishat, brezi, xhamadani etj.), veshjet e grave (këmisha, dimi, xhamadan, përparëse, çorape, shami të verdhë me thekë etj.)¹² Identitetin shpirtëror të Opojës, e kompletojnë traditat shumë të ruajtura muzikore, folklorike, këngët e djepit, lindjes, dasmave, këngët dyshe, vallet në rreth, lojërat nëpër ndeja pas darke, hudhja e gurit nga krahu, kërcimi trehapësh, vrapimi i kuajve, sporti i pelivanëve etj.¹³

¹¹ Drejtoria për kulturë në K.K. Dragash

⁸ Revista mujore e K.K.Dragash, Tetor2004

¹³ Hajriz Meleqi - Opoja - Studim kompleks gjeografik

Trashëgimia natyrore

Opoja dhe Gora disponojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Me pyje të shumta, florë dhe faunë, peizazhe, klimë të shëndoshë, numër të madh të lumenjve, lugina atraktive, burime dhe gurra të ftohta, liqenj dhe terene të përshtatshme për skijim¹⁴, mundësohet zhvillimi i turizmit veror dhe dimëror, ditor, rekreativo – sportiv, shkencor, të gjuetisë dhe peshkatarisë, malor dhe turizmit tranzitor.

Është propozuar që një pjesë e komunës së Dragashit të jetë pjesë e Parkut Nacional "Mali Sharr", ndërsa nga kategoritë tjera nuk ka zona apo monumente të të mbrojtura natyrore.

Peizazhi është strukturë hapësinore, biologjike dhe njerëzore, e cila me kombinime të ndryshme mund të jep tërësi me pamje unike.

Varësisht nga origjina, shkalla e ndryshimeve dhe mënyra e shfrytëzimit peisazhet mund të jenë:

- I. Pejzazh natyror apo strukturë biologjike;
- II. Pejzazh të kultivuar apo strukturë kryesisht rurale; dhe
- III. Pejzazh të ndërtuar apo strukturë kryesisht urbane.

Pejzazhi i zonës së hulumtuar është: Zaplluxhe, Radeshë, Brod, Restelicë, malet e Koritnikut, zonë kjo e mbuluar kryesisht me pyje që karakterizohet me pejzazh natyror dhe të kultivuar. Nuk ka ndikim të dukshëm në pejzazh të zonës së propozuar dhe ndryshime eventuale që do të regjenerohen me kohë.



Pamje e Fushës së Llopshnikut – Vendbanimi Brezna në prapavijë

POPULLSIA dhe ZHVILLIMI SOCIAL

Popullsia

Analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme.

Të dhënat për numrin e popullsisë kryesisht i japin regjistrimet e popullsisë. Meqenëse në Kosovë, që nga viti 1981 e këndeje, nuk ka pasur regjistrim të popullsisë, të dhënat e shfrytëzuara në këtë rast janë marrë nga analiza hapësinore e Komunës së Dragashit, profili socio-ekonomik dhe fizik i Komunës së Dragashit dhe studimi i fizibilitetit për HC Zhur të hartuar nga "Elektroprojekt" i Zagrebit.

Numri i popullsisë - pasi që të dhënat për popullsinë në zonën me interes të veçantë HC-Zhur mungojnë, përdoret me këtë rast numri i popullsisë për gjithë Komunën e Dragashit në të cilën jetojnë rreth 47.000 banorë, si dhe për zonën strikte prej nga duhet të bëhet zhvendosja e një pjese të popullatës (fshatrat Breznë Zym), të cilat janë siguruar nga studimi i fizibilitetit për HC Zhur. Në zonë jetojnë rreth 2100 banorë.

Dendësia e popullsisë - Në komunën e Dragashit, dendësia mesatare është rreth 109 banorë në një km². Kjo është dendësi e ulët e popullsisë krahasuar me mesataren e Kosovës

Struktura e popullsisë - Sipas moshës dhe gjinisë struktura e popullsisë ka rëndësi të madhe për zhvillim demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate.

Kjo zonë ka popullsi kryesisht të re, ku prej 49 % të popullsisë së përgjithshme janë të moshës prej 0 - 20 vjeç; 21 – 30 vjeç e përbën rreth 16% të popullsisë; grup moshë 31 – 60 vjeç përfshin rreth 25% përderisa moshë mbi 60 vjeç e popullsisë përfshin 10% të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna më së miri tregojnë se kjo zonë si edhe e tërë Kosova ka një popullsi të re me rreth 65% të saj nën moshën 30 vjeçare.

Popullsia mashkullore dominon me 51.1 %, në krahasim me popullsinë femërore që ka 48.9 % të popullsisë së përgjithshme..

Struktura etnike e popullsisë - Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë ~60 % dhe Boshnjakë/Goranë rreth 40 %.

Zhvillimi social

Arsimi - Është themeli i një shoqërie të shëndoshë, i cili garanton perspektivë shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike. Duke e lënë mbrapa historinë e dhimbshme të zhvillimit të arsimit në Kosovë, për shkaqe të njohura, pas vitit 2000 institucionet kosovare zhvilluan programet mësimore sipas standardeve bashkëkohore. Në vitin 2002, krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të ulët, të mesëm dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re, arsimi i obligueshëm është zgjatuar për një vit nga 8 vite sa ishte, në 9 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Dragashit është e organizuar në katër nivele: arsim parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsim fillor (1 – 5 klasë), arsim të mesëm të ulët (6 – 9) dhe arsim të mesëm të lartë (10 – 12 klasë). Numri i objekteve shkollore që do të atakohen në mënyrë direkte ose indirekte në këto vendbanime është gjithësej 13, ku një shkollë është e mesme ndërsa të tjerat janë shkolla fillore të ciklit të ulët dhe të lartë.

Çerdhe dhe kopshte – në këtë komunë nuk ekziston asnjë çerdhe për fëmijë të moshës nën 5 vjeç.

Arsimi parafillor - një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore ofrojnë edukim njëvjeçar parashkollor për fëmijët 5-6 vjet.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët - në tërë territorin e komunës mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 35 objekte shkollore ku në 18 shkolla mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, në 16 shkolla jepet mësimi në gjuhën boshnjake dhe 1 shkollë zhvillohet mësimi në gjuhë të përzier. Në këtë nivel shkollor mësimi zhvillohet në 283 paralele, ku gjithsej janë 5200 nxënës të cilët i ndjekin mësimet, prej tyre 3286 meshkuj dhe 1914 nxënës femra. Mesatarja e nxënësve për paralele është 18.37 nxënës. Ndërkaq, raporti mësimdhënës/nxënës është 14.77. Ndërkaq, personeli i punësuar në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 426, femra 33, nga ata 352 mësimdhënës, 32 femra, personel administrative 14, femra 0 dhe personel ndihmës 60 vetëm një femër.




Fig. 21 . Shtirija hapësinore e shërbimeve arsimore dhe niveli i tyre¹⁵

Arsimi i mesëm i lartë - përfshin tri vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshës 15 deri 18 vjeç. Në këtë komunë është vetëm 1 shkollë e mesme. Në këtë shkollë i ndjekin mësimet 927 nxënës, prej tyre 301 janë femra dhe 626 meshkuj. Gjithsej janë 41 paralele. Mesatarja e nxënësve për paralele është 22.61 nxënës. Ndërkaq, raporti nxënës/mësimdhënës është 13.4.

Personeli në arsimin e mesëm të lartë është gjithsej 77, mësimdhënës janë 69 prej tyre, 3 janë femra, personel administrativ dhe ndihmës janë 2, ndërsa gjithsej femra asnjë e punësuar.

Harta paraqet të dhënat ekzistuese për zhvillimin e arsimit në komunën e Dragashit. Me gjendje jo të mirë shkollore na paraqiten vendbanimi i Dragashit, Llopushnikut, Bellobradit dhe Bresanës.

Shëndetësia - Sistemi shëndetësor kosovar ka shumë sfida para vetes, sikurse mosekzistimi i fondit të sigurimit shëndetësor, mungesa e mundësive për trajtimin e disa gjendjeve të komplikuar shëndetësore si leukemia, insuficienca e veshkave, kardiokirurgjia, trajtimi onkologjik-radioterapia etj. Vështirësi ka edhe të natyrës organizative, gjegjësisht implementimit të ligjit të shëndetësisë, paralelizmit të strukturave shëndetësore nga Serbia, pamjaftueshmëria e kuadrit shëndetësor, mungesa e mjeteve për investime të reja në pajisje, hulumtime shkencore, mos përfshirja e sektorit privat në SISH, etj.

Aktualisht në Kosovë sistemi shëndetësor është i organizuar në tri nivele; a) niveli parësor b) dytësor dhe c) nivelin tretësor. Përveç në sektorin publik, është i organizuar dhe në sektorin privat në një shkallë mjaft të madhe. Në

¹⁵ Analiza Hapësinore, IPH/MMPH, 2006, fq. 14.

komunën e Dragashit, në sektorin publik, shëndetësia është e organizuar në nivelin parësor. Shërbimet shëndetësore ofrohen në 6 ambulanca, 6 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 1 Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare. Vlen të theksohet se ekziston një numër i konsideruar i vendbanimeve, prej ku banorët detyrohen të kalojnë distancë të gjatë për të marrë një shërbim mjekësor (Plavë, Pllajnik, Dikancë, etj.).




Fig.22. Shtrirja hapësinore e objekteve shëndetësore 16.

Harta paraqet të dhëna hapësinore për objekte shëndetësore, sipas cilësisë së tyre dhe gravitetit të popullatës deri te objektet më të afërta shëndetësore. Kjo komunë deri më tani nuk është e prekur me ndonjë sëmundje serioze, e shtrirë në lagje apo vendbanime të tëra.

Papunësia

Shkalla e papunësisë në komunën e Dragashit vlerësohet ndër më të lartat në Kosovë (56.85%¹⁶). Të dhënat e shfrytëzuara nga zyra e punës dhe punësimit në komunën e Dragashit dhe MPMS, tregojnë për një normë të lartë të papunësisë apo punëkërkesve të regjistruar (5792 punëkërkes – viti 2008/09). Por ky numër është shumëfish më i vogël në krahasim me numrin real të të papunëve, sepse pjesa dërmuese e të pa punëve nuk janë të paraqitur apo evidentuar. Megjithatë, përmes këtyre të dhënave ne do të mund të paraqesim gjendjen afërsisht reale, duke e krahasuar gjendjen e papunësisë në mes të vendbanimeve (hapësirave) të ndryshme brenda vet komunës së Dragashit.

¹⁶ Analiza Hapësinore, IPH/MMPH, 2006, fq. 16.

¹⁷ Raporti i Zhvillimit Njerëzor, UNDP Kosovë, 2004.

Vendbanimet të cilat kanë shkallë më të lartë të papunësisë, dhe janë shumë mbi mesataren e komunës janë: Pllajnik, Rrenc, Zym, etj. Papunësia më e ulët paraqitet kryesisht në rajonin e Gorës, por kjo mund të jetë jo edhe aq reale sepse nga ky rajon kanë mundur të paraqiten shumë më pakë punëkërkuar në zyrën komunale të punësimit, në krahasim me rajonin e Opojës. Shkalla e lartë e varfërisë në këtë komunë varijon sipas grup moshave dhe gjinisë. Shih grafikonin; Sipas të dhënave të analizuara del se grup – moshat e reja të popullsisë kanë shkallën më të lartë të papunësisë.

Papunësia sipas vendbanimeve ne komunën e Dragashit




Fig. 23. Papunësia sipas vendbanimeve në komunën e Dragashit

Të dhënat tregojnë se moshja 15-24 vjeç është e përfaqësuar me shkallë të papunësisë 80%, prej tyre e përbëjnë 64.44% meshkuj të papunë dhe 97.5% femrave, ndërsa moshën 25-34 vjeç e përbëjnë 67.78% të papunë, kurse prej tyre 64.79% janë meshkuj të papunë dhe 78.95% femra, përdërisa moshja 35- 49 vjeç është e përfaqësuar 38.02% prej tyre 27.38% meshkuj dhe 42.86% femra të papunësuar, dhe krejt në fund moshja 50-64 vjeç është e përfaqësuar me shkallë të papunësisë 42.55% prej tyre 40.91% e përbëjnë meshkuj dhe 66.67% femra të papunësuar

Sa i përket të dhënave për shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe shkallën e papunësisë shih si vijon.




Fig. 24. Papunësia sipas moshës dhe gjinisë¹⁸




Fig. 25. Skema e pjesëmarrjes dhe e papunësisë

¹⁸ UNDP, 2004

Sa i përket papunësisë ka edhe të atillë më kualifikime të lartë (universitet) që janë të papunë. Për të parë më mirë nivelin e kualifikimeve të papunëve kemi paraqitur në grafikonin si vijon.




Fig. 26. Skema e shkallës së papunësisë sipas kualifikimeve

Të dhënat tregojnë se shkalla më e lartë e papunësisë është të personat me kualifikime të ulëta. Sa i përket të papunëve sipas kualifikimeve, dominojnë të papunët me më pak se shkollimin e mesme 75%, e më pas vijnë të papunët me shkollim fillor me 73.11%, po ashtu me shkollim të mesëm pasojnë me 51.94%, me gjimnaz 54.55%, ndërsa me shkollim të lartë 11.11%, dhe me studime universitare të cilët e përbëjnë 33.33% të të papunëve. Niveli i ulët arsimor sidomos te femrat është faktor me rëndësi që ndikon në shkallën e lartë të papunësisë.

Faktorët tjerë të cilët kanë ndikim të madh në shkallën e lartë të papunësisë në këto hapësira janë të ndryshëm. Specifikë e kësaj komune është se kjo komunë është zonë periferike e Kosovës dhe për këtë arsye dhe të tjera, kanë ngelur investimet e dëshirueshme.

Migrimi i popullsisë në këtë komunë kryesisht lidhet me faktorin ekonomik dhe gjetjen e mundësive për punësim në viset tjera të Kosovës dhe në botën e jashtme. Kuadrot po ashtu, për shkak të pamundësisë për punësim janë duke u shpërngulur vazhdimisht. Pozita periferike e komunës dhe largësia nga qendrat tjera të zhvilluara e rrit problemin e punësimit.

Kushtet natyrore janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë e sidomos të blegtorisë, ku një numër i konsiderueshëm i banorëve të kësaj komune merren me aktivitete primare ekonomike, por edhe kjo ekonomi nuk është e zhvilluar si duhet dhe familjet nuk mund ta sigurojnë ekzistencën nga ky aktivitet.

Varfëria

Varfëria si një fenomen kompleks është i përhapur gjithë andej Kosovës. Hulumtimet të cilat kanë të bëjnë me varfërinë tregojnë për një shkallë të lartë (mbi 50%) të popullsisë që jetojnë në varfëri të përgjithshme, ndërsa mbi 13% jetojnë në varfëri ekstreme¹⁹. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkalla e ulët e arsimit, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve nga lufta e fundit në Kosovë ('99), ndikuan në rritjen e varfërisë.

Komuna e Dragashit bën pjesë në komunat më të vogla të Kosovës dhe një ashtu merë pjesë në komunat më të varfra të saj. Gjatë gjithë historisë së saj, kjo komunë ka qenë e lënë anash nga procesi i industrializimit si shkaktarë i pushtetit të atëhershëm serb dhe politikës diskriminuese ndaj popullatës shumicë shqiptare në njërin anë dhe periferisë (komunë periferike) së saj në anën tjetër. Burim kryesor për sigurimin e ekzistencës, komuna e Dragashit e ka : bujqësinë, bizneset e vogla dhe të mesme e posaçërisht kurbetin etj. Edhe për kundër që kjo komunë posedon tokë të kualitetit të mesëm, ku do të kishte mundësi të hapte vende të reja të punës dhe në këtë mënyrë të ndikoj në uljen e varfërisë, si duket gjasat janë të vogla. Parcelizimi i tokave, kreditë jo të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë, tatimet e larta (farëra, plehra artificiale,) etj, janë në disfavor të bujqësisë (bukut), për këtë arsye dhe,

¹⁹ UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosovë, 2004.

arsye të tjera, nuk ka interesim të popullatës të merret ekskluzivisht me bujqësi. Shih grafikonin i cili paraqet shkallën e varfërisë në komunën e Dragashit.

Varfëria është një fenomen kompleks social i cili është vështirë të matet. Për matjen e varfërisë kërkohen të dhëna si: të ardhurat për kokë banori, niveli i arsimimit, kushtet e banimit, shëndetësia, etj. Bazuar në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së, të vitit 2004, komuna e Dragashit ka shkallë mjaftë të lartë të varfërisë së përgjithshme (73.19%) dhe varfërisë ekstreme (26.5%). Pra, kjo komunë merret pjesë ndër komunat më të varfërua të Kosovës.

Këto të dhëna tregojnë për shkallë të lartë të varfërisë në komunën e Dragashit. Mbështetur edhe në të dhëna të Qendrës për Punë Sociale të K. K. Dragashit, për numrin e banorëve dhe familjeve me asistencë sociale sipas vendbanimeve kemi këto rezultate²⁰ (shih hartën);

Shkalla më e lartë e varfërisë është e shprehur në viset rurale më të thella (me largësi nga qendra kryesore) të komunës.

Në shkallën e lartë të varfërisë ka ndikuar: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkalla e lartë e papunësisë sidomos tek të rinjtë, të ardhurat e vogla për kokë banori, arsimimi në përqindje të ulët etj.

Njerëzit në kategoritë e mëposhtme ka të ngjarë të jetojnë në varfëri: të papunët, ata në punë me orar të reduktuar ose punë të pasigurta, të moshuarit, të sëmurët dhe të pa aftët, familjet me një prind etj. Shumë njerëz që mund të jenë paguar në mënyrë të arsyeshme gjatë punës përjetojnë një rënie drastike me daljen në pension. Familjet me një prind e posaçërisht ato me kryefamiljare nëna.

Papunësia e lartë e viteve të fundit pas '99 nuk duket se mund të bie në të ardhmen e afërt, ndërsa papunësia e tej zgjatuar për kryefamiljarët dhe fëmijët e tyre, po i shtynë gjithnjë e më shumë familje drejt varfërisë.




Fig. 27 . Varfëria sipas vendbanimeve në komunën e Dragashit

Vendbanimet, banimi dhe shërbimet sociale

Trajtimi i vendbanimeve është i domosdoshëm ngase i tërë aktiviteti dhe organizimi i jetës së njeriut, shoqërisë njerëzore ka qenë dhe është i lidhur për to. Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë është e një rëndësie të veçantë për planifikim dhe rregullim të hapësirës. Në bazë të kësaj analize mund të përcaktohen kahjet e zhvillimit dhe organizimit të më tejme shoqëroro-ekonomik në hapësirën e caktuar.

Nr.r	Vendbanimi	Nr. banorëve
1	Brezna	3,700.00
2	Zymi	700.00
3	Bellobrada	980.00
4	Dobrusha	569.00
5	Zhuri	7,000.00
6	Renci	732.00
7	Dikanca	200.00
8	Glloboqica	800.00
9	Plava	972
10	Restelica	3,480.00
Gjithsej		18,161.00

Tab.13. Vendbanimet dhe numri i popullsisë

²⁰ IPH/MMPH, Analiza Hapësinore – Komuna e Dragashit, nëntor 2006, fq. 8.

Nga aspekti i strukturës morfologjike-urbanistike, dallohet kryesisht tipi i grumbulluar i vendbanimeve – karakteristikë strukturale me koncentrim të të gjitha objekteve ndërtimore, oborreve ekonomike, rrugëve, etj. Në zonën e studimit të HC Zhur kemi gjithsej 10 vendbanime, dhe këto janë: Brezna, Zymi, Bellobrada, Dobrusha, Zhuri, Renci, Dikanca, Glloboqica, Plava dhe Restelica.

Zona e HC Zhur ka rreth 19,000 banorë me fshatrat më të mëdha, siq janë; Zhuri me 7000 banorë, Brezna me 3,700 banorë dhe Restelica me 3,480 banorë. Vendbanimet te cilat janë të ndikuara drejtpërdrejt me zhvendosje te popullsisë dhe nxënie të pronave janë Brezna, Zymi dhe fshati Buqe.

Objektet e administratës publike - Në zonën e studimit të HC Zhur nuk ka objekte të administrates publike

Objektet edukative arsimore - Në komunën e Dragashit funksionojnë 12 shkolla fillore dhe një shkollë e mesme. Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve arsimore në komunën e Dragashit është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- sipërfaqja shkollore/nr. nxënës,
- gjendja fizike e objekteve,
- kuadri arsimor/nr. nxënësve,
- kuadri përkatës – kualifikimi i mësimdhënësve,
- largësia e objekteve shkollore,

Niveli i ulët i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Dragashit, Llopushnikut, Bellobradit dhe Bresanës. Niveli mesatar i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Rapçës, Kosavës dhe Restelicës. Niveli i lartë i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Krushevës, Brodit, Vranishtës, Kukit e cila është në ndërtim e sipër dhe në shkollën fillore të Blaqit. Shkolla fillore në Zhur ka numrin më të madh të nxënësve nga të gjitha fshatrat tjera të zonës së HC Zhur, me 1152 nxënës. Në fshatin Brezna është shkolla e ciklit të ultë 1-4 , me 200 nxënës, ndërsa prej klasës së 5-të nxënësit vijojnë mësimin në shkollën "Shaban Shabani", në të cilën njëkohësisht mësojnë dhe nxënësit e fshatrave Buçe dhe Plavë. Në Buçe dhe Zym janë dy shkolla të ciklit të ulët 1-4 në të cilin mësojnë 125 nxënës, ndërsa nga klasa e 5-të vijojnë mësimin në fshatin e Bellobradit në shkollën "Sezai Surroi", në distancë 2km.

Objektet shëndetësore - Bartës kryesor i kujdesit primar shëndetësor në komunën e Dragashit është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare me pesë Qendra të Mjekësisë Familjare dhe gjashtë Ambulanca Shëndetësore. Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve arsimore në komunën e Dragashit është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- objekti shëndetësor/nr. banorëve
- gjendja fizike e objekteve
- kuadri shëndetësor/nr. banorëve
- kuadri përkatës – kualifikimi i personelit mjekësor
- largësia e shërbimeve shëndetësore

Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore vërehet në ambulancën e vendbanimit të Kosavës, Blaqit, Radeshës dhe Vraniqit. Niveli mesatar i shërbimeve shëndetësore vërehet në ambulancën e vendbanimit të Restelicës dhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare të vendbanimit të Breznës. Niveli i lartë i shërbimeve shëndetësore vërehet në QKMF të Dragashit, QMF të Rapçit, QMF të Bellobradit, QMF të Bresanës, QMF të Krushevës dhe ambulancën e vendbanimit të Brodit. Vlen të përmendet se në zonën e Llopushnikut ekziston qendra e mjekësisë familjare.

Objektet e sigurisë publike - Punët rreth sigurisë civile i kryen Policia e Kosovës dhe KFOR. Gjendja e sigurisë në këtë komunë nuk është e kënaqshme sepse kanë ndodhur disa incidente të pandrikuara. Qëllimi i tyre është destabilizimi i sigurisë për tërë qytetarët e komunës. Për të krijuar një siguri më të madhe në të ardhmen për qytetarët e komunës, një kompetencë dhe përgjegjësi më e madhe duhet ti jepet Shërbimit Policor të Kosovës. Në komunën e Dragashit nuk ekziston kurrfar shërbimi zjarrfikës. Për rastet e shpërthimit të zjarrit në këtë komunë duhet thirrur shërbimi zjarrfikës në Prizren, i cili është 43 km larg Dragashit, por edhe shumë më larg nga fshatrat malore të komunës.

Objektet dhe institucionet rekreative - Në zonën e studimit të HC Zhur ka disa objekte rekreative. Keto objekte janë më shumë të fushës së hotelarisë si restorane, hotele dhe motele të cilat kryesisht janë të vendosura përgjatë rrugëve të asfaltuara. Fshati Brezna , i cili gjendet pranë rezervatit të planifikuar, Fusha e Llopushnikut, karakterizohet me disa biznese te vogla si dy kafiteri, tri shitore dhe disa punëtori. Popullata kryesisht merret me bujqësi.

Objektet kulturore - Territori i komunës së Dragashit është i pasur me objekte të trashëgimisë kulturo – historike që nga periudhat më të lashta të saj. E kaluara historike e Komunës së Dragashit të sotëm nuk mund të shikohet e ndarë nga Prizreni dhe rrethina e tij, për shkak të lidhjes së ngushtë me qytetin si pjesë përbërëse e tij.

Në Opojë dhe në Gorë ka mjaft gjëmatra të vendbanimeve të vjetra, disa prej të cilave u kanë humbur gjurmët e disa prej tyre u ka mbetur vetëm emri si p.sh. "Zinova" si qytet i lashtë, në afërsi të Bellobradit, në të cilën gjenden gjurmët e lokalitetit të lashtë "Gostil" dhe gjurmë të ngjashme, edhe në afërsi të fshatit Brut.

Rëndësi të veçantë ka pasur rruga e ndërtuar në periudhën romake Tetovë – Shkodër – Lezhë, e cila ka kaluar nëpër malin Sharr dhe qytetit antik "Zinova", për të cilën supozohet të ketë pasur rolin e qendrës regjionale tregtare.

Në periudhën e mesjetës Opoja, Gora dhe Zgatarit kanë qenë si qendra të rëndësishme tregtare dhe zejtare. Në periudhën osmane shumë vendbanime kanë fituar fizionominë e qendrave të fuqishme ekonomike, edhe ato duke ndërtuar një numër të madh të objekteve fetare, të rrugëve, ujësellësve, kanalizimeve, spitaleve etj.

Kukli begu (në shek.XVI) ishte personalitet i kësaj kohe i cili ndikoi në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të kësaj treve (Opoja dhe Gora). Ai ndërtoi xhaminë dhe tyrben pranë saj (e cila edhe sot ekziston dhe ka status të mbrojtjes) në të cilën është i varrosur ai dhe anëtarët tjerë të familjes së tij. Ka ndërtuar sarajin (shtëpinë e bejlerëve), pranë saj ujësjellësin "Qeshmen e sarajit", tunelin nëntokësor (që një kohë e ka lidhur sarajin me xhaminë), namazxhahun, hamamin e shumë objekte tjera të cilat janë shkatëruar dhe janë në shkatërim e sipër.

Sot monumentet me trashëgimi kulturo – historike të kësaj komune pothuajse janë haruar në tërësi. Nuk ka kurfarë mbështetje nga institucionet relevante lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe konservimin e vlerave që i ka kjo anë dhe promovimin e tyre. Kërkesë nga niveli komunal është që të themelohet një muze komunal historik, kulturor dhe etnografik, ku do të mund të shpaloset e kaluara e kësaj ane.

Instituti Regjional për Mbrojtjen e Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore në territorin e komunës ka evidentuar këto objekte: 25 xhami, 5 tyrbe, 7 mullinj, 8 lokalitete arkeologjike, 47 ndërtesa të arkitekturës folklorike, 2 objekte publike dhe 1 valanicë. Për ndërtimin e rezervuarit të Breznës, duhen përmbytur tri varreza të fshatit Breznë.

ZHVILLIMI EKONOMIK

Ekonomia e komunës së Dragashit, sikurse edhe çdo pjesë tjetër e Kosovës, pas Luftës së Dytë Botërore është zhvilluar në kuadër të ekonomisë së RSF Jugosllavisë. Që në fillim kjo ekonomi ishte orientuar në zhvillimin e industrisë ndërsa veprimtaritë e tjera ishin në plan të dytë. Komuna e Dragashit ishte më pak e zhvilluar jo vetëm në Kosovë por edhe në ish Jugosllavinë. Ato pak investime që u bënë, të gjitha ishin të orientuara në Dragash, si qendër komunale, ndërsa viset rurale mbetën si regjione të pa zhvilluara. Shkaqet e mos zhvillimit janë të shumta, prej të cilave do të veçonim disa si: Komunë e izoluar malore me lartësi të mëdha mbidetare, pa infrastrukturë, regjion i brezit kufitar me Shqipërinë etj.

Historikisht popullsia e kësaj ane ka qenë e lidhur më veprimtaritë si lavërtaria, blegtoria, bletaria dhe pylltaria, pasi që kanë bazë natyrore të përshtatshme. Zona e ndikimit direkt në zonën ku planifikohet ndërtimi i rezervuarit për HC-Zhur përfshijnë vendbanimet si: Brezne, Buçe, Plavë, Zym/Qollopek dhe Bellobrad të cilat nuk kanë industri të zhvilluar.

Ekonomia dhe punësimi - Për shkak të pozitës gjeografike të shmangur, Dragashi /Sharri është një ndër rajonet më të pazhvilluara ekonomikisht të Republikës së Kosovës. Gjendja ekonomike e komunës karakterizohet me shkallë të lartë të papunësisë. Supozohet se numri real i personave të papunë është më i lartë se 42%.

Numri i të punësuarve kryesisht janë në komunë, polici dhe kompani private (KUK Commerce,-ndërmarrje për prodhimin e nxeheve elektrike dhe përpunimit të hekurit, Meka – për përpunimin e mishit si dhe disa ndërmarrje të vogla private prodhuese, mini ferma, etj).

Sipas të dhënave të Komunës së Dragashit, popullata në Breznë dhe Zym, kryesisht janë të angazhuar në ekonomi të vogla shtëpiake ose janë të punësuar jashtë vendit. Kjo situatë vlen edhe për vendbanimet tjera të zonës, si për shembull për njerëzit nga Zymi që punojnë në Komunën e Dragashit. Popullata në Breznë kërkon punësim në Dragash (të regjistruar 466 persona), kryesisht të cilët janë punëtorë të pakualifikuar, dhe një numër i vogël me diploma universitare. Sa i përket numrit të punëtorëve të punësuar në biznes, ai sillet prej 1 - 4 punëtorë, fakt ky se bizneset e regjistruara në lokalitetet fshatare janë biznese të vogla. Sipas pjesëmarrjes së veprimtarive dominante ekonomike, në rend të parë hyn tregtia me shumicë dhe pakicë, pastaj hotelet dhe restorantet.

Fshati Breznë, i cili gjendet pranë rezervatit të planifikuar "Fusha e Llapushnikut", karakterizohet me disa biznese të vogla si kafiteri, shitore dhe punëtori. Popullata kryesisht merret me bujqësi.

Në Zym/Qollopek, popullsia merret me artizanate, bujqësi, si ekonomi familjare për konsum vetanak. Ky fshat gjendet në afërsi të zonës ku planifikohet të ndërtohet Rezervari i Plavës.

Fshati Zhur /Komuna e Prizrenit nuk ka ndikim direkt nga ndërtimi HC-Zhur. Zhvillimin e vet ekonomik Zhuri e përjeton në vitet e pas konfliktit të vitit 99', me fillimin e punës së ndërmarrjeve të sektorit privat të cilat merren me veprimtari të ndryshme, shërbyese, tregtare, etj. Ekzistojnë 8 kompani private, që merren me prodhimin e elementeve të betonit dhe prodhimin e zhavorrit si dhe disa të tjera të cilat merren me përpunimin e drurit.

Popullsia kryesisht merret me bujqësi dhe blegtori, një pjesë e popullsisë janë të punësuar në tregti, dhe disa në shërbime të ndryshme. Burimi kryesor i jetesës së popullatës është punësimi i përkohshëm në botën e jashtme dhe punësimi brenda në territorin e Kosovës dhe komunës. Si burim dytësor i jetesës është bujqësia me blegtorinë dhe si burim i tretë është biznesi që ushtrohet nga qytetarët e komunës.

Bujqësia dhe blegtoria²¹ - Duke marrë parasysh prodhimin bujqësor dhe karakteristikat e prodhimeve bujqësore, vetëm 6 % e tokës bujqësore në zonën e komunës Dragashit janë të punëshme dhe përdoren për kultivimin e drithërave dhe patateve. Mesatarja e drithërave sillet rreth 3.000-3.200 kg / ha thekër, 2500-3000 kg / ha grurë, dhe 15.000-20.000 kg / ha për patate, një hektar 4.000 deri 6.000 kg sanë. Suksesin dhe rendimentet më të mëdha i jep bima e patates, varësisht nga reshjet gjatë vegetacionit edhe atë prej 10.000-15.000 Kg/Ha

Komuna e Dragashit nuk posedon sistem të ujitjes, përveç sipërfaqeve të tokave të cilat gjinden rreth rrjedhave të lumenjve, prandaj ballafaqohen me probleme gjatë periudhës së vegetacionit. Pra ujitja e sipërfaqeve të mbjellura kryesisht bazohet në reshjet gjatë sezonit të vegetacionit.

E përbashkët për të gjithë bujqit e Dragashit është se asnjë familje nuk është në gjendje që ti sigurojë të ardhurat e saja nga bujqësia. Sipas llogarive të bëra nga ana e zyrtarëve, familjet të cilat posedojnë mbi 3ha tokë të punëshme arrijnë të sigurojnë të ardhura nga bujqësia në vlerë prej 1000-3000 € në vit.

²¹ Analiza hapësinore për komunën e Dragashit




Fig.28. Përqindja e vendbanimeve që merren me prodhimtari bujqësore

Sipërfaqja e vogël e tokës së punueshme bujqësore, periudha vegetative e shkurtër, rendimentet nën mesataren e Kosovës kanë ndikuar që kjo degë të mos jetë burim i të ardhurave për ekonomitë familjare.

Bujqësia dhe veprimtaritë e saja në Komunën e Dragashit – Nga diagrami i mësipërm sipas vendbanimeve dhe bazuar në numrin e familjeve që jetojnë nga bujqësia, prodhimtaritë bujqësore për konsum familjar si dhe prodhimtaritë bujqësore për konsum komercial.

Perim-kultura - si veprimtari bujqësore në komunën e Dragashit, edhe pse ekzistojnë kushte të përshtatshme klimatike për kultivimin e të gjitha llojeve të pemëve, nuk është i zhvilluar si aktivitet për konsum komercial. Kryesisht ato kultivohen nëpër kopshte shtëpiake dhe furnizimi bëhet prej viseve të tjera. Këto treva janë të përshtatshme për kultivimin e llojeve të ndryshme të frutave të imta, të cilat tani rriten në formë të egër dhe grumbullohen nga një numër i banorëve.

Blegtoria - Komuna e Dragashit karakterizohet me 70% të sipërfaqes së kullosave dhe livadheve. Kushtet e përshtatshme natyrore dhe traditat kanë ndikuar në rritjen dhe kultivimin e kafshëve. Çdo shtëpi posedon me një ose dy lopë dhe në këtë mënyrë i plotësojnë nevojat e tyre për konsum familjar. Ky rajon karakterizohet me rritjen shpendëve, lopëve, deleve dhe kuajve, pra blegtoria është aktivitet kryesor në këto anë, megjithatë kohëve të fundit shihet interesimi për ngritjen e fermave individuale (mini-ferma) për rritjen dhe kultivimin e kafshëve për konsum më të gjerë. Ekzistojnë tri miniferma të lopëve mjelëse me mbi 12 krerë lopë dhe mbi 100 mini ferma të deleve me mbi 150 copë dhe fermat e pulave vojse me rreth 3600 copë. Në vitin 2006 në komunën e Dragashit ishin 24 ferma të madhësisë deri në 1.5 ha, 22 ferma me 1.5 – 3ha, 14 ferma prej 3- 10 ha dhe vetëm 11 ferma me mbi 10 ha

Bletaria - është një sektor i suksesshëm falë kushteve klimatike, llojlojshmërisë së bimëve, ambientit të pastër dhe mungesës së industrisë. Ekzistojnë 800 shoqëri bletësh dhe prodhimi i mjaltit llogaritet të jetë rreth 6500 kg në vit.

Industria

Komuna e Dragashit nuk ka pasur industri të zhvilluar asnjëherë. Kapacitetet e vetme ekonomike kanë qenë "hidrocentrali i Dikancës", "Drateksi" dhe fabrika për përpunimin e bimëve mjekuese .

Dikur hidrocentrali i "Dikancës" prodhonte rrymë elektrike në kuadër të KEK-ut, sot ka një kapacitet të vogël të prodhimit rreth i 1 MË. Fabrika "Drateks", dikur si industri për tjerjen e leshit, ka plasuar mallin e vet jashtë Kosovës dhe ka pasur një numër të konsideruar të punësuarve, por pas konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, kjo fabrikë është privatizuar. Në fabrikën për përpunimin e frutave dhe bimëve mjekuese sot bëhet grumbullimi i frutave dhe bimëve mjekuese kurse përpunimi kryhet në Slloveni. Pas konfliktit të vitit 1999 ka filluar zhvillimi i industrisë në sektorin privat, dhe atë në industrinë përpunuese ushqimore siç janë përpunimi i mishit dhe drithërave.

Zona e ndikimit direkt - Në zonën ku planifikohet ndërtimi i rezervoarit për HC-Zhur, në vendbanimet: Brezne, Buçe, Plavë, Zym/Qollopek, Bellobrad, nuk ka industri të zhvilluar.

Tregtia

Sipas të dhënave të regjistrimit të bizneseve, tregtia zë vendin e parë, ndërkaq numri i të punësuarve sillet prej 1-4/ndërmarrje, tregues ky se këto janë ndërmarrje tregtare të vogla të cilat kryesisht merren me furnizimin e banorëve të këtyre anëve me mallra të konsumit të përditshëm ushqimor dhe jo ushqimor, përderisa ditëve të premte kur është dita e tregut, tregtarë të ndryshëm vijnë dhe plasojnë mallrat e tyre në tregun lokal. Treg të bagëtive në komunën e Dragashit nuk ka, edhe për kundër faktit që kjo trevë është trevë blegtorale.

Turizmi dhe potencialet turistike

I tërë territori i komunës së Dragashit është atraktiv për tu vizituar falë bukurive të rralla natyrore, si dhe trashëgimisë kulturore. Vendet më atraktive për tu vizituar që mund ti veçojmë, janë zonat rreth fshatrave: Restelicë, Brod, Radeshë, Zaplluzhë, Liqen i Breznës, "Shpella e Zgatarit", "Namazgjahu", "HC-Dikancit", etj



Fig. 29. Garat në Zaplluzhë

Turizmi rekreativ, sportiv dimëror dhe malor

Hulumtimet e ekspertëve të ndryshëm tregojnë se terrenet më të përshtatshme në territorin e maleve të Sharrit janë ato të cilat bëjnë pjesë në komunën e Dragashit, në një lartësi mbidetare mbi 1100 metra, ku nevojitet shtresë e hollë e borës. Klima e përshtatshme e cila mbretëron në këto anë mundëson që këto terrene të shfrytëzohen për aktivitete dimërore deri në 6 muaj në vit. Karakteristikë e këtyre shtigjeve është edhe mundësia e skijimit mbi barë.

Zonat ku mund të zhvillohet skijimi janë: Zaplluzhë, Radesh, Brod dhe Restelicë. Këto terrene mund të pranojnë deri në 30 000 mijë skijatorë në të njëjtën kohë. Gjatë sezonit të dimrit organizohen edhe gara në skijim. Terrenet me pjerrtësi të lehtë si dhe shtigjet ekzistuese të cilat i përdorin blegtorët, paraqesin një mundësi shumë të mirë për zhvillimin e alpinizmit, hecjes dhe shëtitjes malore me biçikleta. Ky lloj i turizmit ndërlidhet me zhvillimin e sporteve të tjera malore që mund të zhvillohen në këto anë.

Përkundër pasurive natyrore të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, mungon infrastruktura adekuate, kadri profesional, njohuritë për turizmin, në mënyrë që ai të ngritet në shkallë më të lartë

INFRASTRUKTURA

Infrastruktura e transportit dhe transporti

Rrugët automobilistike - Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik (ZIVE) e përshkojnë rruga nacionale M25, rrugët rajonale R113, R114, R222 dhe rrugët lokale. Rruga nacionale M25 e përshkon fshatin Zhur e cila në kahje të perëndimit të shpie në Shqipëri, kurse në kahje të lindjes të shpie në Prizren.

Zhuri lidhet me fshatin Dobrushtë përmes rrugës lokale të asfaltuar, kurse me fshatrat Llopushnik dhe Pllavë përmes rrugës së asfaltuar R113. Në shtrirjen e saj deri në Pllavë, rruga R113 kalon pranë fshatrave Breznë dhe Buçë, të cilët përmes rrugëve lokale të asfaltuara lidhen me R113. E njëjta rrugë, duke u shtrirë kah jugu, lidh Pllavën me Sharrin (Dragashin) dhe në këtë shtrirje kalon pranë fshatit Rrenc. Ky fshat lidhet me R113 me rrugë të paasfaltuar. Rruga R113 vazhdon të shtrihet kah jugu duke lidhur Sharrin me Gllloboçicën dhe Krushevën. Rruga e asfaltuar R114 lidh Sharrin me fshatin Dikancë në jug duke kaluar pranë fshatit Mlikë, i cili lidhet me këtë rrugë përmes rrugës lokale të paasfaltuar. Fshati Pllavë lidhet me fshatrat Zym dhe Bellobrad përmes rrugës rajonale të asfaltuar R222, ndërkaq Sharrin lidhet me fshatin Shajnë përmes rrugës së asfaltuar lokale. Rrugët janë në një gjendje relativisht të mirë.

Transporti - Nga transporti publik në zonën e veçantë të interesit ekonomik, janë të përfshira vendbanimet Zhur, Sharr (Dragash), Zym, Bellobrad, Buçë, Llopushnik, Gllloboçicë dhe Krushevë. Në relacionin Buçë, Shajnë, Llopushnik – Zym – Bellobrad, transporti publik realizohet me autobus që qarkullon çdo dy orë, kurse në relacionin Zhur – Sharr – Gllloboçicë – Krushevë autobusi qarkullon një herë në ditë. Në zonë janë 5 stacione të autobusëve.

Telekomunikacioni - Shërbimet postare në zonë ofrohen në Zhur, Sharr, Bellobrad dhe Krushevë. Rrjeti i telefonisë fikse me 1500 numra në komunën e Sharrit është i instaluar në Sharr, Shajnë, Bresanë dhe Brod. Pra sa i përket ZIVE, vetëm Sharrin dhe Shajnën kanë rrjet të telefonisë fikse. Sa i përket telefonisë mobile, zona është në tërësi e mbuluar nga signali i kësaj telefonie gjë që nuk vlen për signalin televiziv sepse kjo zonë është vetëm pjesërisht e mbuluar nga signali i tre televizioneve kombëtare (RTK, RTV 21 dhe KTV).

Infrastruktura energjetike - Energjia elektrike në ZIVE ka filuar të përdoret në vitin 1957, kur edhe është aktivizuar hidrocentrali i Dikancës. Sot, ky hidrocentral nuk funksionon sepse turbinat janë të vjetëruara dhe duhet ndërruar. Infrastruktura e hidrocentralit është në gjendje të mirë, por makineria është jashtë funksionit. Zona furnizohet me energji elektrike nga elektranat e Kosovës përmes largpërquesit 35 KV, që vjen nga Prizreni. Momentalisht furnizimi me rrymë elektrike është mjaft i dobët si pasojë e rrjetit të amortizuar.

Rrjeti i shpërndarjes - Në vitin 1957 është ndërtuar edhe rrjeti i distribuimit të energjisë elektrike. Ky rrjet është sot e kësaj dite në përdorim. Përveç ndërhyrjeve të vogla që janë bërë kohëve të fundit, në përgjithësi nuk është intervenuar asnjëherë në sistemin e distribuimit. Për sistemin e distribuimit të energjisë elektrike në komunën e Dragashit përkujdeset distribucioni në Prizren, njësia punuese Dragash. Njësia punuese Elektrokosova në Dragash në rrjetin e distribuimit posedon dhe menaxhon me: Trafostacion bazë në Dragash/TS 35/ 10 KV me dy transformatorë energjetik me fuqi instaluese $S_n = 8 \text{ MVA} + 4 \text{ MVA} = 12 \text{ MVA}$, dhe me hidrocentralin në Dikancë me $S_n = 2,5 \text{ MVA}$. Fuqia e tërësishme instaluese është $S_n = 14,5 \text{ MVA}$.

Rrjetat e tensionit të Lartë 10 KV:

Rrjeta ajrore 10 KV me gjatësi $L = 86 \text{ Km}$, me përques Al – Fe

Rrjeta kablllorike tokësore 10 KV me gjatësi $L = 1 \text{ Km}$

Rrjetat e tensionit të ulët 04 KV

Rrjeta ajrore me gjatësi $L = 140 \text{ Km}$, me përques Al – Fe

Rrjeta kablllorike tokësore 04 KV me gjatësi $0,5 \text{ Km}$

Rrjeta ajrore me kabëll gërshet 04 KV me gjatësi $L = 2,43 \text{ Km}$

Trafostacione TS 10/04 KV nëpër lokacione, (fshatra dhe në qytezën e Dragashit),

Gjithsej janë 88 transformator energjetik me fuqi instaluese $S_n = 20,02 \text{ MVA}$:

TS 10/04 KV Piramid (konstrukcion druri)/6 transformatorë energjetik,

TS 10/04 KV Kulla, 11 transformatorë e

TS 10/04 KV Shtyllë Hekuri, 64 transformator energjetik

Trafostacione TS 10/04 KV lokale që janë patur të KEK-ut , gjithsejtë janë 70 prej tyre

Trafostacione TS 10/04 KV në pronësi private (nuk janë pasuri e KEK-ut) janë gjithsejt.




Fig. 30. Harta e rrugëve dhe transportit publik



Fig. 31. Harta e telekomunikacionit

Infrastruktura ujore

Furnizimi me ujë - Të gjitha vendbanimet e ZIVE kanë ujësjellës, përderisa kapaciteti i tyre ndryshon nga fshati në fshat. Kapaciteti i ujësjellësit në Breznë dhe në Zym është 5l/sek, në Buçë dhe në Pllavë është 3l/sek dhe në Bellobrad kapaciteti i ujësjellësit është 2l/sek. Në muajt e verës (korrik, gusht) ka reduktime në furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm, sidomos në vendbanimet Breznë, Bellobrad dhe Pllavë.

Kanalizimi i ujrave të zeza - Sistemi i kanalizimit të ujrave të zeza është i instaluar vetëm në katër vendbanime të ZIVE: në Sharr, Pllavë, Kapër dhe në Bellobrad. Ujrat e kanalizuar, të patrajtuar derdhen në lumenjtë më të afërt.

Menaxhimi i mbeturinave - Në ZIVE është një deponi e mbeturinave/deponi komunale e Sharrit (Dragashit) që menaxhon me mbeturinat. Vendbanimet Zhur, Sharr, Breznë, Buçë, Pllavë, Shajnë, Rrenc, Zym dhe Bellobrad janë të përfshirë nga shërbimi publik i largimit të mbeturinave. Përveq deponisë legale, në ZIVE, gati në çdo vendbanim ka

edhe deponi të egra apo ilegale ku hudhen më se 30% e të gjitha mbeturinave. Nuk ekziston ndonjë deponi e veçantë për mbeturinat ndërtimore, por ato hudhen në deponitë e egra apo në deponinë komunale të Dragashit.




Fig.32. Harta e ujësjellësit, kanalizimeve, shërbimeve publike për largimin e mbeturinave

Analiza - SWOT

Përparësitë

Institucione përgjegjëse dhe bazë ligjore për planifikim, rregullim të fushës së mjedisit dhe energjetikës;
 Vendim nga KK Dragash për ndërprerjen e ndërtimeve në fshatra në zonën e HC;
 Kushte të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë;
 Resurse natyrore për zhvillimin e turizmit;
 Llojlojshmëri të florës dhe faunës;
 Rrjet rrugor magjstral dhe rajonal;
 Rrjet ë dendur hidrografik;
 Afërsi me Parkun Nacional "Mali Sharr";
 Interesim për investime nga sektori privat – donatorët privat.

Dobësitë

Emigrim të popullatës së re;
 Ndotje të lumenjve;
 Mungesë e mjeteve financiare për projekte zhvillimore të turizmit;
 Fond i vogël dhe në humbje të tokës bujqësore;
 Mungesë e qendrave grumbulluese për plasimin e prodhimeve blegtorale;
 Mungesë e përkrahjes financiare për bujqësi;
 Papunësi dhe varfëri;
 Vend kufitar – qasje e vështirësuar;
 Nivel i ulët i arsimimit;
 Infrastrukturë e dobët teknike (furnizimi dhe cilësia e ujit të pijshëm, rrjeti i kanalizimit, hedhja e mbeturinave, telefonja fikse, transportit publik, rrjeti i vjetër në furnizim të energjisë elektrike);
 Mungesë e rrjetës së monitorimit të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, stacionet e pakta hidrometrike dhe meteorologjike.

Mundësitë

Burime të mjaftueshme për energji të ripërtëritshme;
 Hapje e vendeve të reja të punës;
 Zhvillim të turizmit;
 Zhvillim i blegtorisë dhe bletarisë;
 Promovim i produkteve bujqësore;
 Ndërtimi i gjeneratorëve për prodhimin e energjisë nga era;
 Bashkëpunim ndërkufitar dhe rajonal në projekte të ndryshme;
 Mundësi për përmbushjen e kërkesave të traktatit për komunitetin e energjisë dhe direktivave evropiane;
 Pyllëzimi i zonave të caktuara.

Kërcënimet

Vonesë në sigurimin e mjeteve financiare për ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit;
 Rënie e interesimit për investime;
 Rritje të mikrosizmitetit në zonë;
 Humbja e ujit nga përbërja gjeologjike e tokës/teren karstik;
 Atraktivitet më i madh për investime i vendeve fqinje;
 Fatkeqësi natyrore;
 Zgjidhje e pakënaqshme e çështjes së të shpronësuarve;
 Zënie/humbja e tokës bujqësore;
 Zvogëlim dhe humbje e biodiversitetit.

KAPACITETET INVESTIVE

Lloji	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi €	Gjithsej €
Shtëpi	Nr.	200	80,000	16,000,000
Biznese të vogla	Nr.	10	100,000	1,000,000
Livadhe dhe kullosa	Ha	250	60,000	15,000,000
Tokë pjellore	Ha	70	80,000	5,600,000
Djerrinë	Ha	15	40,000	600,000
Pronësia private			Gjithsej	37,200,000

Tab. 14. Pronësia private (Brezne)

Lloji	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi €	Gjithsej €
Shkolla në Brezne	m ²	500	1,000	500,000
Shkolla në Hanin e Llopushnikut	m ²	600	1,000	600,000
Shtëpia e shëndetit në Hanin e Llopushnikut	m ²	400	1,000	400,000
Fushat e Sportit	m ²	6000	30	180,000
Sistemi i rrjetit të ujësjes				
Tubacionet e ujit	Km	5	40,000	200,000
Stacioni i pompave	Copë	1	30,000	30,000
Rrugët	Km	10	350,000	3,500,000
Varrezat	Ha	4,5	150,000	675,000
Zhvendosja e rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike	Ha	3.3	100,000	330,000
Objektet publike			Gjithsej	6,415,000

Tab.15. Pasuritë /Objektet publike për zonën (Brezne)

Lloji	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi €	Gjithsej €
Shtëpi private	Copë	25	80,000	2,000,000
Livadhe dhe kullosa	Ha	34	60,000	2,040,000
Tokë pjellore	Ha	11	80,000	880,000
Pyje	Ha	2	80,000	160,000
Djerrinë	Ha	2	40,000	80,000
Prona Private Zym /Qollopek			Gjithsej	5,160,000

Tab.16. Prona Private Zym / Qollopek

Rrjeti i infrastrukturës në këtë zonë përfshin rrjetin e furnizimit me ujë të pijes për fshatin Zym me gjatësi të gypave 3 km me çmim total rreth 120,000.00 €. Gjithashtu platforma e trafostacionit për HC Zhur vlerësohet 870,000.00 € ndërsa për sistemin e bartjes nga lumi Brod 1,062,000.00 €.

Lloji	Prona private	Prona publike
Rezervoari Brezne	37,200,000 €	6,415,000€
Rezervoari Plavë	5,160,000€	120,000€
Trafostacioni HC Zhur I dhe sistemi i bartjes HC Zhur	870,000€	0
Sistemi i bartjes nga Lumi Brod	1,062,000€	0.00
Gjithsej:	44,292,000€	6,535,000€
Shuma e përgjithshme, prona private dhe publike	50,827,000 €	
Dëmet dhe humbjet e tokës:	500,000€	
Të paparashikuara (10%) :	5,132,700€	
Gjithsej: Shpronësimi dhe Zhvendosja):	56,459,700 €	

Tab. 17. Shuma e përgjithshme shpronësimi dhe zhvendosja

Shpronësim i tokave	29,824,000
Punë ndërtimore	126,890,000
Pajisje	109,708,000
Tjera	20,593,000
Total asete afatgjata (kapitale)	287,017,000
Asete aktuale	3,110,000
Monitorim	175,000
Kamata gjatë ndërtimit (7%)	39,030
Total asete kapitale dhe aktuale,monitorim	329,332,000

Tab. 18. Kostoja e ndërtimit

Kalkulimet për shpronësim dhe zhvendosje				
BREZNE	Objekte banimi	185	80,000	14,800,000
	Objekte biznesi	10	80,000	800,000
	Objekte shkollore	2	100,000	200,000
	Varezë	1 x 1500	1,200	1,800,000
	Rruge regjionale	4	100,000	400,000
	Rrugë lokale	14	100,000	1,400,000
ZYM	objekte banimi	32	80,000	2,560,000
BUQE	objekte banimi	2	80,000	160,000
	Objekte biznesi	3	80,000	240,000
	varezë	1 x 70	1,200	84,000
Totali				22,444,000

Tab. 19. Kostoja e shpronësimit dhe zhvendosjes

SFIDAT ZHVILLIMORE

Sfida.1.

Shfrytëzimi i resurseve ujore

Pse është sfidë "Shfrytëzimi i resurseve ujore" në kontekst të ngushtë të HC Zhuri?

Nëse dëshirojmë siguri energjetike, atëherë duhet redukojmë apetitet tona për lëndë fosile që ndotin mjedisin. Nuk ekziston ndonjë mënyrë tjetër përveç që duhet hulumtohen resurset për energji të ripërtëritshme, në Kosovë përveç tjerash dhe me HC ZHUR.

Në bazë të vlerësimeve të bëra gjatë me tani, për sasinë e burimeve ujore dhe prurjet e tyre të pellgjeve lumore në territorin e Komunës së Dragashit për nevojat e HC ZHUR, si dhe nevojat për ujë/furnizim të popullatës dhe ndotjes së ujërave të lumenjve të shkaktuara nga shkarkimi i ujërave të zeza si dhe nga hedhja e mbeturinave të amvisorisë dhe të tjerave në shtretërit e lumenjve, prej kohësh janë probleme serioze që duhet trajtuar.

Për të përmbushur nevojat për ujë të banorëve, bizneseve, aktiviteteve bujqësore dhe industriale, turizmit, si dhe për të permisuar standardet ekologjike dhe kapacitetet natyrore mbajtëse të dy baseneve të Plavës dhe Breznës, është e nevojshme të ndërmirren masa të nevojshme lidhur me çështjet e identifikuar;

1. Shfrytëzimi i ujë rrjedhave lumore të 7 ujëmbledhësve me anë të ndërtimit të kanaleve dhe tuneleve për basenin e Plavës dhe Breznës;
2. Pjesëmarrja e publikut të vendbanimeve në ndikim për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe përcaktimi i rregullave përdoruese;
3. Forcimi dhe përmisimi i teknologjisë së sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të ujërave të zonës në 7 zonat ujëmbajtëse nga IHMK si dhe informimi me kohë për sasinë e ujit dhe mundësia e shfrytëzimit të qëndrueshëm;
4. Detyrimi me ligj i vendosjes së impianteve për pastrimin e ujërave të përdorura si dhe grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve të amvisorisë dhe të tjerave;
5. Të minimizohet shkalla e lartë e erozionit prej afro 34% të sipërfaqes, që është e ndikuar nga erozioni i fortë për shkak të sedimentimit të lartë, në bazenin e Plavës dhe Breznës.

Pse është sfidë në kontekst të gjerë të rajonit, komunës së Dragashit, Prizrenit dhe më gjerë?

Sfidë në kontekst të gjerë të rajonit është: Rishikimi shkencor i vlefshmërisë dhe përputhshmërisë së akteve ligjore ndërshtetërore në mes R Kosovës dhe R. Shqipërisë për menaxhimin e ujërave në përputhje me konventat ndërkombëtare ku përcaktohet indeksi i prurjes më të ultë ekologjike në lumenj (minimumi biologjik).

Kjo marrëveshje midis dy shteteve duhet arritur për funksionalizimin e HC ZHUR bazuar në konventa ndërkombëtare.

- Indeksi i prurjeve më të ulta në shtretërit e lumenjve që ju ndërrohet kahja e drejtimit nëpërmjet kanaleve dhe tuneleve;
- Arritja e marrëveshjes me Shqipërinë, për ujë mbledhës të lumit Qaljana dhe ujëmbledhës të Plavës;
- Përcaktimi i kriterëve të brendshme për lumin e Restelicës, Brodit dhe Radeshit ku duhet të respektohet minimumi biologjik.

Sfida.2.

Shpronësimi dhe zhvendosja

Pse është sfidë shpronësimi dhe zhvendosja në kontekst të ngushtë të HC Zhuri?

Shpronësimi dhe zhvendosja, është sfidë meqë kemi të bëjmë me pjesën më të ndjeshme, çështjen e njeriut, lëvizjeve të popullatës, pronave materiale dhe shpirtërore të tyre. Në këtë rast kemi tri aspekte të ndjeshmërisë, atë emotive në rastin e dislokimit nga vendjetesa e deriatëhershme, aspektin material dhe financiar me rastin e shpronësimit të pronave të paluajtshme dhe fizik me rastin e gjetjeve të zgjidhjeve adekuate për rivendosjen e popullatës për të jetuar dhe vepruar në formën dhe cilësinë e deritanishme.

Procesi i zhvendosjes është aktivitet i dhimbshëm dhe me të vështirë, i cili do të ndodhë me përgatitjet për krijimin e dy liqeneve akumuluese për hidrocentralin e Zhurit. Me këtë rast do të përmythen një mori shtëpish, pasurish tjera përcjellëse të paluajtshme, vareza, rrugë etj. Në fshatin Breznë kur jemi tek përmytjet, kemi të bëjmë poashtu dhe me tri grupacione të varrezave të cilat do të duhej poashtu të rivendoseshin gjetiu me krijimin e liqenit të Breznës.

Me procesin e shpronësimit si sfidë të posaçme, poashtu është sfidues, rrugës automobilistike që kalon përmes liqenit akumulues të Breznës.

Mundësitë për zgjidhjen e sfidës - Janë multidisiplinare: ligjore, institucionale, financiare dhe në fund humane dhe njerëzore që kanë të bëjnë me vetëdijësimin e lartë qytetaresk për të mirën kolektive, ndërtimin e hidrocentralit energjetik të Zhurit.

Sfida.3.

Zhvillimi ekonomik i zonës

Pse është sfidë zhvillimi ekonomik i zonës në kontekst të ngushtë të HC Zhuri?

Regjioni i Dragashit është i izoluar në raport me viset tjera në Kosovë, sikurse dhe me viset tjera jashtë kufinjve kosovar, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Komuna e Dragashit edhe përkundër resurseve natyrore dhe atyre njerëzore është e pasur, nuk janë të shfrytëzuara për të mirën e zhvillimit ekonomik të zonës. Mungon organizimi dhe orientimi i investimeve private dhe publike.

Komuna e Dragashit është ndër komunat më të pa zhvilluara të Kosovës, me 90% të vendbanimeve nën mesataren e zhvillimit²². Kjo gjendje zhvillimit të ulët ekonomik është trashëguar, si pasojë e situatës ekonomiko politike të viteve të nëntëdhjeta, fondeve të kufizuara për zhvillim, proceseve të ndërlikuara të tranzicionit, pasojave të konfliktit të 99", procesit të zgjatuar të privatizimit, buxhetit të vogël të komunës etj.

Mozhvilimi i regjionit ka pasur dhe ka për pasojë migrimin e popullsisë si nga viset rurale në ato urbane dhe më tej në ato urbane më të zhvilluara²³, për shkaqe punësimi si dhe kualitet më të mirë të jetesës. Mungesa e investimeve dhe mundësive për punësim në këto vise, kanë për pasojë ikjen e kuadrove të arsimuara në qendrat më të zhvilluara, përderisa vendlindja e tyre mbetet edhe me tej e pazhvilluar. Migrimet kanë për pasojë edhe pronat e braktisura dhe të pashfrytëzuara.

Mungesa e "Strategjisë së zhvillimit ekonomik për Kosovë" politikave të favorshme (për bujqësi, blegtori apo turizëm), reflekton apo kanë ndikim direkt në mozhvilim të regjionit.

Mungesa e infrastrukturës teknike, e burimeve financiare, e investimeve nga diaspora, e pikave kufitare me shtetet fqinje, pamundësojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave.

Pse është sfidë në kontekst të gjerë të rajonit, komunës së Dragashit, Prizrenit dhe më gjerë?

Për të dalur nga situata e gjendjes së ulët të zhvillimit ekonomik, prioritet numer një janë lidhjet e mira me Maqedoninë dhe Shqipërinë përmes hapjeve të pikave të kufitare. Me hapjen e re të pikave kufitare, mundimin e lëvizjes së lirë të njerëzve nëpër pika kufitare, do të ju ipet mundësia banorëve të dalin nga bllokada jo vetëm ekonomike të banorëve të Komunës së Dragashit dhe më gjerë.

Cilat janë mundësitë për zhvillim ekonomik lokal bazuar në resurset e bujqësisë dhe të turizmit?

Mundësitë për zhvillim të regjionit të Dragashit mbështeten në shfrytëzimin resurseve natyrore me të cilat shquhet kjo zonë (blegtori, bletari, turizëm mjekësor, rekreativ, dimëror, etj), për një zhvillim të dëshirueshëm ekonomik.

Arsimimi i popullatës do të ofronte mundësi dhe zgjidhje për të gjithë banorët e komunës duke u ofruar nivel njohurish adekuate për shfrytëzimin re surseve të regjionit, me pjesëmarrje aktive në jetën ekonomike për përmirësimin e kualitetit jetësor. Ndërtimi i HC Zhur do të jetë një mundësi e mirë për ngritjen ekonomike të zonës dhe më gjerë.

Ky zhvillim mund të mbështetet fillimisht me këto projekte apo masa dhe veprime:

- Subvencione dhe kredi për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit lokal;
- Ndërtim të kapaciteteve për përpunimin e frutave dhe bulmetit;
- Zbatim të projekteve për bujqësi organike;
- Ndërtim të sistemeve për ruajtje të frutave;
- Zhvillim të eko-turizmit përmes ofrimit të formave të trajnimit për operatorët vendas, guidat, pronarët e hoteleve dhe popullsisë vendase ;
- Zhvillim të projekteve për turizëm, bazuar në bashkëpunim ndërkufitar;

²² Analiza hapësinore për Dragashin, 2006

²³ Në Dragash Në Prizren, Prishtinë, etj

II. VIZIONI PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM HAPËSINOR

DEKLARATA E VIZIONIT

Duke u bazuar në mundësitë dhe duke i përmbushur nevojat e zonës deklarata e koncipuar e vizionit për zhvillimin hapësinor të zonës për Hidrocentralin e Zhurit, bazuar në analiza, hulumtime, vlerësime, raport dhe strategji:

"Hidrocentrali i Zhurit - Kopsht Energjetik gjenerator i energjisë së ripërtëritshme, i zhvillimit ekonomik, me mjedis të pastër dhe atraktiv për investitorë dhe vizitorë"




Fig. 33. Skema piramidale për arritjen e vizionit

Me qëllim të arritjes së deklaruar të VIZIONIT, në mënyrën më të lehtë të mundshme, duhet që Deklarata e Vizionit të ndahet në synime të fushave të ndryshme tematike, duke i renditur dhe grupuar, brenda tyre, objektivat gjegjëse.

Në pjesën e Strategjisë (fazë e katërt) të këtij Plani, shtjellohen dhe renditen veprimet, masat dhe projektet e duhura për të arritur secilën nga këto objektiva, si në **fig.x.**

Në vazhdim janë të paraqitura në mënyrë të përmbledhur synimet dhe objektivat për arritjen e zhvillimit hapësinor të ZIVE "KEZH":

1. Çka planifikohet për shfrytëzimin racional të resurseve ujore për nevojat e prodhimit të energjisë; Cilat janë ato parametra të cilat do të duhej të shfrytëzohen për të mbajtur, mbrojtur dhe kultivuar jetën e gjallesave të gjalla në zonë, sikurse dhe të mbrojtjes së natyrës?

Vizioni për të ardhmen e ZIVE "Hidrocentrali i Zhurit" konsiston në zhvillimin socio-ekonomik, që para së gjithash nënkupton ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike dhe në ruajtjen e mjedisit të pastër siq është tani në këtë zonë. Prodhimi i energjisë elektrike synohet të arrihet duke shfrytëzuar fuqinë e ujrave mbitokësor të zonës, kurse mbajtja e një mjedisi të pastër mund të arrihet me marrjen e masave mbrojtëse. Pra njëri prej synimeve me arritjen e të cilit kontribuohet në përmbushjen e vizionit për të ardhmen e zonës është formuluar si: "Shfrytëzimi racional i resurseve ujore dhe mbrojtja e mjedisit".

Objektivi për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike do të arrihej me realizimin e projekteve për ndërtimin e objekteve që do të mundësonin këtë shfrytëzim që do të thotë ndërtimin e hidroelektrocentraleve HEC1, HEC2 dhe infrastrukturës së tyre përcjellëse që janë kanalet për bartjen e ujit dhe bazenet akumuluese.

Resurset ujore do të shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike që është njëri prej objektivave që lidhet me synimin e poashtu edhe banorët e zonës do t'i shfrytëzojnë ato për pije dhe ujitje që është një objektivi tjetër, i cili lidhet me synimin e lartpërmendur. Në mënyrë që resurset ujore të shfrytëzohen racionalisht, e që njëkohësisht nënkupton edhe ruajtjen e mjedisit, është i domosdoshëm sigurimi i minimumit ekologjik në zonën e lumenjve. Ky sigurim paraqet objektivin e radhës, arritja e të cilit kontribuon në arritjen e synimit, pra nuk lejon që sasia e ujit në lumenj të zvogëlohet nën minimumin e domosdoshëm dhe lumenjtë të shterren. Mbrojtja nga rreziqet natyrore (erozioni, vërshimet, tërmetet, thatësira dhe zjarri) paraqet një objektivi që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit në ZIVE "Hidrocentrali i Zhurit", pra ka të bëjë me njërin komponentë të synimit. Objektivi i fundit me të cilin mbrohet mjedisi, arrihet me marrjen e masave antierozive, masave për mbrojtje nga vërshimet dhe zjarri si dhe me përpilimin e planeve për shpëtim nga tërmetet, thatësitat dhe zjarret eventuale.

S1 Shfrytëzimi racional i resurseve ujore dhe mbrojtja e mjedisit

S1.O1. Shfrytëzimi i ujit për hidroenergjë dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse
S1.O2. Shfrytëzimi i resurseve ujore për pije dhe ujitje
S1.O3. Sigurimi i minimumit ekologjik në zonën e lumenjve
S1.O4. Mbrojtja nga rreziqet natyrore(erozioni, vërshimet, tërmetet, thatësira, zjarri)

Tab. 20. Synimi i parë dhe objektivat e tij

2. Çka planifikohet në kuptim të shpronësimit dhe kompensimit të pronave të përmblytura nga uji? Çka me zhvendosjen efikase dhe rivendosje? Çka me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimeve?

Me këtë synim tentohet arritja e mbizotërimit të rregullimit të planifikuar të vendbanimeve pjesëmarrëse, duke kryer që më parë proceset për shpronësim, kompenzim si dhe për zhvendosje të popullsisë e të varrezave. Këto procese, do të kryhen, me përgjegjësi të madhe dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë, nga institucionet vendore Qeveritare. Së pari, do të kryhet shpronësimi i pronave, të cilat, do të lëshojnë vendin për akumulim të ujit në liqenin artificial të Breznës dhe në rezervarin artificial të Zymit në lumin Plava. Më tej, zbatimi i marrëveshjes që do të arrihet, në mes pronarëve (pjesëtarë të komunitetit) dhe Komisionit Qeveritar për shpronësim dhe kompenzim, do të kryhet duke u bazuar në mënyrën e kompenzimit të vet-deklaruar nga secili pronar. Në fund, pas mbarëvajtjes së këtyre proceseve, si dhe pas përcaktimit të lokacionit të ri për banim të popullsisë që zhvendoset, por edhe për vendbanimet tjera brenda zonës, kërkohet të hartohen planet rregulluese. Këto plane rregulluese, për të gjitha vendbanimet e zonës së interesit, do të jenë rezultat i planifikimit, urbanizimit dhe rregullimit efikas, e gjithashtu edhe mjet për kontrollë të zhvillimeve të ardhshme në këtë hapësirë.

S2. Planifikimi i vendbanimeve dhe zhvendosjes së popullsisë në zonë

S2.O1. Shpronësimi dhe kompenzimi nën ujdi i pronave që përmblyten nga akumulimet e ujit;
S2.O2. Zhvendosja dhe rivendosja e popullsisë dhe e varrezave
S2.O3. Planifikimi dhe kontrolli e zhvillimeve në zonë

Tab. 21. Synimi i dytë dhe objektivat e tij

3. Çka parashihet sa i përket zhvillimit ekonomik për zonën e Hidrocentralit të Zhurit? Çka parashihet lidhur me zhvillimin e turizmit? Cilat do të ishin mënyrat për përfitimet maksimale nga resurset turistike në zonë, për turizëm natyror dhe rekreativ, turizëm rural dhe ekologjik, turizëm kulturor? Çka tentohet të mbërrihet për zhvillim hapësinor të zonës së Hidrocentralit të Zhurit përmes bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar?

Me këtë synim tentohet zhvillimi i Zonës së Hidrocentralit të Zhurit dhe në drejtim tjetër përpos atij të zhvillimit energjetik, përmes zhvillimit të sektorëve tjerë ekonomik dobiprurës për zonën, përmes resurseve të saja ekzistuese natyrore për zhvillim të turizmit, porse dhe me realitetin e ri të krijuar me liqen akumulues si resurs shtesë për turizëm natyror dhe rekreativ,.

Sa i përket turizmit rural dhe kulturor, të gjitha resurset ekzistojnë dhe mund të themi se zona e HC të cilën tanimë do e quajmë KEZH për shkak të llojllojshmërisë natyrore dhe kulturore do mund ta kemi me bollëk, meqenëse zona është përplote me llojllojshmëri kulturore, burimore, të pastër dhe atraktiv për turizëm kulturor.

Synimi për zhvillim ekonomik të zonës përpos resurseve ujore për prodhim të energjisë, arrihet përmes objektivit për promovim të turizmit natyror, ekologjik dhe rural me të cilat shquhet kjo zonë dhe të cilat do të ishin resurs i begatshëm për zhvillim të zonës.

Me objektivin e dytë, përmes bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar mund të arrihen iniciativa të shumta për projekte të përbashkëta zhvillimore, me interes të përbashkët dhe të cilat do të kontribuojnë në zhvillim të turizmit apo dhe të kahjeve tjera zhvillimore, pra është mënyrë e mirë për arritjen e synimit të gjithëmbarshtëm.

S3. Zhvillimi ekonomik i zonës përmes zhvillimit të shumëllojshëm të turizmit me bashkëpunim ndërkufitar; planifikim dhe kontroll të zhvillimeve

S3.O1. Promovimi i turizmit kulturor/ekologjik/rural në zonën e Zhurit,
S3.O2. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar lidhur me zhvillim,
S3.O3. Kontroll i zhvillimeve në zonën e Zhurit,

Tab. 22. Synimi i tretë dhe objektivat e tij



KORNIZA dhe KONCEPTI I ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM HAPËSINOR

Koncepti - Mënyrë skematike e shpjegimit të zgjidhjes së problemit, me çrast, i përvetësuar si i tillë zbërthehet në hulumtime më të thella shtjellimi për çështje të fokusuara zhvillimore të zonës në fjalë.

KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR I ZIVE –“KEZH - Hidrocentrali i Zhurit”

Fakti që zona “Hidrocentrali i Zhurit” është e shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Zonë të interesit të veçantë ekonomik, orienton kah zhvillimi ekonomik përmes sektorit energjetik duke shfrytëzuar resurset ujore të zonës, akumulacionet për prodhim të energjisë porse dhe përmes kahjeve tjera të zhvillimit të zonës. Me rastin e ndërhyrjeve për investime në infrastrukturë ujore dhe energjetike, me ndërtimin e liqenit akumulues të Breznës tentohet që të gjitha resurset e tjera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore me këtë rast të përdoren për të mirë të zonës.

Llojllojshmëria natyrore dhe kulturore e zonës është potencial për zhvillimin ekonomik të zonës me shfrytëzim të kontrolluar dhe racional të këtyre resurseve për turizëm sportiv, rekreativ, kulturor, me çrast do të jetë pikë referente në kuptim të rekreimit në pjesën jugore të Kosovës.

Natyrisht, ky lloj i zhvillimit ekonomik është i domosdoshëm dhe kompletion orientimet zhvillimore përkrah zhvillimit energjetik, hidrocentralit të Zhurit me ç’rast që të gjitha këto duhet trajtuar në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm, duke mos anashkaluar asnjë nga zhvillimet tjera përcjellëse si në aspektin social ashtu edhe atë mjedisor.

KEZH - KEZH ZHUR

Koncepti i zhvillimit hapësinor, me emrin dhe shenjën e vet identifikuese “KEZH-KEZH ZHUR”, i paraqitur si në fig.34, shpreh zhvillimet e ardhshme hapësinore të planifikuara në zonën me interes të veçantë ekonomik, sipas zhvillimeve të parashikuara në zonën e portokalltë të Kopshtit të Kosovës.

Nga skema e këtij koncepti, paraqiten zhvillime si procese të vazhdueshme të cilat dhe simbolizojnë të trija synimet e vizionit me këtë Plan Hapësinor për KEZH:

- I. Prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- II. Mbrojtjen e mjedisit; dhe
- III. Mbrojtjen e ujërave.

I gjithë zhvillimi është i bazuar në zgjidhje të qëndrueshme për rivendosjen e vendbanimeve, pra zhvendosjen dhe rivendosjen e tyre në lokacion të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm, sfidë kjo e cila ka për bazë gjetjen e zgjidhjeve aspektin njerëzor si shtytës me të cilin dhe për të cilin zhvillohet zona në fjalë e Kopshtit Energjetik Zhur.

Zona qendrore e Kopshtit Energjetik Zhur, të lokalizuar në zonën e liqenit të Breznës me kanalet e hapura/mbyllura përfshin liqenin e Breznës dhe zonën buferike të kanaleve të sistemit akumulues të liqenit.

Në njërën anë synohet mbrojtje dhe riciklim i vazhdueshëm i të trija resurseve kryesore të zonës: ujit, botës së gjallë natyrore dhe energjisë, të cilat janë shprehur me shigjeta si kahje zhvillimore dhe me koncept të ngjyrave tripalëshe. Poashtu zhvillimet e ardhshme të komunave Dragash dhe Zhur, në raport me komunën më të madhe, atë të Kastriotit/Prishtinës, janë të rëndësishme në kuptim të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë. Kjo kahje zhvillimore, në kuptim të shpërndarjes së energjisë dhe bashkëpunimit, shpreh ndërvarshmërinë mes komunave Dragash dhe Zhur, porse dhe komunave përtej kufirit përmes bashkëpunimit ndërkufitar.

Zona e gjërë e cila përfshin komunën e Dragashit dhe të Prizrenit janë të hijezuara, që të reflektojnë zhvillim bazuar në resurset ekzistuese, pra atë të turizmit kulturor bazuar në trashëgiminë e shumëllojshme të regjionit porse dhe të turizmit natyror e rekreativ, bazuar në resurse natyrore e pejzazhore të vetë zonës, porse dhe afërsisë me Parkun Nacional Mali Shar.

Në përgjithësi përmes shënjes për ripërtëritje identifikohen tri qëllimet kryesore:

- I. Mbrojtja e resurseve ujore;
- II. Mbrojtja e cilësisë së jetës së gjallë; dhe
- III. Mbrojtjes nga efektet e gjithmbarshme nga prodhimi i energjisë gjatë dhe pas funksionimit të zhvillimeve të pritura.

Këto të gjitha duke përfshirë proceset e planifikimit të vendbanimeve me zhvendosjen – rivendosjen e popullatës në këto vende.

Qendrat gjeneruese me kapacitetet e tyre për prodhim dhe shpërndarje të energjisë elektrike, janë të vendosura përkrah zonës me interes të veçantë ekonomik.

Përmes këtij koncepti tentohet të arrihet:

- Planifikim dhe zhvillim i ndërlidhur dhe i koordinuar hapësinor në mes të fushave tematike të bazuara në sfidat kryesore zhvillimore të zonës së vecantë ekonomik KEZH "Hidrocentrali i Zhurit"; zbrëthimi i sfidave në synime, objektiva, projekte dhe aktivitete për zhvillimin ekonomik social e mjedisor të zonës KEZH;
- Harmonizim dhe bashkëveprim në mes të nivelit qendror dhe lokal gjatë procesit të zbatimit të projekteve konkrete dhe kontrollit të zhvillimeve brenda dhe jashtë kufirit të zonës së KEZH-it;
- Përzgjedhje të aktiviteteve sipas prioriteteve dhe implikimeve hapësinore, kohore dhe të kapaciteteve buxhetore dhe institucionale për KEZH si dhe
- Arritje të dëshiruar të zhvillimit të ardhshëm të planifikuar hapësinor, në përmbushje të Vizionit të parapërcaktuar për zonën e KEZH.

Fig. 34 Koncepti zhvillimor - HC Zhur



Pjesa e tërë e zonës së veçantë të KEZH – Kopshtit Energjetik të Zhurit, luan rolin e gjeneratorit për prodhim të energjisë ripërtëritëse në masivin e Sharrit, akumulacioneve ujore për prodhim të energjisë elektrike, shpërndarjen e energjisë së prodhuar përmes kyqjes në linjën kryesore energjetike të Kosovës, për shfrytëzim dhe shkëmbim në rrjetin rajonal të energjisë.

KEZH është pikë referente në Kosovë për trajtim të qëndrueshëm të resurseve natyrore, trajtim të vazhdueshëm të gjenerimit jo vetëm të energjisë ripërtëritëse elektrike, porse dhe përfitimeve ekonomike nga zhvillimi/shfrytëzimi i mundësive të reja të krijuara ekonomike, zhvillimit të zonës, krijimit të hapësirave të reja për rekreim, argëtim, mundësi të reja turistike.

IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM HAPËSINOR

SYNIMET E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

S1. Shfrytëzimi racional i resurseve ujore dhe mbrojtja e mjedisit

S1.01. Shfrytëzimi i ujit për hidroenergjë dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse
S1.02. Shfrytëzimi i resurseve ujore për pije dhe ujitje
S1.03. Sigurimi i minimumit ekologjik në zonën e lumenjve
S1.04. Mbrojtja nga rreziqet natyrore (erozioni, vërshimet, tërmetet, thatësia, zjarri)

Synimi 1. ka të bëjë me shfrytëzimin racional të resurseve ujore për nevojat e:

- I. prodhimit të energjisë;
- II. mbrojtjen e jetës së botës së gjallë; dhe
- III. mbrojtjes së natyrës

do të mund të arrihej me realizimin e objektivave që lidhen me të. Objektivat janë katër dhe për t'u dalluar se kanë të bëjnë me S1, janë shënuar me S1.01., S1.02., S1.03., dhe S1.04. Objektivi i parë është:

S1.01. Shfrytëzimi i ujit për hidroenergjë dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse

Ky objektivi do të arrihej me realizimin e projekteve për ndërtimin e objekteve që do të mundësonin këtë shfrytëzim që do të thotë ndërtimin e hidroelektrocentraleve HEC1, HEC2 dhe infrastrukturës së tyre përcjellëse që janë kanalet për bartjen e ujit dhe bazenet akumulues. Resurset ujore do të shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike. Dihet mirë sa shumë nevojë ka Kosova për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike, prandaj ky konsiderohet si njëri nga objektivat kryesor në mesin e të gjitha objektivave për ZIVE "Hidrocentrali i Zhurit". Në mënyrë që kjo të arrihet duhet të ndërtohet infrastruktura e nevojshme. Objektivi tjetër që lidhet me synimin është:

S1.02. Shfrytëzimi i resurseve ujore për pije dhe ujitje

Si objektivi tjetër do të arrihej me realizimin e disa masave apo projekteve. Një projekt do të ishte studimi i fizibilitetit të resurseve ujore duke përfshirë cilësinë dhe sasinë e ujit për pije dhe ujitje. Projekti tjetër do të ishte rehabilitimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësave. Ndërtimi i ujësjellësave të rinj në vendbanimet e zonës që nuk kanë të tillë, do të ishte projekti i radhës. Në funksion të arritjes së këtij objektivi është edhe realizimi i projektit për rritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm. Banorët e zonës do ta shfrytëzojnë ujin për pije dhe ujitje. Kjo do t'ua mundësojë atyre kultivimin e kulturave bujqësore dhe natyrisht do t'ua ngritë nivelin e jetesës.

S1.03. Sigurimi i minimumit ekologjik në zonën e lumenjve

Ky është objektivi i radhës, i cili nënkupton shfrytëzimin racional të resurseve ujore e njëkohësisht edhe ruajtje të mjedisit. Kjo do të thotë se nuk guxon të lejohet që sasia e ujit në lumenj të zvogëlohet nën minimumin e domosdoshëm dhe lumenjt të shterren. Sigurimi i minimumit të domosdoshëm të ujit në lumenj mundëson ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore në vendbanimet ujore duke mos lejuar kështu degradimin e këtyre vendbanimeve.

Ndërtimi i stacioneve hidrometrike monitoruese në lumenjt e zonës dhe jashtë saj është një masë apo projekt, realizimi i të cilit do të mundësonte arritjen e objektivit për sigurimin e minimumit ekologjik në zonën e lumenjve. Këto stacione do të monitoronin në mënyrë të vazhdueshme lumenjt në zonë dhe do të informonin për ndonjë rënie eventuale të sasisë së ujit në lumenj duke alarmuar kështu për marrje të masave. Konventa për Shfrytëzimin e Ujërrjedhave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare obligon për arritjen e objektivit për minimumin ekologjik. Qëllimi primar i kësaj konvente është t'i forcojë masat në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal në mënyrë që të mbrohen ujrat ndërkufitare dhe të sigurohet një shfrytëzim i qëndrueshëm i ujrave ndërkufitare si sipërfaqësore ashtu edhe

nëntokësore. Shtetet duhet të bashkëpunojnë dhe të sigurojnë që ujrat ndërkufitare të përdoren në mënyrë të arësyeshme dhe të barabartë. Kur ato ndajnë të njëjtin burim ujor, duhet të mbështeten tek njëra-tjetra në mënyrë që të zbatojnë zgjidhje sa më efektive në ruajtjen dhe shfrytëzimin e këtyre ujrave.

S1.04. Mbrojtja nga rreziqet natyrore (erozioni, vërshimet, tërmetet, thatësia, zjarri)

Siq mund të shihet ky objektivi është në funksion të mbrojtjes së mjedisit. Sikur në zonat tjera, edhe në ZIVE "Hidrocentrali i Zhurit" janë prezente rreziqet natyrore si: erozioni, vërshimet, tërmetet, thatësia dhe zjarri. Për këtë arsye duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e zonës nga këto rreziqe.

Marrja e masave për mbrojtjen e zonës nga rreziqet natyrore konsiston në realizimin e disa projekteve. Njëri do të ishte studimi i zonave erozive sipas shkallës së erozionit. Studimet e fundit për shakllën erozive janë bërë 25 vjet më parë nga Hidroekonomia e Kosovës. Rezultatet nga këto studime sot konsiderohen të vjetëruara, prandaj sot nuk e kemi një pasqyrë reale sa i përket ndikimit eroziv në zonë. Të dhënat e fundit na japin një shifër me 34% të sipërfaqes me erozion të fortë dhe shumë të fortë. Meqenëse gjendja pas 25 vitesh ka ndryshuar, është e domosdoshme të bëhen hulumtime në terren dhe në bazë të tyre të merren masa antierozive. Projekt tjetër është ndërtimi i pritave dhe kaskadave malore. Ndërtimi duhet të bëhet paralelisht me realizimin e projektit për ndërtimin e hidrocentralit në mënyrë që të parandalohet erozioni, sepse erozioni do t'i mbushte bazenet akumuluese me depozitime erozive duke penguar kështu realizimin e projektit për hidrocentral. Këto masa duhet të ndërmerren urgjentisht në fshatrat: Restelicë, Zlipotok, Krushevë, Brod, Gllloboçicë, Baçkë, Dikancë, Mlikë, Kukljan, Leshtanë, Vranishtë, Xërx, Pllajnikë dhe Rrenc. Projekti i radhës apo masa që duhet të merret në mënyrë që të arrihet objektivi për mbrojtje nga rreziqet natyrore është pyllëzimi i zonave të zhveshura. Kjo është edhe një masë tjetër në funksion të parandalimit të erozionit. Sa i përket rrezikut nga tërmeti, një projekt i nevojshëm për t'u realizuar, si njëra prej masave mbrojtëse, është hartimi i hartës së mikrosizmitetit për zonën e ngushtë të ndërtimit. Për shkak të rëndësisë së projektit të hidrocentralit, rrezikut nga tërmetet që u kanoset kanaleve që bartin ujin dhe dy bazeneve akumuluese, duhet të studjohet zona dhe në detale të paraqiten elementet seizmologjike në mënyrë që statika e ndërtimit t'i përshtatet seizmikës së zonës dhe kështu objektet e ndërtuar t'u rezistojnë më shumë tërmeteve eventuale. Një projekt tjetër, realizimi i të cilit do të ishte në funksion të arritjes së objektivit për mbrojtjen nga rreziqet natyrore, konkretisht nga zjarri është hartimi i planeve emergjente preventive për shpëtim nga zjarret. Pyjet përfshijnë 56% të zonës, ato shtrihen edhe në vazhdim prapa vijës kufitare të zonës, andaj duhet të përgaditet elaborati për mbrojtje nga zjarri sepse pasojat mund të jenë katastrofale për HC Zhur. Zjarret në pyje janë të shpeshtë për shkak të pakujdesisë së faktorit njeri, andaj duhet të kihet parasysh mbrojtja nga zjarri duke përgaditur ekupe në nivel të HC Zhur dhe komunave pjesëmarrëse Dragash dhe Prizren.

S2. Planifikimi i vendbanimeve dhe zhvendosjes së popullsisë në zonë

Arritja e këtij synimi së bashku me dy të tjerat, do të mundësojë realizim të vizionit të deklaruar përmes objektivave si më poshtë. Pra, në zonën e interesit, kërkohet të mbizotërojë rregullim i planifikuar i vendbanimeve pjesëmarrëse, pas kryerjes së proceseve të shpronësimit, kompenzimit si dhe për zhvendosjes së popullsisë e të varrezave. Këto procese, do të kryhen, me përgjegjësi të madhe dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë, nga institucionet vendore qeveritare. Fillimisht, do të kryhet shpronësimi i pronave të cilat për akumulim të ujit në liqenin artificial të Breznës dhe në rezervoarin artificial të Zymit në lumin Plava. **Më tej, zbatimi i marrëveshjes që do të arrihet, në mes pronarëve (pjesëtarë të komunitetit) dhe Komisionit Qeveritar për shpronësim dhe kompenzim, do të kryhet duke u bazuar në mënyrën e kompenzimit të vet-deklaruar nga secili pronar.** Në fund, pas mbarëvajtjes së këtyre proceseve, si dhe pas përcaktimit të lokacionit të ri për banim të popullsisë që zhvendoset, por edhe për vendbanimet tjera brenda zonës, kërkohet të hartohen planet rregulluese. Këto plane rregulluese, për të gjitha vendbanimet e zonës së interesit, do të jenë rezultat i planifikimit, urbanizimit dhe rregullimit efikas, e gjithashtu edhe mjet për kontrollë të zhvillimeve të ardhshme në këtë hapësirë.

Shkurtimisht, ky synim do të arrihet duke e derivuar në këto Objektiva:

S2.01. Shpronësimi dhe kompenzimi nën ujdi i pronave që përmythen nga akumulimet e ujit;
S2.02. Zhvendosja dhe rivendosja e popullsisë dhe e varrezave si dhe
S2.03. Planifikimi dhe kontrolla e zhvillimeve në zonë.

S2.01. Shpronësimi dhe kompenzimi nën ujdi i pronave që përmythen nga akumulimet e ujit;

Kjo objektivë arrihet, duke u bazuar në ligjin për shpronësim, mirëpo për të qenë sa më efikas, sikur edhe për objektivën tjetër të radhës nevojitet të hartohet Korniza e Politikave për Zhvendosje, ngajshëm me atë për FMR (Fushën e Mihjes së Re). Këtu, gjatë takimeve të Institucioneve të Qeverisë me komunitetin, do të identifikohen përfaqësuesit e preferuar, për të themeluar edhe Zyrën Këshilldhënëse. Komisioni nga kjo zyrë do të këshilloj komunitetin për nevojat e tyre dhe është në shërbim të tij. Me qëllim të mbarëvajtjes së punës në inventarizim, vlerësim, kompenzim të pronës paraprake dhe evidentim e kontraktim të pronës së re, do të bashkëpunoj në mënyrë të drejtpërdrejt me ZSH (Zyrën për Shpronësim) në MF (Ministrinë e Financave) si dhe DP (Departamentin e Shpronësimit) dhe AKK (Agjencinë Kadastrale të Kosovës) në MMPH (Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor). Po ashtu, nga kjo Zyrë dhe nga institucionet e përmendura, do të hartohet edhe doracakut për vlerësimin e pronave të pa tundshme, me kritere të barabarta për të gjithë. Atëherë, pas arritjes së pajtueshmërisë së plotë, në këtë Zyrë, do të nënshkruhen edhe kontratat me pronarët, mbi llojin dhe mënyrën e kompenzimit të pronës, si dhe në bazë marrëveshjeje mund të bëhet edhe monitorimi i zbatimit të tyre.

Prandaj, kjo objektivë do të arrihet me këto aktivitete, që mund të jenë masa, veprime apo projekte, si:

S201A1. Takime gjithpërfshirëse me komunitetin;
S201A2. Themelimi i zyrës këshilldhënëse;
S201A3. Krijimi i bazës së të dhënave me inventarizim, vlerësim, kompenzim dhe evidentim të pronës së re;
S201A4. Hartimi i doracakut me kritere të barabarta për vlerësim të pronës dhe mënyrat e kompenzimit;
S201A5. Zbatimi i kontratave nën ujdi mes Qeverisë dhe titullarit të pronës, dhe
S201A6. Zbatimi i 80% të kompenzimit të shpronësimit në ndërtimin e shtëpive të reja.

S2.02. Zhvendosja dhe rivendosja e popullsisë (Breznes dhe Zymit) dhe e varrezave

Kjo objektivë arrihet, në atë mënyrë, që pas evidentimit të pronarëve që duan kompenzim të pronës me pronë, dhe në zbatim të Kornizës së Politikave për Zhvendosje (të aprovuar – deri atëherë), gjendet vendi i përshtatshëm për lokacion të ri banimi për vendosjen e popullsisë që zhvendoset. Për lokacionin e ri, që ndahet për rivendosje të popullsisë që zhvendoset, kërkohet të hartohet Plan Rregullues, nga Komuna e Dragashit. Plani Rregullues për lokacionin e ri, do të ofroj, përveç banimit të koncentruar dhe efikas edhe qasje të mirë në infrastrukturë dhe shërbime qofshin ato teknike apo sociale.

Qështje tjetër dhe shumë e ndijshme, krahas zhvendosjes së popullsisë, është edhe zhvendosja e varrezave, nga sipërfaqet e tokës që do të përmythen nën ujë. Këtu, duhet patut shumë kujdes në arritje të pajtueshmërisë së plotë, me të afërmit e të varrosurve si dhe me bashkësinë fetare të cilës i përkasin, në përcaktim të lokacionit si dhe gjatë procedurave të nxjerrjes së eshtrave dhe rivarrimit të tyre.

Megjithatë, kjo objektivë do të arrihet me këto aktivitete:

S202A1. Hartimi, aprovimi dhe zbatimi i Kornizës Politike të zhvendosjes për HC Zhur;
S202A2. Përcaktimi dhe ndarja e lokacionit për banim të ri për popullsinë që zhvendoset;
S202A3. Hartimi i Planeve Rregulluese për lokacionet e reja dhe vendbanimet ekzistuese në zonë, dhe
S202A4. Përcaktimi i lokacionit dhe zhvendosja e varrezave.

S2.03. Planifikimi dhe kontrolli i zhvillimeve në zonë

Kjo objective arrihet, së pari, me një marrëveshje në mes të Institucioneve Qeverisëse vendore, të asaj qendrore (MMPH) dhe lokale (Komuna e Dragashit), për marrjen e vendimit për kontrollin e zhvillimeve dhe mosvazhdim të ndërtimeve të reja në hapësirat e zonës së interesit pa plane rregulluese. Kurse, kjo kontrollë, duhet të jetë rigorozë dhe të bazuara në plane që shërbejnë si instrument si dhe të kryhet nga inspektorati. Ndërsa, së dyti arrihet me hartimin e planeve gjegjëse, për zonat e banimit, qofshin ato të reja apo ekzistuese, si dhe ato për infrastrukturë e shërbime teknike, kulturore, turistike e sociale, duke prirë me më të domosdoshmet dhe afatshkurta. Pas gjithë kësaj, përfundimisht dhe së treti, pas kryerjes së hartimit dhe aprovimit të planeve rregulluese, fillon edhe ndërtimi i objekteve dhe kontrolli e zhvillimeve të bazuara në këto plane.

Natyrisht, kjo objektivë do të arrihet me aktivitetet e përmendura, pra me:

S2O3A1. Vendimi për ndalimin e ndërtimeve pa plan rregullues në zonën e interesit;
S2O3A2. Zbatimi i vendimit nga inspektorati për ndalimin e ndërtimit pa plan rregullues;
S2O3A3. Hartimi i Planeve Rregulluese për vendbanimet pjesëmarrëse në zonën e interesit
S2O3A4. Hartimi i planeve për infrastrukturë dhe shërbime teknike;
S2O3A5. Ndërtimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të domosdoshme në zonën e interesit, dhe
S2O3A6. Ndërtimi i komplekseve për banim dhe të objekteve sociale.

S3. Zhvillimi ekonomik i zonës përmes zhvillimit të shumëllojshëm të turizmit me bashkëpunim ndërkufitar; planifikim dhe kontroll të zhvillimeve

Strategjia e zhvillimit ekonomik të ZIV "HC Zhur" bazohet në konceptin e zhvillimit hapësinor i cili ka për bazë mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore për përfitime ekonomike duke e nxitur zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, turizmit dhe industrisë, gjithnjë duke u bazuar në direktivat e BE-së.

Zona në fjalë ka potencial ekonomik për shkak të morfologjisë së terrenit e cila karakterizohet me lugina, burime të lumenjve, llojlojshmëri të botës bimore dhe shtazore, terrene për sporte dimërore dhe verore, si dhe me llojlojshmëri të trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore. Burimet natyrore mundësojnë akumulimin e sipërfaqeve ujore në liqe për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme në HC-Zhur. Akumulimi i sipërfaqeve ujore në liqe do të krijojë pejzazh atraktiv si dhe afërsia e PN "Mali Sharr" do të rrisin interesimin për vizitorët që rezultojnë me zhvillimin e turizmit. Traditat blegtorale të popullatës dhe shfrytëzimi i kullosave të zonës, do të stimulohen për kultivim të blegtorisë dhe prodhimeve të tyre nga ai ekstensiv në atë intensiv si dhe industrinë për përpunimin e ushqimit.

Pozita e ZIV në kufi me Shqipërinë ofron mundësi për bashkëpunim ndërkufitar me programe dhe aktivitete të përbashkëta të zhvillimit në nivel lokal mes komunave dhe vendbanimeve fqinje. Zhvillimet e vendbanimeve në zonë do të jenë të kontrolluara nga organe kompetente përgjegjëse për monitorim.

Ky zhvillim mbështet në objektivat të cilat do të realizohen përmes projekteve masave dhe aktiviteteve si:

S3O1. Përparimi i zhvillimit të blegtorisë dhe promovimi

Ky objektivë ka për qëllim ndryshimin e aktiviteteve blegtorale të popullatës lokale nga prodhimi ekstensiv në atë intensiv (realizimi i kushteve për zgjerimin e fermave, integrimi i tyre dhe llojlojshmëria e produkteve) që synon në rritjen ekonomike. Organizimi i grumbullimit dhe plasimit të produkteve në treg përmes mekanizmave dhe aktorëve ekzistues të tregut. Ky ndryshim mund të ofrojë popullatës ekzistuese mundësi reale të ngritjes ekonomike për të vazhduar me praktikatat e tyre tradicionale, të nxis interesin për investime dhe do të ulë shkallën e migrimit.

Ky objektiv në ZIV "HC Zhur" do të arrihet përmes këtyre projekteve, masave dhe aktiviteteve:

- Subvencionimi dhe ringjallja e blegtorisë, krijimi i kushteve për punësim në zonë, mundësimi i kredive të favorshme me kamata të ulëta dhe afatgjata;
- Mirëmbajtja dhe meliorimi i kullosave;
- Mbështetje për themelimin e fermave dhe kultivimin e kuajve, qenit të Sharrit, dhitë e egra, shpezëve dhe kafshëve të tjera atraktive për vizitorë;
- Mbështetje e Ekonomive familjare për produkte blegtorale (qumështi, fruta, shpezëtari etj.)
- Zbatimi i projekteve për bujqësi organike;
- Kultivimi i patates;
- Rritja e fondit të gjedheve dhe përmirësimi i racës;
- Mbështetje popullatës së zonës për vetëdijësimin e fermerëve për blegtori (veterinë, teknologji ushqimore, pylltari, agrobiznes etj.); Organizimi i punëtorive dhe shërbimeve këshillëdhënëse për rritjen e cilësisë së kultivimit blegtoral;
- Ngritja e punkteve grumbullues për:
 - o grumbullimin e frutave të imta dhe bimëve mjekuese;
 - o grumbullimin e qumështit nga gjedhet;

- Hartimi i projektit për krijimin e simbolit karakteristik unik për prodhimet e zones - eko prodhime dhe ambalazhimi i tyre;

S302. Zhvillimi dhe promovimi i turizmit kulturor/rekreativ/ekologjik/rural

Favorizimi dhe ngritja e sektorit të turizmit do të thotë arritje e synimit për rritjen e numrit të vizitorëve në zonë. Vendbanimet e zonës dhe për rreth saj do të fuqizohen përmes vetëdijesimit dhe informimin për mundësitë e ngritjes mirëqenies së tyre përmes industrisë turistike që do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik, ku të hyrat nga këto aktivitete do të jenë plotësim i të hyrave materiale familjare, ndërsa më vonë burim kryesor i të ardhurave. Në fillim për ngritjen e zhvillimit të turizmit do të ketë nevojë për investime në infrastrukturën e nevojshme të mbështetura nga Shërbimi Këshillëdhënës Rural (SHKR) duke organizuar trajnime teknike profesionale për zanate dhe iniciativa për diversifikim rural për biznes, përfshirë këtu fshatin - eko-turizmin (në bazë të objektivave të përgjithshme për zhvillimin agro-rural në Kosovë të parapara në PZHRB 2007-13).

Ky zhvillim mund të mbështetet fillimisht me këto projekte apo masa dhe veprime:

1. Program për vetëdijesimin e komunitetit për ruajtjen e kulturës dhe traditave të popullsisë që jetojnë në zonë (folklori, promovimin e ngjarjeve kulturore dhe traditave, ceremonisë martesore, festave tradicionale, lojërave, etj),
 - Plotësimi i plan-programeve arsimore për industrinë e turizmit;
 - Arsimimi i kuadrove profesioniste për nevojat e turizmit;
2. Veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin e turizmit rural dhe ekologjik;
3. Metodatat për përfitime nga shfrytëzimi ekologjik i zonës;
 - Projekt për identifikimi dhe adaptimi e shtëpi/ bujtina për eko turizëm;
 - Ofrimi lehtësimi në tatime për stimulimin e banorëve për involvim në industrinë turistike si dhe kushteve të favorshme për investime në turizëm;
 - Harmonizimi i PH "HC- Zhur", PH parku Nacional "Mali Sharë", PZHK Dragash dhe PZHK Prizren në dobi të zhvillimit të turizmit.
4. Marketingu – promovimi për Eko-Turizëm - me këtë aktivitet promovojmë vlerat e natyrës, trashëgimisë kulturore, kapaciteteve rekreative dhe të eko turizmit me qëllim të informimit sistematik për joshjen e vizitorëve përmes;
 - Hartimi i hartave, broshurave dhe video klipeve për vlerat dhe kapacitetet turistike në zonë;
 - Organizimi dhe mbajtja e panairove për promovimin: e vlerave pejzazhore natyrore, prodhimeve blegtorale karakteristike të zonës në dobi të turizmit; Promovimi i traditave kulturore dhe sporteve tipike lokale; Promovimi i turizmit rural;
 - Pjesëmarrje aktive në Panaire dhe konferenca ndërkombëtare për turizëm;
 - Distribuimi i materialit propagandistik për zonën nëpërmes: Mediave vendore dhe ndërkombëtare; Agjencioneve turistike; Ambasadave të Republikës së Kosovës; Avio kompanive që kanë destinacion Kosovën;

S303. Bashkëpunimi ndër-komunal dhe ndër-kufitar për zhvillim të zonës

Me këtë objektiv tentohet të arrihet marrëveshja për perspektiva te reja për zhvillim duke i respektuar kriteret dhe normat ndërkombëtare. Realizimi i këtij objektiv i mundëson arritjen bashkëpunimit për mbrojtjen e mjedisit, krijimin e planeve të përbashkëta për zhvillim, krijimi i mundësive për marrjen e përvojave dhe përsosjen e tyre nga vendet të ngjashme në rajon dhe më gjerë. Ky objektiv ndihmon në identifikimin e problemeve mundësive zhvillimore të përbashkëta fqinjësore, përzgjedhjen e masave dhe veprimeve për tu bashkërenditur drejt zhvillimit të zonave rurale që kufizohen mes vete.

Ky objektiv do të arrihet përmes këtyre projekteve, masave dhe aktiviteteve:

- Nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim;
- Formimi i organizmave ndërkomunal që iniciojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin ndërkufitar;
- Ngritja e iniciativave për harmonizimin e strategjive zhvillimore të komunave fqinje të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë (IPA);

- Harmonizimi i strategjive zhvillimore lokale të komunave/vendbanimeve në zonat kufitare për identifikimin dhe zgjidhjen prioriteteve drejt zhvillimit rural ndërkufitar; Harmonizimin e rregulloreve dhe masave mbrojtëse për resurset natyrore ndërkufitare;
- Aktivitetet dypalëshe për bashkëpunim rajonal;
- Monitorimi dhe kontrolli i zhvillimeve sipas planeve.

PLANI I VEPRIMIT

Synimi S1							
Shfrytëzimi racional i resurseve ujore dhe mbrojtja e mjedisit							
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi në Euro	
Shfrytëzimi i resurseve ujore për pije dhe ujitje	1	Studimi i fizibilitetit të resurseve ujore përfshirë sasinë dhe cilësinë për ujë të pijshëm dhe ujitje.	Qeveria e Kosovës	MMPH	#	BK	70.000
	2	Rehabilitimi në rrjetin ekzistues të ujsjellesit	MEF= KRU-Hidroregjioni jugor	KRU-Hidroregjioni jugor + Komuna	#	BK	300.000
	3	Ndërtimi i rrjetave të ujsjellesit të rinj në vendbanime që nuk kanë, në zonë.	MEF= KRU-Hidroregjioni jugor	KRU-Hidroregjioni jugor + Komuna	#	BK	350.000
	4	Rritja e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm	MEF= KRU-Hidroregjioni jugor	KRU-Hidroregjioni jugor + Komuna	#	BK	170.000
Shfrytëzimi i ujit për hidroenergjë dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellese	1	Ndërtimi i Hidroelektrocentralit (HEC1) me infrastrukturën përcjellese	Qeveria e Kosovës	MEM-MMPH-MEF	##	BK	200.000.000
	2	Ndërtimi i Hidroelektrocentralit dy (HEC2) me infrastrukturën përcjellese	Qeveria e Kosovës	MEM-MMPH-MEF	##	BK	50.000.000
Sigurimi i minimumit ekologjik në zonën e lumenjve	1	Ndërtimi i stacioneve hidrometrike të rendit të dytë monitoruese në lumenjtë e zonës dhe jashtë saj.	MMPH - IHMK	IHMK	#	BK	80.000
Mbrojtja nga rreziqet natyrore (erozioni, vërshimet, tërmetet, thatësira, zjarri)	1	Studimi i zonave erozive sipas shkallës së erozionit	MMPH-MBZHR	MMPH-MBZHR	*##	BK	100,000
	2	Ndërtimi i pritave dhe kaskadave malore	MMPH-MBZHR	MMPH-MBZHR	###	BK	20,000
	3	Pyllëzimi i zonave të zhveshura	MBPZHR	AKP+Komuna	Vazhdimsi	BK	1.000.000
	4	Ndërtimi i hartës së mikrosizmitetit në zonën e ngushtë ndërtimit.	MEM	MEM	*	BK	30,000
	5	Hartimi i planeve emergjente preventive për shpëtim nga zjarret, thatësia	Komuna +Kompanit	Komuna	#	BK	50.000

Synimi S2							
Planifikimi i vendbanimeve dhe zhvendosjes së popullatës të zonës							
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi në €uro	
Shpronsimi	1	Plotësimi i kornizës ligjore dhe institucionale	Qeveria Kuvendi	MMPH, MEM, MEF	*	BK	20,000
	2	Takime gjithpërfshirëse	Qeveria	MMPH, Komuna	*	BK	10,000
	3	Themelimi i Zyres këshilldhënëse	Qeveria	MMPH, Komunat	*	BK	200,000
	4	Themelimi i zyrës së Komisionit për zhvendosje (në kuadër të MMPH-së) dhe krijimi i bazës së të dhënave (inventarizimi, vlerësimi, kompenzimi dhe evidentimi i shpronësimit)	Qeveria	MMPH, MEM, MEF, AKK, Komuna	*	BK	1,000,000
	5	Hartimi dhe zbatimi i kriterëve të dakorduara	MMPH MEF	ZKZH, Komuna	*	ska	0
	6	Arritja e pajtueshmërisë në mes të Qeverisë-Komunitetit dhe kontraktimet me titullarin	MMPH MEF	ZKZH, AKK, Komuna	*	ska	0
	7	Zbatimi i 80 % të kompenzimit të shpronësimit për ndertimin e	MMPH	ZKZH	*	BK	Hulumtim 40,000,000
Zhvendosja	1	Aprovimi dhe zbatimi i Kornizës së Politikave për zhvendosje)	Qeveria	MMPH, ZKZH	*	BK	Hulumtim
	2	Përcaktimi i lokacionit për vendosjen e popullsisë nga vendbanimet e zhvendosura	Komuna	Komuna	*	BK	2,000
	3	Hartimi i Planeve Rregulluese për Lokacionet e reja	MMPH Komuna	Komuna,	*	PPP	40,000
	4	Përcaktimi i lokacionit dhe zhvendosja e varrezave	MMPH Komuna	Komuna, Komuniteti	*	PPP	30,000
Planifikimi i zhvillimeve në zonë	5	Nxjerrja e Vendimit për ndalimin e ndërtimeve në zonën e interesit	Qeveria	Komuna,	*	ska	E kryer
	6	Zbatimi i vendimit nga Inspektorati	Komuna	Inspektorati,	*	ska	
	7	Hartimi i Planeve Rregulluese për VB në zonën e interesit	Komuna	Komuna	*	PPP	200,000
	8	Hartimi i planeve të infrastrukturës fizike (Rrugëve, ujësjellës, kanalizim, energjetikë, telefoni)	Qeveria Komuna	Komuna,	*	PPP	30,000
	9	Ndërtimi i infrastruktures të nevojshme në zonë	Qeveria Komuna	Komuna,	*	PPP	5,000,000
	10	Ndërtimi i objekteve sociale (shkolla, shtëpi shëndeti, objekte kulturore, të sigurisë etj.)	Qeveria Komuna		*	PPP	1,000,000

Synimi S3 Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik							
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi në €uro	
Promovimi dhe përparimi i zhvillimit të blegtorisë;	1	Subvencionimi dhe ringjallja e blegtorisë , krijimi i kushteve për punësim në zonë, Mundësimi i kredive të favorshme me kamat të ulëta dhe afatgjata; Mirëmbajtja dhe meliorimi i kullosave; Mbështetje për themelimin e fermave dhe kultivimin e kuajve, qenit të Sharrit, dhitë e egra, shpezëve.....dhe atraktive për vizitorë; Mbështetje e Ekonomive familjare për produkte blegtorale (qumështi, fruta, pulari etj.) Zbatimi i projekteve për bujqësi organike; Kultivimi i patates; Rritja e fondit të gjedheve dhe përmirësimi i racës		QK, KK Prizren, KK Dragash	**	QK, KK Prizren, KK Dragash	2.000.000
	2	Mbështetje populatës së zonë në vetëdijësimin e fermerëve për blegtori (veterinë, teknologji ushqimore, pylltari, agrobiznes etj); Organizimi i punëtorive dhe shërbimeve këshillëdhënëse për rritjen e cilësisë së kultivimit blegtoral		QK, KK Prizren, KK Dragash	***	BE, BK, QK, KK Prizren, KK Dragash	180.000
	3	Punkti grumbullues; Ngritja e stacionit për grumbullimin e frutave të imta dhe bimëve mjekuese; Stacioni për grumbullimin e qumështit nga gjedhet		QK, KK Prizren, KK Dragash	*	BE, BK, QK, KK Prizren, KK Dragash	150.000
Promovimi dhe zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore/rekreative/ekologjike/rurale në zonë;	1	Vetëdijësimi për ruajtjen e kulturës dhe traditave të popullsisë që jetojnë në zonë (folklori), veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin e turizmit rural dhe ekologjik; Ngritja e vetëdijes në ruajtjen dhe promovimin e ngjarjeve kulturore dhe traditave; (ceremonisë martesore)			***	QK, KK Prizren, KK Dragash	150.000
	2	ECOZONA –TURISTIKE Marketing për ekoprodhime; Organizimi dhe mbajtja e panairove për promovimin e prodhimeve blegtorale; Ambalazhimi dhe krijimi i simbolit karakteristik dhe unik për prodhimet e zonës; Propagandimi i vlerave natyrore, pejzazhore dhe			***	QK, KK Prizren, KK Dragash	1.000.000

		karakteristikave të tjera kulturore të zonës në dobi të turizmit; Promovimi i traditave dhe sporteve tipike lokale					
	3	Organizimi për menaxhimin e shtëpive të zbrazëta në zonë për turizëm fshatar; agjensi turistike; promovimi i turizmit rural			*	PPP	500.000
Bashkëpunimi ndër-komunal dhe ndërkufitar për zhvillim të zonës;	1	Ngritja e iniciativave për harmonizimin e strategjive zhvillimore të komunave fqinje të Kosovës dhe Shqipërisë, Maqedonisë (IPA)		KK Dragash, KK Prizren	**	BE, Shqipëri Maqedoni Kosovë	150.000
	2	Strategjia për krijimin e fondit për zhvillim të komunitetit (fshatrat e ndikuara në mënyrë direkte dhe indirekte)		KK Dragash, KK Prizren	**	KK Dragash, KK Prizren	150.000
GRAND TOTAL							302,962,000

STRATEGJIA E TRENDIT

Strategjia e trendit nënkupton zhvillimet e pakoordinuara dhe të paplanifikuara sipas të cilave mundësohet vazhdimi i trendit momental të zhvillimeve, të mos zhvillimeve me përmasa kapitale dhe të ndërhyrjeve të pakontrolluara në hapësirë, të investimeve vetanake individuale të paplanifikuara e të pa kritere. Këto strategji nuk sjellin zhvillim të harmonizuar dhe me perspektivë, të udhëhequr nga një vizion dhe qëllime specifike, qasje dhe strategji të dakorduar të veprimeve.

Përveç kësaj, zhvillimet e tilla nuk janë të mbështetura në ndonjë planifikim të aktiviteteve, të bazuara në ndonjë studim, hulumtim apo plan të hartuar paraprakisht me afate kohore, implikime buxhetore si dhe kornizë të nevojshme institucionale për zbatim.

Sa i përket energjisë së ripërtëritshme, institucionet e Kosovës sikurse në aspekt legjislativ dhe dokumenteve strategjike, ka futur energjinë e ripërtëritshme si prioritet, përderisa mospërmbushja e kërkesave për prodhimin e energjisë elektrike të ripërtëritshme do të thoshte mos përkrahje e iniciativave evropjane dhe synimeve për energji të qëndrueshme.

“STRATEGJIA E ENERJISË E REPUBLIKËS TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2009–2018 (Rishikimi i Strategjisë së Energjisë për Periudhën 2005-2015)

Kjo Strategji i kushton vëmendje të veçantë përputhshmërisë me aquis të Bashkimit Evropian, aquis këto që për sektorin energjetik janë të obligueshme për Kosovën në kuadër të anëtarësisë në Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Strategjia synon stimulimin e përdorimit racional të energjisë dhe rritjen e efijencës së përdorimit të saj, shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, futjen e teknologjive të reja dhe zbatimin e standardeve mjedisore siç ato parashikohen me ligj.

“LIGJI MBI ENERJINË 2004/8”

Eficienca e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme - Sipas nenit 10 të Ligjit mbi Energjinë 2004/8 parashtron kornizën për implementimin e parimeve të efijencës së energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë. Në veçanti, paragrafi (a) i nenit 10 lidhet me përgatitjen e një plani të implementimit për të promovuar përdorimin eficient të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme. Masat për efijencë të energjisë dhe menaxhim të kërkesës janë të rëndësishme kritike për zvogëlimin e normës së lartë të rritjes së kërkesës vjetore për energji, e cila shfaqet kryesisht për shkak të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje.

Kosova ka zhvilluar caqet indikative vjetore edhe 10-vjeçare për burime të ripërtëritshme. Ajo gjithashtu ka përpiluar planin e detajuar për implementimin e (i) Direktivës 2001/77/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 shtator 2001 mbi promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burime të ripërtëritshme të energjisë në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, dhe (ii) Direktivës 2003/30/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 8 maj 2003 mbi promovimin e shfrytëzimit të bio-karburanteve dhe karburanteve tjera të ripërtëritshme për transport.

Në mars të vitit 2007, udhëheqësit e 27 vendeve të BE, adoptuan qëllimin prej 20% të energjisë së ripërtëritshme nga konsumi i përgjithshëm final deri në vitin 2020. E kombinuar me zotimin për rritjen e efikasitetit të energjisë për 20% deri në vitin 2020, udhëheqësit politik përgatitën terrenin për një të ardhme më të qëndrueshme për Bashkimin Evropian dhe gjenerata të reja.

Direktiva RES dhe Energjia elektrike nga burimet e energjisë së ripërtëritshme

Cakton projeksionet për energji ripërtëritëse si konsum final të energjisë deri në vitin 2020, përfshirë dhe 10% të energjisë ripërtëritëse në transport, i cili është i kalkuluar në bazë të kontributit të cdo shteti, plus një rritje lineare prej 5.5 % për shtetet anëtare, varësisht nga BPV.

Bashkimi Evropian ka për qëllim të ketë 21% të energjisë elektrike nga burimet e energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2010. Ky qëllim është formuluar në Directive 2001/77/EC për promovimin e energjisë elektrike të ripërtëritshme. Disa nga shtetet anëtare (Gjermania, Spanja dhe Danimarka) janë në rrugë të mirë, të tjerët janë më larg.

Strategjia Zero në zonën e KEZH-së do të ketë për pasojë:

- Vazhdimin e reduktimeve të energjisë elektrike;

- Ngecjen në zhvillim ekonomik të vendit;
- Përkeqësimin e kualitetit të jetesës;
- Rritjen e papunësisë;
- Mbylljen e obliguar të TC-ve ekzistuese "Kosova A dhe Kosova B" sipas afateve të paracaktuara kohore;
- Rritjen e importit të energjisë elektrike nga vendet fqinje;
- Koston e lartë të energjisë elektrike nga importi për konsumin vendor;
- Vazhdimin e zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore;
- Humbjen dhe degradimin e tokës bujqësore si dhe të mjedisit për rreth.

STRATEGJIA SIPAS KONCEPTIT ZHVILLIMOR

Autoritetet e institucioneve qendrore në bashkëpunim me donatorët e jashtëm të interesuar, do të ndërmarrin masat e duhura në drejtim shfrytëzimit të burimeve vendore të energjisë, të rezervave të linjitet për nevoja gjeneruese dhe përmbushjes së kërkesave të BE-së për burime ripërtëritëse të energjisë elektrike. Në mënyrë direkte zhvillimi i kapaciteteve të reja energjetike do të mundësojë furnizim të sigurtë të energjisë elektrike në periudhë afatgjate dhe zhvillim më të qëndrueshëm (mjedisor, ekonomik e social). Natyrisht, kjo është bazë e sigurtë dhe çështje pararendëse për investime të jashtme e të brendshme, në të gjitha fushat e ekonomisë së dobësuar kosovare.

Qeveria e Kosovës e ka të qartë, që në një periudhë shumë të afërt kohore, duke marr parasysh dinamikën e zhvillimeve të shpejta në rajon dhe më gjërë, e sidomos përkujdesjes ndaj ndryshimeve klimatike si shkas i ngrohjes globale, krizës financiare në botë, do të jetë shumë e më vështirë shfrytëzimi i mëtejshëm i (nxjerrjes dhe djegies) resursit të linjitet për prodhim të energjisë elektrike.

Fondi për tu dedikuar për zhvillimin e komunitetit do të mbështet programet për zhvillim të komunitetit të ndikuar nga zhvillimi i KEZH. Qëllimi i fondit është që ti ndihmohet komunitetit për të përmirësuar jetën e tyre, mjedisit social dhe fizik, në aftësimin e tyre dhe pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes.

Qeveria e Kosovës do të shpronësojë hapësirën e cila nevojitet për ndërtim të sistemit, përderisa rivendosja në lokacion tjetër do të jetë bazuar në konsensus me banorët e zonës. Zhvillimi i procesit të zhvendosjes - rivendosjes së popullatës nga vendbanimet në KEZH, gjithashtu, ka rëndësi të veçantë, bile shumë të ndjeshme. Rivendosja e tyre në vendbanimet e reja, kërkon planifikim dhe kontrollë në densifikim dhe zgjërime të vendbanimeve ekzistuese, në një mjedis jetësor më të pastër. Kjo arrihet me hartimin e planeve rregulluese urbane.

Përcaktohet dhe zbatimi i brezit rrethues, tamponit të gjelbër dhe barrierave tjera, me qëllim të mbrojtjes së popullatës dhe të mjedisit jetësor nëpër vendbanimet për rreth zonës së ndikuar.

Strategjinë e zhvillimeve sipas konceptit, e shprehë harta e mëposhtme, e paraqitur si në fig.35., e cila nënkupton përzgjedhjen më të mirë të mundshme të zhvillimeve. Këtu janë vlerësuar dhe shtjelluar opsionet më të preferuara, për proceset e zhvilluara dhe shumë të ndërlydhura për zonën me interes të veçantë ekonomik HC Zhur.

Përfundimisht, përfitimi është i shprehur edhe në zhvillimin e vendbanimeve në formë të koncentruar dhe më të dendësuar se sa që ishte më parë, në favor të ruajtjes së tokës bujqësore por edhe të shtrirjes së infrastrukturës si dhe lehtësimit në ofrim të shërbimeve teknike dhe sociale.




Fig. 35. Harta e zhvillimit hapsinor të ZIVE "HC Zhur"

VLERËSIMI I STRATEGJIVE

Natyrisht, që të nënkuptohet dhe të sigurohet se strategjia sipas konceptit zhvillimor të Planit Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik të KEZH është e mirë dhe pozitive, duhet të përballet me çfarëdo strategjie tjetër të hartuar, duke i krahasuar ato nëpër kriteret e njohura për vlerësim të strategjive.

Me këtë rast, meqë nuk kemi strategji tjera të përgatitura më parë, bëhet krahasimi ndërmjet dy strategjive të elaboruara në këtë kaptinë si fazë e katërt e këtij dokumenti, pra vlerësimi dhe krahasimi ndërmjet "Strategjisë ZERO" – trendit të zhvillimit (duke mos bërë asgjë në kuptim të qëllimit të prodhimit të energjisë ripërtëritëse elektrike) dhe "Konceptit të zhvillimit hapësinor", që nënkupton vazhdimësinë e zhvillimeve të vendbanimeve dhe jo të kapaciteteve të reja ekonomike, akumulacioneve të ujit, hidrocentraleve, resurseve të reja ekonomike turistike. Këto indikatorë janë të prezentuara në tabelën 23 si në vijim. Vlerësimi është kuantitativ i shprehur për nga cilësimi kualitativ i dukurive dhe përfitimeve në kuptim të ngushtë lokal dhe rajonal sikurse dhe në kuptim të gjërë shtetëror.

Kriteret për vlerësim Strategjia, duhet të jetë, ...		Strategjia sipas trendit (ose strategjia "0")		Strategjia sipas konceptit të zhvillimit të planifikuar hapësinor	
1	Reale dhe e zbatueshme (ofrimi drejt përfitimeve ekonomike dhe sociale)	0	Vazhdon zhvillimi i vendbanimeve rurale pranë një parku nacional buzë kufirit me Shqipëri	1	Arrihet qëllimi i plotësimit të kushtit për energji ripërtëritëse (përfitim lokal dhe shtetëror)
2	Aresyeshmëria ekonomike	0	Deri diku por pa përfitime të qarta	1	E definuar qartë për nga aspekti i përfitimeve ekonomike
3	Niveli i qartësisë të roleve dhe përgjegjesive për zhvillim	0	Përveç KK Dragash dhe banorëve të fshatrave, të tjerat janë të paqarta	1	Me role të ndara dhe përgjegjësi të qarta, të nivelit qendror dhe lokal
4	Me ndikim në qëllimet prioritare	-1	Qëllimi i zhvillimit të vendbanimeve larg qëllimeve për energji ripërtëritëse	1	Është pararojë e prioriteve zhvillimore
5	E fokusuar dhe strategjike	-1	Jo e fokusuar	1	E fokusuar dhe me prioritet strategjik në zhvillimin e vendit
6	E kuptueshme dhe e përkrahur nga pjesëmarrësit kyç	1	E pranueshme vetëm për banorët e atakuar dhe të fshatrave përreth	0	Kuptimplotë, përkrahje institucionale dhe ekspertizë profesionale
7	Korniza hapësinore, kohore dhe investive	0	Pa ndonjë kornizë kohore dhe investive	1	Ofron kornizë të qartë për të gjithë treguesit përbërës (hap., koh. dhe inv.)
8	Caktimi i rregullave të nevojshme të kontrollit	0	Pa bazë të qartë e të nevojshme për rregullat e kontrollit	1	Rregulla të qarta të kontrollit por jo të gjitha
9	Koordinim në mes sektorëve dhe mundësive zhvillimore	0	Konfliktet vetëm sa vijnë e shtohen vazhdimisht	1	Shprehë përpjekjet për minimizim të konflikteve
10	Shtytës për sinergji potenciale	0	Sinergji ka porse jo në drejtim të arritjeve të qëllimit kryesor të zhvillimit hapësinor për zone të vecante	1	Paraqet funksionimin maksimal të sinergjive
11	Të jetë fleksibile	0	Mund të ketë ndonjë lloj fleksibiliteti por pa planifikim	1	Fleksibilitet në zhvillime, lokacione, kapacitete dhe investime
Gjithsejt		1 nga 10 positive 2 nga 10 negative		9 nga 10 pozitive	
Forma e vlerësimit: [-1]Aspak; [0]Pjesërisht; [+1] – Plotësisht					

Tabela 23. Vlerësimi i strategjive për zonën KEZH-së sipas kriterëve standardë

V. DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Me anë të dispozitave për zbatim bëhet definimi më i qartë i kushteve dhe masave për shfrytëzimin, rregullimin e hapësirës duke përfshirë mbrojtjen mjedisore dhe sociale të KEZH dhe mbrojtjes sociale të zonës ku do bëhet rivendosija e popullatës së zonës. Përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në respektimin e rregullave të parashikuara, të cilat do të ndikojnë në realizimin e drejtë të zhvillimeve të parapara në zonë dhe përreth saj.

KUSHTET DHE MASAT E PËRGJITHSHME

Me planin Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik – KEZH (në tekstin e mëtejshëm: Plani) definohej caqet e rregullimit, organizimit dhe destinimit të hapësirës si edhe kushtet dhe masat për shfrytëzim, rregullim dhe mbrojtje të zonës së veçantë.

- “Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik – KEZH 2012-2022” është i punuar në bashkëpunim të ngushtë nga Instituti për Planifikim Hapësinor – MMPH me Grupin Punues Ndërmësor (të themeluar për këtë qëllim) dhe përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike (hartat, tabelat dhe fotot e ndryshme).
- Rishikimi i Planit bëhet në çdo pesë vite por mund të bëhet edhe sipas kërkesës në bazë të ndryshimeve në terren.
- Përgjegjës për revidim të Planit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), **përkatësisht Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH).**
- Plani është punuar në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe në pajtim me direktivat, konventat dhe parimet ndërkombëtare për planifikim, zhvillim dhe mbrojtje të mjedisit.
- Të gjitha planet tjera të nivelit më të ulët dhe me ndikim në territorin e zonës KEZH i nënshtrohen këtij Plani.

PËRGJEGJËSITË E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

- Propozon institucionet përgjegjëse për përgaditjen e lokacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese;
- **Propozon masat** për hartimin final të Projektit Zbatues për teknologjinë e pranueshme, ndërtimin e sistemit të hidrocentralit në pajtueshmëri të plotë me standardet e BE-se;
- Propozon fazat e zhvillimit për ndërtimin e zbatimit të projektit për HC të Zhurit;
- Bashkë me institucionet përgjegjëse, krijon dhe implementon kornizën e kërkesave që dalin nga Aquis Communitarie.
- Bën inventarizimin, vlerësimin e paluajtshmërive dhe merr vendimin për shpronësim.
- **Në bashkëpunim me Komunitetin përcakton lokacionin e përshtatshëm për zhvendosjen dhe rivendosijen e popullsisë;**
- Në bashkëpunim me Komunitetin dhe në konsultim me Komunitetin cakton lokacionin për zhvendosje - rivendosije të varrezave;
- **Bashkë me institucionet përkatëse për trashëgimi kulturore dhe historike përkujdesen ndaj trashëgimisë kulturore në përgjithësi;**
- Trajton problemet e trashëguara mjedisore dhe parandalon ato të parashikuara dhe të mundshme;
- Aprovon dhe mbikqyr zbatimin e të gjitha Planeve të hartuara nga Investitori Privat të cilat kërkohen në bazë të kontratës;
- MMPH është përgjegjëse për ofrimin e kushteve urbanistike për Planin Rregullues Urban të Kompleksit të Hidrocentralit të Zhurit;
- MMPH jep pëlqimin mjedisor dhe urbanistik për zonën me interes të veçantë ekonomik “KEUK të Zhurit”.

ZBATIMI I PLANIT NGA ANA E QEVERISË QENDRORE/INVESTITORIT

- Operon dhe menaxhon me kapacitetet gjeneruese, pas procesit të tenderimit dhe në përputhje me kushtet e kontratës;
- Harton Planin e Veprimit për Zhvendosje bazuar në "Kornizën e Politikave për Zhvendosje";
- Harton Planin e Veprimit për Zhvendosje të varrezave në bashkëpunim me Kuvendin Komunal përgjegjës dhe në konsultim të ngushtë me komunitetin;
- Harton Planin Rregullues Urban për Kompleksin KEZH" në bazë të kushteve urbanistike të ofruara nga MMPH;
- Themelon Fondin për Zhvillim të Komunitetit të kësaj zone që do të definohet në Kërkesën për Propozim;
- Përkujdeset për ruajtje, mbrojtje të mjedisit dhe hartimin e projekteve për rehabilitimin e mjedisit në të cilin do të operojë dhe instalojë sistemin e monitorimit mjedisit për resurse natyrore dhe cilësi të ajrit.
- Mbikëqyrë hftytëzimin në mënyrë racionale të resurseve ujore të nevojshme për procesin e prodhimit të energjisë elektrike;
- Harton VNM, VNS dhe PVZH bazuar në këtë Plan dhe dokumente tjera të hartuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës
- Çdo plan të hartuar, që i kërkohet edhe me kontratë, e dorëzon për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës.
- Operatori ekonomik²⁴ menaxhon me kapacitete gjeneruese ekzistuese brenda zonës deri në

PËRGJEGJËSITË E PUSHTETIT LOKAL

- Institucionet e nivelit lokal të komunës së Dragashit do të bëjnë koordinimin e menaxhimit të pjesëve të caktuar brenda Zonës me interes të veçantë KEZH;
- Plani zhvillimor komunal (PZH) i Dragashit duhet të harmonizohet me këtë Plan;
- Zgjerimi i vendbanimeve duhet të jetë në përputhje me PZH, PZHU dhe PRRU dhe PH të malit Sharr për komunën e Dragashit;
- Qeveria lokale harton dhe miraton Planin Rregullues Urban;
- Qevria lokale, pas marrjes së pëlqimeve nga MMPH, miraton Planin Rregullues Urban për Kompleksin e KEZH;
- Drejtoria Komonale për Urbanizëm, gjatë hartimit të planeve rregullative/urbane, duhet orientuar zhvillimet në densifikim apo zgjerim të vendbanimit ku do bëhet relokimi i banorëve të KEZH, alternativë kjo e zgjedhur me konsensus me banorët e zonës;
- Siguria e sistemit të hidrocentralit (sinjalizimi, mbrojtëset rrugore,);
- Siguria në komunikacion (sinjalizimi, mbrojtëset rrugore,);
- Ndalimi i qarkullimit të mjeteve transportuese në rrugët lokale të vendbanimeve;

RREGULLIMI DHE SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS

- Hapësira brenda kufijve duhet ruajtur ekskluzivisht për aktivitetet energjetike ujore porse dhe për aktivitete rekreative turistike.
- Në vendbanimet që duhet të zhvendosen, sipas avancimit të zhvillimeve bazuar në Planin e Zhvendosjes, autoritetet komunale të Dragashit marrin vendim mbi ndalimin e ndërtimeve të reja pas inventarizimit të pasurisë së paluajtshme.
- Ndërtimet e objekteve të reja të banimit, në periudhën pas marrjes së vendimit nga autoritetet komunale mbi ndalimin e ndërtimit tyre deri para fillimit të procesit të zhvendosjes, konsiderohen ndërtime ilegale dhe nuk kompensohen.

DISPOZITAT MBI KRONOLOGJINË DHE ETAPAT E ZBATIMIT

- Avancimi i procesit të zhvillimit të hidrocentralit gjegjësisht kronologjisë së ndërtimit të vazhdueshëm të sistemit mund të zbatohet vetëm në bazë të vendimeve të Qeverisë së Kosovës.

²⁴ Me operator ekonomik definohet operatori aktual që është KEK-u sh.a. apo pasardhësi i tij pas procesit të ristrukturimit apo privatizimit ...

- Avancimi dhe kronologjia e zhvillimeve realizohet sipas Planit Kryesor Energjetik Ujor, të hartuar nga Elektroprojekt Zagreb, me pasqyrim kronologjik të fazave.
- Plani mbështetet në studim-hulumtimin e fizibilitetit për HC Zhur hartuar nga Elektroprojekt Zagreb.
- Avancimi dhe kronologjia e zhvillimit të procesit të zhvendosjes së pjesës së vendbanimeve Brezan dhe Zhur duhet të realizohet konform zhvillimit të procesit të zhvillimit të hidrocentralit të Zhurit.

UDHËZIME MBI HULUMTIMET E MËTUTJESHME

- Qeveria e Kosovës/Investitori harton hulumtimin dhe strategjinë e zhvendosjes dhe rivendosjes së banorëve në vendbanimin e ri.
- Përfundon procedurat e shpalljes dhe obligon KK të Dragashit-në hartimin e Planit Rregullues Urban të KEZH;
- Përmes institucioneve kompetente harton studimet e fizibilitetit dhe zbaton projektet për ndërtimin e Hidrocentraleve tjera të vogla;
- Studjon dhe realizon projektin e shndërrimit të 'Hidrocentralit të Ujmanit në hidrocentral reversibil;
- Harton projekte të bazuara mbi studimet e kryera paraprakisht për mundësinë e shfrytëzimit burimeve tjera alternative për prodhim të energjisë elektrike;
- Krijon kornizë të qëndrueshme ligjore, institucionale dhe ekonomike për energjinë alternative;
- Themelon Institucionin Qëndror për hulumtim dhe shfrytëzim të burimeve të ri-përtritshme.

Literatura

- EC, CARDS assistance Programme to the Eastern Balkans 2001, *"Regional Strategy Paper (2002-2006)"*, Brussels.
- Elektroprojekt Zagreb, 2009, *"Study-Multidisciplinary, Preliminary Environmental Assessment" HPP ZHUR.*
- EU pillar, PISG, Energy office, 2003, *"Energy strategy and policy of Kosova – ëhite paper"*, Prishtina
- European Stability Initiative, 2002. *"De-industrialisation and its consequences, a Kosova story"*, Prishtina – Berlin.
- Hajriz Meleqi, 1994, *"Studim kompleks gjeografik"*, Prishtinë.
- KK Dragash 2004, *"Revista mujore e K.K.Dragash"*, Dragash.
- KK, Dragash 2006, *"Analiza hapësinore për Dragashin"*, Dragash.
- Kodra A., 1987, *"Skema e zhvillimit paleogjeografik e gjeotektonik të Albanideve të brendshme gjatë Triasikut dhe Jurasikut"*. Buletini Shkencave Gjeologjike, Tiranë.
- MEM, 2005, *"Raport i sektorit të energjisë"*, Prishtinë, Kosovë.
- Menkoviq L, Karoviq J, Kashkal M, 1982, *"Osnovna Geoloska Karta"* Prizren.
- MMPH/ IPH, 2006, *"Plani Hapësinor i Kosovës 2005-+2015+"*, Prishtinë.
- Riinvest, 2005, *"Profili socio-ekonomik i Kosovës dhe sfidat zhvillimore"*, Prishtinë.
- UNDP Kosovë 2004, *Raporti i Zhvillimit Njerëzor, "Pasqyra e Papunësisë sipas Rajoneve"*, Prishtinë.
- <http://kk.rks-gov.net/dragash>
- Qeveria e Kosovës 2009, *"STRATEGJIA E ENERGISË E REPUBLIKËS TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2009 – 2018 , (Rishikimi i Strategjisë së Energjisë për periudhën 2005-2015).*
- EREC/European Renewable Energy Council", 2008, *"Renewable Energy Technology Roadmap 20% by 2020"*, Brussels.